


Ali Pasha është ndoshta personazhi historik shqiptar më i lëvruar në gjininë e letrave, artet figurative, skenat e muzikës dhe teatrit botëror. Sigurisht e tërë kjo vëmendje e krijuesve të letërsisë, muzikës dhe artit pamor europian dhe më gjerë nuk ishte rastësi. Ajo nuk u imponua as me forcën e diktatit, autoritetin e pushtetit, e aq më pak me censurën.

ALIPASHA NË LETËRSINË, ARTIN DHE SKENAT E TEATRIT BOTËROR

Prof. Dr. Irakli Koçollari

(fq. 20)



in memoriam

REQUIEM PËR LINDITA AHMETIN

Nga Nurie Emrullai

(fq. 7)

Në atë çast si një lloj rituali, zëri i saj drithërues, nuk ishte më i njëjti me atë që pak minuta më parë na kishte folur, por ishte një zë ardhur prej lashtësie, nga atje ku sa herë përmes poezisë së saj na ka treguar që i flente shpirti në antikitet, me një peshë që na e rëndonte dhe na e lehtësonte ajrin përreth, që na trazonte e na ngjallte përnjëherë.

FLAMUJT E BARDHË

Tregim kushtuar piktorit Ali Oseku

nga Astrit Bishqemi

(fq. 17)

SHËNIME MBI LIBRAT

Në vigjilje të 100-vjetorit të lindjes

JUP KASTRATI DHE STUDIMET DERADIANE

Nga Tefë Topalli

(fq. 4)

Shënime për romanin "Vajzat e mjegullës" të shkrimtarit Namik Dokle, botim i CONNECTUM, Sarajevë

QËNDRESA NDAJ ANTINJERËZORËS

Nga Dr. Adijata Ibrishimoviç-Shabiç

(fq. 10)

Antologjia "Proza tregimtare greke",
përgatitur nga Stavri J. Dajo (Literatus, 2023)

DRITËHIJE TË DILEMAVE TË NJERIUT

Nga Mehmet Elezi

(fq. 11)

Romani "Malësorja" i shkrimtarit Nazmi Rrahmani

ARKETIPI DHE PAVETËDIJA KOLEKTIVE

Nga Shefqet Dibrani

(fq. 8)



(fq. 2)

15 prill 2024. Ti mbush 100 vjeç. Ose, kishe me mbushë. Mbjaj mend se për 75 vjetorin tand, t'u pat akordu nga Presidenti i Republikës i kohës titulli "Mjeshtër i madh i Punës". Fola diçka në atë ceremoni dhe nuk mbaj mend gjithçka thashë, por ndërmend fort qartësisht se e pata mbyllë atë ndërhyrje temen me fjalët: "du që në 15 prillin e 100 vjetorit tand, me të ardhë te shtrati në mëngjes, me të puthë e me të thanë – e mbajte fjalën, shpirt!"

LETËR BABAIT TIM, JUP KASTRATI, NË NJËQINDVJETORIN E LINDJES

Nga Diana Kastrati

Shënime për "Kur sunduesit grinden"

Kadare, Chronotope-ja që ka ngrirë tri minuta të një epoke

Nga Ilir Yzeiri


(fq. 6)

ROMANI I FUNDIT I GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ-IT, ËSHTË NJË DËSHMI PREKËSE E GJENISË SË TIJ

Nga Gabriel Garcia Ochoa

Përktheu: David Hudhri

(fq. 23)



BIBLIOTEKË

Klara Kodra (fq. 12)

Zjarri i një agimi

Valbona Quku (fq. 12)

Luleborat në rrugën "Elena"

Skënder Karriqi (fq. 13)

Një shfaqje në qytetin e vogël

Mehmet Jasin (fq. 14)

Hyjnia e erës

Luan Rama (fq. 15)

Padashur e lëndova gomarin

Esmeralda Shpata (fq. 16)

Aura

Vangjush Saro (fq. 17)

Dhjetë fabula

Arben Meksi (fq. 22)

Karikatura e të shtunës

KËNGA E GJORG GOLEMIT DHE FIGURA GJERGJ ARANITIT NË LETËRSI DHE ARTE

Nga Avni Alcani

(fq. 18)

"Kanga e Gjorg Golemit", e cila është konsideruar si një ndër krijimet më të bukura të folklorit shqiptar. Kënga i kushtohet Gjergj Aranit Golemit, një nga figurat historike më të shquara të shekullit të 15-të.

Babi shpirti,

15 prill 2024. Ti mbush 100 vjeç. Ose, kishe me mbushë. Mbaj mend se për 75 vjetorin tand, t'u pat akordu nga Presidenti i Republikës i kohës titulli "Mjeshtër i madh i Punës". Fola diçka në atë ceremoni dhe nuk mbaj mend gjithçka thashë, por ndërmend fort qartësisht se e pata mbyllë atë ndërhyrje temen me fjalët: "du që në 15 prillin e 100 vjetorit tand, me të ardhë te shtrati në mëngjes, me të puthë e me të thanë – e mbajte fjalën, shpirt"! Ndërmend vetëm emocionin në lotë tandin dhe përpjekjen titanike temen për të mos e lëshu veten në skena patetike. Nuk e kam të qartë tashma mbas 25 vitesh nga kjo shprehje publike e dashnisë, nëse kur ta pata thanë isha e bindun a jo se do të ndodhte. Kam frikë se jo. Nuk kisha asnjëfije vetëdijësimi se si do të ishte kjo ditë, se si do të isha unë, ne...Ti nuk je ma në jetë dhe sigurisht nuk përban një çudi. Jeta biologjike ka rregullat e saja. E unë, kam muej që mas forcat e mia për me ta shkru këte letër tuj e ditë se do të ishte një ushtrim i fortë emocional për mua. Por ia dola, bash si personazhi i Kunderës te romani "Pavdekësia": Agnes e ndigjon me dhjetra herë "Adagion", për me mujtë me e përballu kur ta ndigjonte te funerali i të atit.

Po pse të shkruet sot publikisht? Letra për vetë natyrën e saj nuk mund të jetë publike, aq ma shumë kur bahet fjalë për një letër midis familjarësh. Nuk e di a do të kishe kenë një mendje me mu për këtë letër, por unë e kam vendosë tashma e, letra asht në sytë e tanëve. Nuk jam pishman, përkundrazi. I dhashë lirinë vedit me e ba publike, por edhe me e shkru në gegnisht përse kohë ky ka qenë kodi jonë i komunikimit në shtëpi. Du me qenë krejt e sinqertë me letrën. Po të tregoj se në këtë pikë të jetës ku ndodhem, jo thjesht të moshës, por edhe të disa bindjeve që njeriu përfton në këtë kohë që na asht dhanë me jetu, se ka disa syresh që duhen shprehë, duhen nda me të tjerët. E ty du me të vu në dritën publike për atë çka unë jam e bindun se i takon publikut. Ti i ke taku publikut qyshkur vetëm 20 vjeçar dole në shtyp me një studim mbi "Dramatikën shqiptare". E prej atëherë nuk u ndale ma tuj i dhanë publikut lexues punë tueja, që kapshin një gamë të gjanë fillimisht, por që paralajmëroshin hullinë ku do të shkoje: studimin. Nuk kam njoftë në jetën teme deri me tash të paktën, një tjetër njeri ma punëtor, ma sistematik, ma të zellshëm, ma të organizuem. Imagjinata jeme pat shkue deri aty sa pata rindërtu një skenë (mos qesh): kur ke lindë ti, Fatat që mblidhen rreth shtratit për me përcaktu udhëtimin e foshnjës, do të kenë këndu në kor: punë, punë!

Ku më xanë fill ndërmendjet e mia për ty? Herët, por më vjen krejt e qartë skena kur unë isha pa u futë në klasë të parë e nuk dijshe me lexu, por shifsha motrat e mija ma të mëdhaja që lexojshin e atëherë iu drejtova atyne me lutjen: ma lexoni edhe mue këtë librin (kisha gjetë një me ngjyra në raftin e librave...). Kujtoj krejt qartë se si e ku ishin motrat e mia binjake: në salonin e madh të katit të parë ku banojshim asokohe, në një kanape, njena nga njena anë, tjetra nga ana tjetër. E ndigjune lutjen teme, por as sytë nuk i çunë kah unë. E fyeme prej mospërfilljes të "egër" të tyne, bana do metra e erdha mbrapa shpindës tande tek skrivania në fund të salonit: babi, unë iu kërkova atyne dyjave me ma lexu këtë librin, por ata as nuk m'u përgjigjen! Ti e more shumë seriozisht këtë "denoncim" temin për "sjelljen e keqe" të motrave dhe brofe në kambë tuj më marrë për dore: ashtuu?? Hajde t'iu thona bashkë lutjen tande! (vonë kam marrë vesh që ti mezi kishe mbajtë të qeshunën). E sigurtë tashma për fitoren teme, ndejta përmbri teje tek i qortojshe për faktin se nuk e kishin vlerësë kërkësën teme dhe iu the ta ndalojshin leximin e tyne e të merreshin me mu. E futun në mes tyne me

LETËR BABAIT TIM, JUP KASTRATI, NË NJËQINDVJETORIN E LINDJES

Nga Diana Kastrati



nji buzëqeshje sfiduese, njena prej tyne filloi me ma lexu tanë hundë e buzë. Ndërkohë mu më iku vëmendja dhe u largova tuj i lanë ato dyja të habituna e të nervozueme me mu. Por kur hyna në klasë të parë ama, më pate kërkun në formë urdhni, mu e motrave para meje, që në një fletore 16 lekshe të kohës, të shënojshim librat që kishim lexu përgjatë gjithë klasës së parë deri në pushimet e verës, me një rregull të caktuem që sot kishte me u quejt "bibliografi e arsytueme". Fletoret janë aty, të rrujtuna prej teje. Edhe kur u bane gjysh për së parit, ia bane të njëjtën kërkësë mbesës tande. Edhe ajo fletore asht endë aty. Por mbaj mend edhe një rast tjetër kur isha në klasë të parë tashma dhe kisha mësu përmendësh një vjershë që e kishim detyrë shtëpije dhe, e bindun për përgatitjen teme, të kërkova me ma ndigju tekta e recitojshja. Gabim i fortë: qysh në rresht të parë më ndalove duke më thanë t'u vendosja theksin logjik fjalëve, vargjeve, pauzave. Për gjithësecilin varg, tuj më kthy nja dhjetë herë! Bindja jeme fillestare për lavdi, kishte qenë e rrejshe! U betova me vedi se nuk do të kishte një herë të dytë kërkësë vullnetare nga ana jeme. Por prapë tek ti përplasesha. Ritmi jot i ditës, javës, muajve, viteve që kalova me ty, kornizohej nga makina jote e shkrimit dhe skrivania jote e përmbytun nalt e poshtë në tokë nga libra, letra, dosje e stilolapsa. Të gjitha të vendosuna në një rregull kirurgjikal. "Xhaxhi Jupin e shof gjithmonë me shpindë" – thoshte një shoqe e jemja e fëminisë. Ishte pozicioni i skrivanisë që me pamje nga balkoni i dhomës, kishte derën e hymjes mbrapa e meqenëse ti ishe aty rregullisht, asaj i dukej se ti rrije gjithmonë me shpindë. Por unë atë

pozicion e dojshe shumë. Për secilën pyetje që kryet tem prej fëmije krijonte, unë vijsha nga mbrapa shpindës tande, të preksha e me kënaqësinë e atij që e din se merr vëmendje, të pyetsha pa parathanie. Gjesti që më lumturonte ishte të hequnit e beftë të gjyslykëve nga sytë tuej dhe shprehja që e shoqonte: po shpirt! Nuk kujtoj as edhe njenen prej pyetjeve të famshme që të kam pas bā. Kujtoj ama me kthjelltësi, ndjesinë e plotnisë teme, të sigurisë që unë mund të vijsha tek ti përgjithëherë që dojshe. Tash mund ta kuptoj se çka don me thanë me të ndërprë tash e mbasandej kur je duke punu me kokë. Të kam falenderu me mend ma vonë, por ndruhem se nuk ta kam pas thanë me gojë. Veç tash e di se baza e vetëbesimit tem, xen fill njaty. Nuk m'u tradhëtu ndonjherë prej teje ky vetëbesim, nuk mori kurrë plasë, as kur u dergjshë në shtrat në muejt e fundit e unë kisha nevojë për disa të dhana për Shkodrën që më duheshin për një takim me Dacia Marainin. Si me pasë kliku në internet, memoria jote mitike, m'u gjet ndihmë. Edhe aty, i kthyem përgjysë kah unë, pamvarësisht dhimbjeve fizike të sëmundjes që kishte avancu, kryejshë ritualin e shenjtë për mu: atë të Vëmendjes. E mu më përkthehej me tingullin që ishte i jemi tashma, tingulli i Besimit në ty e që përthehej i plotë në mu.

Në tanë këtë film të jetës me ty, ndërmendja jeme për ty e me ty, mban gjurmë të forta e plot me ngjyra. Më vjen figura jote e kërrusun në skrivani deri vonë në mbramje; e ndryshove këtë orar kur mosha filloi me u ndë e ora e mbylljes së punës ditore tande ishte 11 e darkës. Para se me i mbyllë letrat e makinën e shkrimit,

të shifja në kambë para skrivanisë tuj shkru *promemorien* për ditë e nesërme: me të kuqe ishin prioritaret, me të zezë rutina. Nadja të shifte ty të parin në kambë. E më vijnë të kthjellta si drita e lëbyrtë, zgjimet në shtëpi, mëngjesi i bamun gati prej teje në tavolinë për ne tri vajzat, kurse Nanit ia çojshë te shtrati, përditë. E në sfond kishte muzikë, gjithmonë. Kur të takonte me dalë prej shtëpije para se ne trija me u ulë në tavolinë, mbi të gjejsim pusullat e shkrueme me atë kaligrafinë e stërrregullt tanden: "Shpirtat e mi, sot kam leksion deri nga ora...Në orën ...kam mblehdje katedre. Në drekë do të vij në shtëpi me hangër bashkë, mbasdite kam prapë mblehdje...". Janë nuk di sa syresh të rrujtuna në dosjet që ti vetë i ke pasë sistemu.

Për vite me rradhë kena pasë dhomën e hëjes në atë që ne e quejshim "dhoma e mesit" ku në murin përballë nuk mungonte edhe aty një raft librash i mbushun nga toka deri në tavan. Tuj u gjetë përditë përballë tij, kishim mësu përmendësh titujt e librave a të revistave dhe derisa të na shërbehej vakti nga Nani, ne motrat kishim xanë një lojë: njena përmendte titullin e ne dy tjerat duhet ta gjejsim ku ndodhej në raft. Mandej të vëjsim ty në provë; e kotë me thanë që u përgjigjshë saktë tuj tregu edhe radhën ku ndodhej në raft. Kjo më habiste pa fund. Nuk e imagjinojshe se si mund të mbaheshin mend vendet ku ndodheshin gjithë ato libra. Shtëpia ishte e mbushun cep më cep me rafte librash e me libra e revista që rrijshin në tokë ngaqë nuk kishte m'v vend të lirë. Vetëm Nana jonë shenjtore mund ta përballonte kësi parehatije në shtëpi, por e kotë me e thanë: ju adhuroshit njeni tjetrin e gjithçka mbarre ngjyrën e dashnisë, edhe parehatia e lëvizjes bahej bukuri. Kam në hundë sot e gjithmonë erën karakteristike të librave, të pluhnit, normal. Pastrimin e risistemimin e bajshe vetë. Më kujtohet që u mendojshe me të ndihmu, ne temen. Tek më thoshte kriterin se si do të vendoseshin, unë isha pak si e paorientueme, por saktësia e veprimeve tueja, mbi të gjitha sistematiciteti, ma forconte paorientimin tem. Kujtesa jote ishte pak me thanë, fenomenale. E kjo në 360°: për librat e datat e botimeve, për autorët, për edicionet e ndryshme. Kam kuptu ma vonë se kjo kujtesë nuk ishte thjesht dhunti e lindun, ishte e kultivue. Në sistemin tand cerebral të të punuemit, kishte një organizim perfekt të kohës, të projekteve për studimet që do të bajshe, të ditarëve që mbajshe. Feja jote ishte kultura e shkrueme. I plazmuem me shkollën klasike të të menduemit, fjala e shkrueme, memorizimi në letër, dokumentimi mbi të gjitha, ku futej edhe ai i memories me celuloid, fotografive pra, shtëpia jonë ngjante me një bibliotekë – arkiv. Kur isha e vogël ua kisha zili disa shoqeve që i kishin shtëpitë ma pak të ngarkueme me këto "objekte". Kur u rrita pak e kuptova se notojshe në thesare.


A e din shpirt se ç'ka më vjen në mend tjetër? Nji mbasdite vere kur unë tashma kisha hy në moshën e adoleshencës. Në raftin e dhomës së pritjes, kisha kohë që kisha vu ore një libër në italisht me një titull ftues të tipit "*L'amore e il sesso*", në mos u gabofsha botim i fund viteve '30 të shekullit të kaluem. Në fakt, ishte libër studimor. Prita sa ti shkove me pushu në një orëshin e gjumit kanonik të mbasdites dhe iu afrova raftit. Mora librin dhe ndejta me sytë nga dera në mënyrë që ta kontrollojshe situatën në rast se do t'u çojshë prej gjumit. Libri ishte i vjetër, me gërma të vogla. Italishtja jeme nuk ishte as elementare, ama dëshira e kureshtja jeme ishin të mëdhaja. Filloj me lexu. Në 10 fjalë të një fjalie, kuptojshë tri a katër. Shtoji këtu edhe vështirësinë e shkrimit akademik studimor, zor se po kapsha gjā. Ndërkohë, e përhumbun në këtë përpjekje temen titanike, nuk ndigjoj zhurmën e hapave të tu në dërrasat e dyshemesë së vjetër

që kërcitshin dhe, ndjej zanin tand të qetë: "Shpirt, mendoj se italishtja jote nuk ka me të leju me e kuptu. Ma mirë lenë prapë në raft dhe e lexon në një kohë tjetër kur ta kesh xanë më mirë gjuhën!" Në largësinë prej 4 metrash, kishe kuptu për cilin libër bahej fjalë! E kontraktueme nga xania bef, me gjymtyrët që mezi po më bindeshin, e vuna në raft e ngrita sytë me të pà. Të kam qenë mirënjohëse pa fund në atë moment po aq sa sot e kësaj dite. Në rast se ti do të më kishe bërë moralizma në atë çast, nuk e di se si do të isha raportu ma vonë me libra të kësaj natyre. Me matuni ma hoqe librin që sigurisht nuk ishte për moshën teme, por nuk më krijove tabunë. E kjo asht tejet e randësishme për një adoleshente.

Mbaj mend që aq sa ishe përkëdhelës me ne vajzat (edhe ma shumë se Nani), po aq ishe rreptë e autoritar. Idem Nani për këtë të dytën. Ishte një simfoni *in duo*. E prapë me intuitë kuptojsha që kur ishte puna me marrë leje për me shku diku, ma lehtë e kisha me ardhë tek ti së parit. Përgjithëherë përgjigja jote ishte: pyete Nanin! Ndoshta falë natyrës teme ma komunikuese e të hapun, kisha fillu herët me folë me ty, me dalë me ty shëtitje. Mbaj mend që një vajzë komshije më pat thanë: si del me babën ti në këtë moshë? (isha në gjimnaz). Nuk iu pata përgjigjë. U ndjeva e paralizueme në pamundësinë teme me i shpjegu asaj që shëtitja me ty ishte balsam për mû. Në krah tandin, rreth meje më mbështillte një ajri e papërshkrueshme. Më flitshe e më ndigjojshe e mbi të gjitha, më jepse aq informacion sa nuk do ta kisha marrë as në vite të tana leximesh. Ti ishe rrëfimtari i lindun, ai që të magjepste. Ishe pasionanti. Ishe mbreti i fjalës e emocionit të bukur. Ishe elektrizues. Mbramjet e verës me ty më vijnë saktësisht me të njëjtën ndjesi: mirakandje shpirti, mendjeje.

Mbaj mend kur ma pate dhanë makinën e shkrimit për me të daktilografu librin e Faik Konicës "*Doktor Gjilpëra...*", të cilin e kishe marrë hua e t'u donte t'ia kthejshe të zotit mbrenda një jave. Kësodore, ti i daktilografojshe vetë. Ndër vite mbaj mend këtë stërlodhje tanden me veprat e autorëve që nuk i kishe. Besoj se kam kenë në fund të tetëvjeçares. E mora disi me frikë, por nga njena anë stili ironik i Konicës me të cilin po bijsha për herë të parë në kontakt, e nga ana tjetër besimi jot në mu, ma hoqën sikletin e parë. Edhe sot e kësaj dite e përdori kompjuterin me thuasje të njëjtën mënyrë si makinën tande të shkrimit Olivetti.


Mbaj mend se as ti, as Nani, nuk ju xente sytë dashnija për ne vajzat, sa mos me dallu ku i kishim dobësitë tona. Gati gati "të pamëshirshëm" në vlerësim, por falë Zotit objektivë, e kishit kuptu natyrën e prirjet e secilës. E kur erdh momenti me zgjedhë drejtimin tem për studime, prirja e pasioni jem për gjuhët e hueja, i pikasun herët nga ti, më çoi drejt asaj që tashti asht jo thjesht profesion për mu, por pasion: gjuha e kultura italiane. Isha e "përmytun" në dashni për atë që po bajshe, që nuk ishte tjetër vetëm se zgjatimi i tanë bisedave tona ndër vite. Por asokohe studioshim edhe ekonominë politike....socializmin. Unë i bajsha rezistencë landës për "moslogjikën". E në fakt, në provim mora një notë jo fort të kandshme. Kur u ktheva në shtëpi atë natë, m'u tha nga ti e Nani: për provimin tjetër



do të përgatitesh vetëm në dhomë, derisa të jesh bindë se e ke përvetësu si duhet! Mbaj mend se provimi tjetër ishte letërsia italiane. Ekstazë për mu. Por ndërkohë dialogu me ty ishte i mekët. Kaluen dy ditë, tri; të katërtën vara në derën e dhomës teme një fletë A4 ku shkruhej: "*Per me si va ne la città dolente, per me si va ne l'eterno dolore, per me si va tra la perduta gente.../ Lasciate ogne speranza, voi ch'intrate*" (Komedia Hyjnore, Ferri, Kanga III). Funkcionoi! Të ndigjova mbas deret që po qeshje. Hyne mbrendë e u rrokëm. Paqja zbriti në mû.

Mbaj mend se ti ishe Mentori i temës teme të diplomës. Mbaj mend përgatitjen e ankthshme, prezantimin para komisionit, rezultatin e bukur. E, mbaj mend se si në korrik të atij viti që kisha mbaru studimet, teksa kotesha në divan, më erdhe me një turrë librash në dorë e më the: "E mira do të ishte që të mendojshe për me shkru një

artikull te numri i ardhshëm i Buletinit...Në rast se don me u përqëndru te Treqindshi italian, këto libra mund t'i kesh si bazë fillestare. Çka të lindin nevojë rrugës, i gjen në Bibliotekë të qytetit." Të pashë me bezdinë e atij që i prishet lezeti i ndejtjes kot mbasi mendon se i ka mbaru detyrimet e studimit. Mbaj mend që vetëm më dhe orientime si me e hartu bibliografinë e referencat. Edhe sot e kësaj dite, pavarësisht formave të reja të shkrimit të aparatit shkencor, unë ruej remineshencat e formës të mësueme asokohe. Iu futa edhe një herë leximit. Nuk e di a e kam pas shkru mirë a jo atë artikull, por ti ma lexove vetëm në fund kur e kisha mbaru. Më përgëzove. Ndoshta për me më dhanë zemër. Kot me të thanë sa mirënjohëse të kam kenë e jam për atë mbasdite vere që do të kishte kalu anonime dhe e pashije, si tana ditët kur nuk bajmë diçka të vjefshme e të bukur. Më ka



vlejtë jo thjesht Modeli jot, më ka vlejtë fryma që më jepse, shtysa, optimizmi, bindja e ngulitun sot e kësaj dite se kur merresh me librin, "i je largu përgjithmonë banalitetit". Tash e kuptoj se fillimet e mia mbasuniversitare, ishin hala të rrëmujshe për mue. Nji gja ama e kisha të qartë diku në nënvetëdijen teme: në një mënyrë a tjetër, pak apo shumë, do të merresha një ditë me atë çka kisha nuhatë prej një jete në shtëpinë tonë.

Mbaj mend që nuk u ankojshe asnjherë për kurgja. Veç dy gjana përbajshin "setin" e ankimeve tueja: koha që nuk të mjaftonte kurrë e, hapësina fizike në shtëpi për librat. Skedarët e tu ishin në ato kutitë e drunit a kartonit. Ishin të pafundme, në të gjitha dhomat, me përjashtim të kuzhinës. Nji pjesë të tyne, mjerisht, i kishim vendosë edhe në balkon që kishte një strehë po kaq mjerane për me mbrojtë atë mund të pacak tandin ndër dekada. Ishim mundue me Nanin me i mbulu disi qysh.

I kontrollojshim herë mbas here, por shiu hyn gjithkund. Mbaj mend që në një nga ato herët e kontrollit periodik, vumë òrë se thuejse tanë skedarët që ndodheshin në ballkon ishin damtue plotësisht. Më vjen turp, shumë, e më pushton dhimbja tek ta them: një natë nga e vona, për mos me të shqetësu ty që skedarët kishin dalë jashtë përdorimit, fshehtas i nxorëm me kutija e i hodhëm në...kazanin e plehrave të rrugës. As nuk e di se cilave veprave tueja i përkisshin, por ime motër Mira më pat thanë se më duket një pjesë e tyne ishin shënime për hartimin e nji Fjalori foljesh të gjuhë shqipe. As nuk e di sa dekada jetë e punë të kishin marrë për me i qëmtu, mbledhë e sistemu, por imagjinoj që shumë. Du me lehtësu disi vedin me faktin se çuditërisht nuk pata ndigju në shtëpi se i pate kërk. Ndoshta i kishe shfrytëzu tashma, ndoshta nuk të ka dalë koha më me u marrë me këtë projekt studimor, por duke ditë fort mirë se si edhe pusulla ma e vogël ishte e shenjtë për ty, më djeg shpirtin ky fakt. Por menduem me ta kursy ty dhimbjen. Sot, nuk do ta kishim bërë. Do t'i kishim mbajët edhe të mykuna, edhe të palexueshme. Më fal shumë, shpirt!

Mbaj mend ritmin tand marramendës të përditshëm, mbledhjet e pafundme në Institut, katedër, madje këtu përgjithë të hane në mëngjes në ora 8. Mbaj mend se përgjithë të dielë, përpos të tjerave impenjime tueja, ti përgatisje raportin për mbledhjen e katedrës të së hanës, raporte që shkolin mbi 4 faqe rregullisht. I kemi të gjitha të rrujtuna. Mbaj mend që anëtarët e katedrës, edhe ish studentë të tu që sot punojnë a drejtojnë atë institucion, më patën deklaruar: në rast se dimë si shkruhet një relacion a studim, e kemi prej Profesor Jupit.

Mbaj mend kërkesat e promemoret e tueja drejtu instancave të nalta qeveritare në Tiranë për ta shndërru Institutin Pedagogjik të Shkodrës, në Universitet. Ishin përpjekje të vijueshme të tuejat, për me e sjellë Shkodrën në naltësinë që i takon, për traditën e shkrueme të saj, për eksponentët e jashtëzakonshëm që ka nxjerrë në çdo kohë. Ishin këto argumentet e tueja në ato letra që sigurisht ndodhen tek ne, por me siguri edhe në arkivën e Institutit apo të institucioneve të kohës. Madje, kur mbërriti momenti për
(Vijon në fq. 5)

Në vigjilje të 100-vjetorit të lindjes

JUP KASTRATI DHE STUDIMET DERADIANE

Nga Tefë Topalli



“Poezi shqipe të shekullit XV “Kangë të Milosaut” transliterue, përshtatë në gjuhën e sotme dhe komentue nga Jup Kastrati (Tiranë, 1956).

Kështu duhet quajtur vepra e parë e një studimi të plotë të romanit lirik “Këngët e Milosaut”, hartuar nga prof. Jup Kastrati, për poemën aq të njohur të apostullit të shqiptarizmit, Jeronim de Radës, publikuar më 1836, kur intelektualët, pedagogët dhe dijetarët arbëreshë, jo vetëm u shfaqën, por u bënë protagonistë të idealeve të Rilindjes sonë Kombëtare. Krijimet e tyre letrare e gjuhësore u përfshin nëpër tekstet shkollore të Shqipërisë gjatë viteve 1930-1944, nga tekstologë të nderuar si J. Rrota dhe E. Çabej. Me këtë fakt lidhet edhe botimi monografik i mësuesit të njohur të gjimnazit të shtetit në Shkodër, Jup Kastrati, kur përshtati me gjuhën e sotme, (në variantin letrar të Jugut) poemën-roman “Kangët e Milosaut”, 1956. Për këtë gjuhëtar albanolog, studiuesit e veprës së tij, kanë theksuar se në periudhën e parë të punimeve shkencore të gjuhëtarit të ri, 1944 – 1960, ai hartoi dhe nxori në qarkullim monografinë *Dramatika shqiptare* (1940), kur ishte në moshën 16 vjeç: më pas përgatiti *Vepra të zgjedhura të Faik Konicës* (1952), si dhe veprën letrare-gjuhësore “*Poezi shqipe: Kangë të Milosaut- bir i sundimtarit të Shkodrës*” (1956). Brenda vitit 1960, ai do të përgatitë për botim Buletin e ILP të Shkodrës, përkthen përmbledhjen me fabula të Fedrit (1958), boton një vëllim me vjersha e tregime të shkrimtarit të ri shkodran Kolë Mirdita “*Trëndafila që s’çelin për ne*” (1959), publikon “*Bibliografinë shqipe*” (1950), për të vijuar me 6 bibliografi të tjera: për Shuteriqin, Dramatikën shqiptare, për Narrativën shqipe, bibliografi për Shtypin shqiptar dhe Organet e shtypit, bibliografi për Gramatikën dhe Fjalorët e shqipes, bibliografi për revistën “*Hosteni*”

etj. Në këtë dhjetëvjeçar bën botime në lëmë të gjuhësisë, studime monografike për Pashko Vasën, Zef Jubanin, Daut Boriçin etj. Kontributet e prof. Jup Kastrati, sidomos në themelimin e katedrës së Gjuhës shqipe dhe Letërsisë në ILP të Shkodrës, do të dalin më në pah me botimin e plotë të trashëgimisë arsimore dhe pedagogjike, letrare e shkencore për rreth 4 dekada, jo vetëm në këtë institucion të lartë shkencor, por në disa Universitete të vendit dhe jashtë - në Prishtinë e në botën arbëreshe, për 100-vjetorin e lindjes (15 prill 1924).

Për poemën “Milosao”, duhet të shënojmë se hulumtimet e pjesëshme kanë nisur qysh para Luftës II Botërore, në vendin tonë (fragmente dhe vetëm pak këngë të veprës), si nga L. Gurakuqi, I. Bebeziqi, A. Xhuvani, Z. Kodra, G. Meyer, Tagliavini etj. kurse në vitet pas, studimet vijuan me përshtatjet e bëra nga prof. Jup Kastrati, më 1956, ndjekin më vonë përshtatjet nga prof. Dh. Shuteriqi (1964), poeti Andrea Varfi (1974) dhe prof. Gjergj Zheji (2009). Vepra e J. Kastrati dallon prej botimeve të tjera, jo veç në përmasat e saj, por njëherësh në gjerësinë e trajtimit të çështjeve alfabetike, leksikore, tekstore (nga origjinali tek përshtatja), interpretimet gramatikore me aq shumë shpjegime, për bibliografinë e mbështetur etj. Nga 204 faqe të monografisë, 4 janë të Parathënies, studimi hyrës me titull “Kangët e Milosaut” shtrihet në 28 faqe, 67 i takojnë tekstit *original dhe përshtatjes*, 98 faqe përbëjnë lëndën për alfabetin dhe shënimet gjuhësore në disa disiplina: fonetike, të leksikut, morfologjisë e sintaksës. Autori shënon me plot poni: “*Vepra, mbasi u krye iu dha për kontroll prof. Kolë Kamsit, Dr. Eqrem Çabejt dhe Mahir Domit. I falënderojmë nga zemra botnisht.*” (f. 9) Ndër këta, Kamsi kishte kryer studime në Kolegjin e Shën Adrianit dhe kishte mbledhur lëndë për

Fjalorin arbërisht-shqip, që do të shihte dritën e botimit vetëm në vitin 2009, me kujdesin e familjes së tij. Studiuesit dhe botuesit i mjaft veprave të J. Kastrati, prof. B. Baliu shënon se poema e përshtatur *Milosao*, pa asnjë ndryshim, është botuar edhe në Prishtinë (1965) në Shkup (1968) dhe për së dyti në Prishtinë (1969). Prej 7 vitesh, kemi në dorë veprën akademike, të shkëlqyer, *Opera Omnia II, Canti di Milosao- Edizione critica e traduzione italiana a cura di Francesco Altimari*, Con DVD allegato, Rubbetino Editore, 2017, 484 f., sjellë për studiuesit e sotëm si punim filologjik, me metodat bashkëkohore të analizës së tekstit


Vepra e transliteruar “Kangët e Milosaut”, nga teksti origjinal i edicionit të parë, 1836, u mendua prej autorit të përshtatjet në të folmen e sotme, me bazë

*toskërishten, pse, siç dihet, dialekti arbëresh në përqindje të madhe i afrohet atij të jugut. Ishte një gjykim shkencor dhe parashikim se varianti i shkruar i toskërishtes do të vihej mbi bazën e gjuhës letrare, pas 16 vitesh, më 1972. Gjithçka poetike e De Radës na vjen në arbërishte, kurse dallojmë me bindje penën e studiuesit Kastrati, me një variant shkrimi që tejkalon të folmen e Gropës së Shkodrës. Ai synonte që përshtatja të ishte sa më poetike, të ruhej fryma krijuese e poetit të Makit, ritmi i veçantë i poezisë së tij dhe elipsi sintaksor, stili konçiz dhe leksiku deradian. Nuk kemi si të mos përcjellim ato karakterizime të ndjera për gjuhën dhe shprehjen plot oshëtimë të rilindësit të madh arbëresh: “*Kur jeton me Milosaut dhe të bijën e Kologresë, Rinën, kur dëgjon bisedat e tyne të nxehta, fjalët e tyne të kthjellta, frazeologjinë e tyne, ndjenjën e tyne të ngrohtë, kur shijon edhe ti atë ndjeshmëni të hollë, atë lirizëm, që e përshkon veprën fillim e mbarim, kur vren, posaçërisht, atë rrobe elegante, atë metrike, me të cilën e mveshi poeti këtë poemë dhe roman në vargje, atëherë e çmon edhe ma tepër këtë vepër madhore, e cila inauguron letërsinë tonë reflektive, atëherë e çmon edhe ti ashtu siç e vlersuen Lamartinë, Hugo, Mistral, Camet, Tommaseo, Cantu, Benloew, Meardi, Marchiano, Stratigo, Bugliari, Gualtieri e të tjerë auktoret e saj.*” (f. 8)*

Ne sot, pas gati 70 vjetësh, duhet të vështrojmë me vëmendje verbin e shkruar të prof. J. Kastrati në analizën e thellë që bën ai në zbrëthimin e plotë të veprës në sythin “Kangët e Milosaut” f.11-37, brenda të cilit gjejmë edhe përkthimin e fjalës-kushtesë që drejton De Rada për mikun e vet Rafael Zagarese, kur kalonte ditë me Antonin dhe Ëngjellin pranë mureve të Shën Adrianit. Autori ynë jep të dhëna për tre botimet e Kangjellave të poemës, shqip e të përkthyer italisht në prozë, në korelatë kohore me rendin kronologjik të poemës së dashunisë, kohë që prof. Altimari më vonë, e shënon për *këngët paramilosaike, brenda një periudhe prej nandëmbëdhjetë vjetësh 1405 deri me 1423, marrun me mend në Shkodër, historikisht në Maki, vendlindja e poetit.* (f. 15). Vende-vende, pena e gjuhëtarit tonë na sjell bukurinë dhe ndjesinë e prozës plot poezi, figuracion dhe shprehësi, si në këtë frazë:

“*Në një mëngjez, kur zgjohet nga gjumi dhe hap dritaren e dhomës, prej frushullimës së krahëve të vidës, sheh natyrën e stolisun e të lulëzueme edhe për së largu detin e kaltër Jon. I zbulohet, si kurr s’i kish pa ma parë atdheu me shtëpia dhe deti. Dhe poeti, nga harmonia imitative e shushurimës së krahëve të pëllumbit me qelqet e dritares, na përshkruen një tablo mbushë me fantazmagori ngjyrash dhe dritash: të bardha lulet e linit, si zemra e vetë të riut, simbol pastërtie dhe sinqeriteti; të kaltërt ujnë dhe detit dhe mbarë qielli; në ngjyrë ari fushat e mbjelluna me grunë. Gjithëshka asht e përgatitun për lindjen e dashunisë; zemra asht e pastërt e plot harë, e mendja asht krejt e humbun në vështrimin e natyrës së bukur, e nuk kujton brengat njerëzore. Pranëvevera, përjashta, gazullon: lulet e linit në të çeluna, era i përkundë e ato duket se vallëzojnë e qeshin. Edhe qielli asht i qeshun porsi lulet. Krejt natyra asht e lumtun. I lumtun asht edhe poeti...*” (f. 17)

Edhe skenat e ëmbla të jetës së re në çift, vijnë e sillen prej autorit studiues plot “*pervigilium Veneris*”, si shkruan ai, dhe paraqiten me një sfumaturë në mes romantizmit dhe të sensualizmit. Pas shfaqjes sublime të dashurisë në këngën e parë, autori ynë shpjegon se hyrja në poemë bëhet në kangjellin e dytë, kur ngjet edhe takimi i parë i heroit (Milosaut) me të bijën e Kologresë, Rinën e bukur me *bishtaleca*, tek kroi i fshatit. De Rada ndjek një traditë këngësh në këtë simbol poetik, qysh nga Eposi ynë, kur nusja e Mujit, grabitur nga Zanat e malit, takohet



dhe njihet me të shoqin, i cili e mëson si t'u shpëtojnë të Mirave Shtojzovale! Kroin e fshatit për dashurinë e vashave e ka në vargjet brilante edhe Lazgushi ynë; edhe në prozë, Kadareja, e përshkruan mahnitjen e *Sjellësit të Fatkeqësisë* para vajzave të lira e të gëzueshme shqiptare, pranë një kroi, në novelën e mësipërme; ndërsa karvani i tij po sillte në Arbëri simbolin, që për disa shekuj, do të quhej *Islamo nox*.....Lexojmë përgjatë shpjegimeve këngë për këngë, të dhëna letrare, kulturore, me emra e vepra klasike të antikitetit grek e romak, emra shkrimtarësh të rramave e drejtimeve artistike të mëvonshme, si: Anakreonti, Safoja, Gualtieri, Tommaseo, emra vendesh e fshatrash nga hapësira ku banojnë arbëreshët; Mistrali përmendet me thënien e tij “*Quel délicieux tableau! Cela a le parfume idilles oblique et la rêve de langue vierge!*” (Sa tabllo i kandshëm. Kjo ka aromën e idileve biblike dhe të jetës virgjineshë!” (përkthim i autorit), kur zë e ravijëzon bukurinë e Rinës, kur De Rada tregon *jetën e ditës dhe të katundit me përfytyrime të kërcyeshme*. Kangjellë pas kangjelle, lexuesi sikur humbet në kënaqësinë e valleve *djem e vajza*, pranë detit, në skenat e natyres së gjallë e me ngjyra gjithnduerësh, mbi të gjitha, nuk na ndahet përjetimi për gëzimin e njerëzve që kënaqen e hidhen lart shpirtërisht kur shohin të rinj të lumtur, optimizmin e jetës, nanat me fëmijët e vet ngrykë, ... “ e poezija, në këtë pikë, ka ngjyrën e poezisë së Tirtut”, (një poet i Greqisë së lashtë, që jetoi në shek. VII, para Krishtit), etj. Në segmente të ndryshme shpjegimi ka edhe krahasime të vargjeve apo këngëve sipas botimeve të ndryshme që i janë bërë poemit prej vetë poetit; në mbyllje të komentit, njihemi me gjykimin se autori i kësaj përshtatjeje, *e sheh krejt të arsyeshme atë mënyrë të folurit eliptik (dhe elipsi është gjë e domosdoshme e poezisë dhe e të folurit njerëzuer...)*; ai na njeh me letrën që poeti i Makit i dërgon Nikolla Tomaseo-t, vijon me krahasime të veprës në vargje me *nymfa* të Horaci-t dhe citime prej Dante-s....edhe prej mësuësit të tij te Komedia Hyjnore, Virgjilit, si: “*hic inte flumina nota, et fontes sacros*” (këtu ndërmytet lumenjtë të njohtur e gurrave shenje). Në fund të kësaj kornize komenti të frymëzuar e poetik, autori i librit kujton Dorothën e Goethës, duke e përqasur me vashën arbëreshe, e cila, “*me njeñen dorë mbante të ngritun mbi veshin e bardhë si bora flokët e lëshueme, me tjetrën nxori dy mollë dhe ia lëshoi në dorën e tij dhe u skuq.*” Dhe mbyllet kjo paraqitje për një veprë që prof.Kastrati jo vetëm e publikoi para shumë viteve, por e deshi si art i paarrirë për kohën kur u shkrua, nga pena e atij që gjuhëtari dhe albanologu ynë, i kushtoi një jetë të gjatë studimi të gjitha veprave: De Radës: “*Dikush tjetër thotë, se kangët e tija janë tepër të coptueme. Por ai që sjell ndër mendë pëllumbeshën e pavdekshme t'Anakreontit, më ban me djitë, se nuk mund të takohemi me fillin retorik të fluturuesve. Tjetër fill shoh tash unë, që e shtërngoi atë, qysh në vitin 1839; dhe shoh se zemra e tij qe shembull përkurmënie dhe vendosmënie njëherit. Në zemrën e tij është dëshirë e përvujtë për të mirën, sepse është plot dashuni për jetën....*”

Në këtë shkrim modest, si peng nderimi për dijetarin e madh të filologjisë dhe albanologjisë shqiptare, në këtë 100-vjetor të lindjes, më pëlqen të kujtoj sentencën e semiotistit dhe tekstologut U. Eco, i cili nënvizonte se, kur përkthejmë nga një gjuhë në tjetrën, le të *mundohejmë të themi gati të njëjtin gjë*; por, në rastin tonë, kur përshtatim gjuhën e një autori, siç është De Rada, me gjuhën e sotme, duhet përpjekur të themi, jo gati, *por krejtësisht të njëjtin gjë*, siç ka arritur prof.J.Kastrati me poemën-roman idilik “Kangët e Milosaut”, dhe asnjëherë të bëhen përshtatje të përafërta, të tjetërsuara apo edhe devijime të papranueshme.



(Vijon nga fq. 3)

me u ba ky shndërrim në Universitet, ishte ti që e pagëzove me emrin e përndritshëm që mban, atë të Luigj Gurakuqit. DASHNËJA jeme për Shkodrën, Shqipërinë, Kosovën e për Arbëreshët, xen rranjë tek ti, tek pasioni jot i pashterrshëm për to. E unë pa drojë aspak, sot në këtë moshë që di me të gjyku jo si babë, por me akull të mendjes, të quej Përbashkues kombëtar. Iluminist.

Kujtoj që udhetojshe shumë shpesh në Tiranë për në Bibliotekën Kombëtare, në Arkiv për gjurmime, në Institutin e Gjuhësisë, në Akademi. Udhëtimi zgjaste 5 orë me shku...kthimi po aq. Kujtoj miqtë e kolegët e tu në shtëpi tonë, rregullisht, ti nuk frekuentojshe lokale; kujtoj se gjatë gjithë jetës tande ne kishim gati pelegrinazh njerëzish të panjoftun që vijshin edhe nga Jugu i Shqipërisë për me të marrë një mendim, një libër, një bibliografi për aksh çështje; kujtoj letrat e pafundme të studiuësve nga jashtë e mbrenda, por edhe të mësuësve të thjeshtë, të një poeti që sapo kishte fillu udhën e krijimit, të studentëve të tu. Kujtoj se edhe me shoqet e mia ishte i njajti mikpritës i pashoq, elegant, civil. Ti nuk e din shpirt se sa mesazhe me vijnë mue e motrës teme në celular nga njerëz të ndryshëm që jeta i ka sjellë me të njoftë mirë, por me të taku edhe rastësisht, ish studentë tuj që sot janë mbi 70 e kusur vjeç. Po të tregoj një rast ndër të shumtët: 4 vjet ma parë më vjen në zyrë një zarf me një letër të shkrueme me dorë nga një ish studente e jotja e cila jetonte në Itali prej kohësh; sot gjyshe. 6 faqe letër sistemu me kujtimet për ty, me nderime që n'rast se nuk do ta dijshe se si ke kenë, mund ta merrshja për idolatri. Në këtë përmbyetje memoristike për ty, ka të paktën disa konstante që i gjej tek secili syresh që na drejtohet thjesht me shprehje vlerësimin a respektin për ty: qytetar model, civil, korrekt, skrupoloz, profesional, pasional, erudit e sidomos i pajisun me një bujari unike intelektuale. Më beso shpirt se arrijnë me mbajtë mend edhe librat që iu ke huajtë, bibliografitë që iu ke kalu, projektet e jetës në të cilat janë hedhë e që mbajnë gjurmën e fjalës tande në zanafillë. E pra, unë e di tashma që nuk ndodhë thuejse kurrë që dijenitë e një jete të kalueme me studim, kërkim e sistemim ditunish, t'i kalohen kaq lehtësisht tjetrit. E unë kam kenë dëshmitare e këtyne skenave të panumërta e, n'rast se atëherë më dukej normale, sot e vlerësoj si modelin ma të vyer që na ke lanë. Ua kthej falenderimet e mirënjohjen, por shpirt, nuk e din sa e vështirë asht me u marrë me sistemimin

sikur edhe të epistularit tand që qysh në ikje tande nga jeta kur atëherë numëronte gati 5000 letra, paramendo sot!

Mbaj mend e më janë ngulitë në kokë si leitmotiv i memories teme të gjallë, shqetësimi jot për veprat e pabotueme tuejat, për veprën studimore për Mjedjen që ta kishin “djegë e çu për karton” (shprehja jote), fryt i sa viteve punë, fill sapo e kishe mbaru e ia kishe dorëzue shtypshkronjës; njëjtë për veprën monografike për Konicën që përpos se të ndalohet me viju punën që ishte fillu tashma, edhe botimi në SHBA mbas 1990 del i cinguem; njëjtë për veprën e shumëve dekadave punë për mbledhjen e shkrimeve me karakter filologjik, historik e publicistik të De Radës që mbetë fjetë në Akademi të Shkencave për ma shumë se një dekadë e nuk u botu prej tyne; njëjtë për Historinë e Albanologjisë vëllimin e dytë; njëjtë për Studimet arbëreshe...Ti na i ke lanë me shkrim e me gojë porositë e tueja testamentare e sot mund të tham se veprën e plotë për Konicën e botuem; po kështu edhe Veprat historike filologjike të De Radës; po kështu, shpejt ka me dalë edhe një tjetër botim i joti. Shiko, nuk asht puna se na “duhet” me mbajtë fjalën para tejet si prind; jo, na dy vajzat tueja jena të binduna se DUHET me i botu për një arsye që i kapërcen caqet e thjesht një dashnije për prindin: këto studime janë një e Mirë Publike e si të tilla na kemi detyrimin me u marrë me to. Veç ta dish sa e vështirë asht për ne, jo aq për kohën, mundin, a shpenzimin për botimin e tyne, por për faktin se punojmë me një përgjegjësi të dyfishtë kur bahet fjala për veprat tueja. Sa të mundemi fizikisht e mendërisht, nuk do ta ndalim këtë punë. E kur të mos jemi na ma në jetë, kanë me qenë nipi e mbesa, të jesh i qetë. Ndërgjegjësimi i tyne për këtë “barre”, asht i plotë, le që për fat ti ke arritë me ua dallu karakteristikat e tyne qyshse ishin fëmi. Mundem me të thanë se ndoshta ata kanë dalë përtej parashikimit tand e tonit. E n'rast se kam një prehje në shpirt, më vjen prej kësaj sigurie.

22 shtator 2003. Ishte dita e fundit e jetës tande. Unë nuk isha as me ty, as në Shqipëri. Kisha një muaj që ndodhesha në Hollandë për një kurs diplomacieje. Institutit Clingendael i Hagës pranë të cilit ndiqsha kursin, atë ditë na kishte nisë për të ndjekë leksionet në Universitetin e Maastricht-it, 272 km larg Hagës. Ishte ora 10 e mëngjesit, ndodhesha në sallën e leksioneve. Bie zilja e celularit, ishte ime motër, Bardha. Dal jashtë me një shtypje në gjoks. E ndjeja. Me avash më thotë që ti nuk ishe mirë, që temperatura nuk zbriste prej dy ditësh. Më

tha që ndoshta ishte mirë të nisesha... Motra tjetër, Mira, e besuemja jote e përjetshme, ajo që të kishte ndejtë mbi krye ditë e natë, me muej e vite, e kujdesshme si gjithmonë, nuk kishte dashtë me më trazue. E shushatun, e kalamendun, i marr leje profesorit dhe nisem për nga stacioni i trenit. Me autobuz do të duheshin disa orë të mira me mbërritë në Hagë, me tren diçka ma pak. Në një gjendje kaosi, trazimi e dridhjeje në trup, futem në vagon pa pre biletën. Isha vetëm në sedilje. E shkrehun nga mungesa e të tjerëve në skompartiment, i jap rrugë vajit të mbledhun. Jashtë xhamave mbretonte një kohë e vranët, e ftoftë, e idhtë siç ishin tana ditët thuejse në atë vend. Pa asnjë rregull në kokë, midis vajit me zâ, isha tuj mendu a thu e kishe lexu letrën e një foto që t'i kisha nisë pak ditë ma parë nga Amsterdam (letra ka mbërritë mbas ikjes tande, mora vesh). Kisha vizitu *Rijksmuseum* të Amsterdamit ku kisha fotografu vedin para kuadrit *Caritas romana* të Rubensit me qëllimin me ta nisë ty. Kishte edhe një letër me një përshkrim temin emocional nga vizita aty dhe të premtosha që sa të kthehesha do ta flisnim bashkë. Tuj mos i dhanë formë asnjë ndjesie në ato momente, nuk e ndigjoj kontrollorin e biletave. Kurrë nuk do ta harroj finesën e atij burrë. Kishte ndejtë në krah temin, pa m'u drejtu me fjalinë e zakonshme: biletën, ju lutem. Ktheva kryet vrikthi. Me siguri që pamja jeme e shpërfytyrueme, e shtyu me më thanë: nuk po ju shqetësoj. Nuk më pyeti as pse isha ashtu, pyetje të cilës tash që e mendoj, nuk do të kisha mujtë me iu përgjigjë saktë sepse nuk kisha mbërritë me e realizu mendërisht ngjarjen, jo ma me e artikulu - kam humbë babën. Kujtoj si në jerm vrapimin në Institut, kërkësen zyrtare për largim, prerjen e biletës së avionit që nuk kishte atë ditë fluturim, por të nesërmen, tranzit. Një përqindje krejt e vogël iluzioni më mbante pezull me shpresën se do t'ia mbërrija me të përqaftu të ngrohtë... Pjesa rationale më shkulte përposhtë e më fuste ankhin që përpjekja jeme me të gjetë gjallë, nuk do të realizohej. Miqtë e mi të shtënjtë, Alketi, Xhuli, rrinin me mu atë natë që nuk mbaronte. Hagë - Bologna - Tiranë. Aeroporti Tiranë e kthim në Shkodër. Ti nuk ishe ma qysh një ditë ma parë mbasdite. Kishin shty për në darkë vonë ceremoninë mortore. Ishte e para herë në jetë që unë hyjshe në shtëpi e ti nuk më flisje. Gjeta Nanin, e paralizueme prej 3 vitesh tashma nga njëra pjesë e trupit që edhe në atë gjendje ekstreme të sajën, e përmbledhun, murmurin, pa lotë: po tash? Ishte ma e thukta frazë që përmblidhte pakuptueshmërinë e jetës së saj tash e mbrapa. Rrugëtimi juej bashkë, kishte kapë mbi gjysmë shekulli. Mbas nja një viti nga ndarja jote kam vendosë arësjetimin mbi ngjarjen; prindërit ikin të parët, zakonisht e fatmirësisht. Mjerë kush provon të kundërtën! Për mu përbante herën e parë. Nuk isha e pajisun me kulturën e besimit për botën e përtejme. Kjo ma vështirësonte pranimin e faktit, aq ma shumë përpunimin e tij. Por më ka prevalu mendimi e bindja që tek e fundit jeta jote kishte qenë e mbushun plot me pasione, punë, bukuri, dashni familjeje. Kishe përmbyllë një cikël në mënyrën ma intensive të mundshme. Këtu gjeta prehje. Edhe sot kur vij me ju vizitu në varreza, ty, Nanin, motrën Bardha, teze Zanën, tek motra 46 vjeçare nuk di me folë lirshëm. Nuk e kam pranue. Sa fat që ti e Nani nuk ishit ma në jetë kur Bardha ndërroi jetë. Tek ti flas qetë e me bindje, pavarësisht bindjeve të mija për botën tjetër, bindje që mbas humbjes të motrës kanë marrë forma të tjera... Ty të tregoj e të tregohem, në paqe. Edhe sot du me të tregu se nuk më doli parashikimi publik që në ditën e 100 vjetorit me ardhë te shtrati jot e me të puthë e me të thanë se e mbajta fjalën. Sot du me ta folë shpirtin tem, e publikut tandin. Të rroku krejt, jeta jeme!

Diana

Libri i fundit i Kadarese "Kur sunduesit Lgrinden", na dëshmon përsëri se shkrimtari ynë i madh është i vetmi artist që arrin të identifikohet me kulmin e artit të shkruar në shqip, dhe, duke qenë kështu, tek ai, ose te vepra e tij, në mënyrë fare të natyrshme, identifikohemi të gjithë.

Çdo libër i shkruar prej tij, si më parë, edhe sot, bëhet menjëherë pjesë e kënaqësisë sonë kolektive dhe na përshkon të gjithëve si të ishte një i ftohtë marsi ose si një ndriçim dielli me ato rreze që vetëm një letërsi e madhe është në gjendje të lëshojë.

Kur lexon Kadarenë, të duket se je duke vazhduar leximin e një vepre që ke nisur prej kohësh dhe nuk po e mbaron dot, të duket sikur ti po rindërton urat me një tekst që e ke lënë përgjysmë.

Ashtu siç e sqaron edhe vetë në nëntitull, në këtë libër, ai merret me një nga ngjarjet më të bujshme socioletrare të shekullit të kaluar që ka ndodhur në Rusinë Sovjetike të Stalinit. Është një bisedë triminutëshe, ose edhe pak sekonda më shumë, e diktatorit më të përgjakshëm komunist, Stalin, me poetin e famshëm dhe shkrimtarin Boris Pastërnak, autorin e romanit "Doktor Zhivago" që fitoi Nobelin në vitin 1958, çmim që autori nuk e mori, pra, nuk e tërhoqi nga juria që të mos detyrohej ta përzinin nga atdheu i tij, Bashkimi Sovjetik.

Biseda telefonike mes Stalinit dhe Pastërnakut ka ndodhur më 23 qershor 1934 dhe ky është një fakt historik. Objekti i bisedës ka qenë poeti Osip Mandelshtam, i cili ishte arrestuar sepse, mes miqsh e shokësh, recitonte një trivargësh në të cilin për Stalinit thoshte "Maloku i Kremlin".

Mandelshtami ishte një poet i madh po aq sa Pastërnaku, ishte dhe mik i tij, madje shok i ngushtë për ata që i shihnin bashkë. Për këtë bisedë, e cila asnjëherë nuk u mor vesh se si ishte zhvilluar, çfarë ishte thënë konkretisht dhe çfarë kishte kumtuar Stalini e çfarë i ishte përgjigjur Pastërnaku, janë shkruar dhjetëra libra e qindra tekste të ndryshme.

Fati i Mandelshtamit dihet. Ai vdiq në burg, por jo për këtë trivargësh, vdiq më vonë në arrestimin e dytë, pasi kishte shkruar një ode që e mburrte Stalini dhe e bënte të madh sa një "car". Por, kjo është një histori tjetër.

Shënime për veprën "Kur sunduesit grinden (Rreth misterit të telefonimit Stalin-Pastërnak)"

Kadare, Chronotope-ja që ka ngrirë tri minutë të një epoke

Nga Ilir Yzeiri

Me anë të kësaj sprove, që të kujton romanin filozofik të shekullit XIX apo letërsinë integrale që përfshin rrëfimin imagjativ, aktualizimin e të vërtetave që nuk jetojnë, por që rrinë të fshehura në emocionet kolektive dhe që shtresohen pastaj në vepra të mëdha tragjike, Kadareja na rrëfen për një hapësirë dhe një kohë të ngrirë në kujtesën botërore, e cila, realisht, ka ndodhur më 23 qershor 1934, dhe që është vetëm tri minuta. Kjo, si të thuash, është ekzgjekja ose e vërteta historike. Diegjeza, ose e vërteta artistike, natyrisht nuk është aq, nuk është vetëm tri minuta, aty brenda, në atë bisedë telefonike, ndodhet një epokë e tërë që karakterizohet nga terrori dhe nga krimi shtetëror.

Pikërisht këtë ngrirje të kohës me hapësirën, që është tipar themelor i estetikës së romanit, Bahtin, një studiues tjetër i famshëm rus, e quan "chronotop".

Kadareja është treguar i kujdesshëm dhe nuk e ka cilësuar librin e tij, e ka lënë, si të thuash, pa gjini, as roman, as novelë, as përsiatje, as...as. Mesa duket, lexuesi është i lirë që ta vendosë ku të dojë, në cilindo raft të gjinive apo llojeve letrare që ai mendon

ose do t'i duhet të shpikë vetë një të tillë, sepse, nëse do të ndjekë modelin e rafteve në bibliotekë, do t'i duhet që ta lëvizë nëpër të gjitha ato, ngaqë ky libër i ka të gjitha cilësitë e rafteve që përmendëm. Nuk ka as tryezë lënde në fund, as në fillimi.

Nis pjesa e parë.

Është rikthimi i Kadarese në Rusi pas gati 50 vjetësh. Viti 2010. "Stacioni ndodhet në trotuarin e djathtë. Numri i trolejbusit është tre. Do të vazhdosh rrugën gjer në sheshin Pushkin" (f. 7). Fillin e këtij rrëfimi pastaj e merr rrëfimtari, ai që, herë është autori vetë, dhe herë është fantazma e tij e cila, më së shumti, ka udhëtuar në ëndërr në këtë qytet. Ndërsa ne, lexuesit, mendojmë menjëherë një nga novelat e famshme "Muzgu i perëndive të stepës" dhe aty, sidomos fati i Pastërnakut, lotët e studentes bionde që dëgjonte të sharat dhe fyerjet ndaj Pastërnakut, na kalojnë me shpejtësi si reklama e një filmi që ka në sfond vdekjen.


Mirëpo, tani rrëfimi nuk është linear, ai ndërtohet me pandehma nga ato që asnjëherë nuk marrin përgjigje. Kadareja sikur nis të na lexojë një tekst të



padeshifrueshëm deri atëherë për të. Ja shtatorja e Pushkinit me nënshkrimin « ... exegi monumentum... » – një monument unë ngrita dhe dualiteti ose dyjësia mes poetit dhe carit, mes poetit dhe tiranit. Duke ecur në rrugët e Moskës së vitit 2010, atij i turbullohet shikimi dhe kthehet 50 vjet më pas. Në Moskë vazhdojnë mitingjet për dënimin e Pastërnakut, në Tiranë vazhdonte fushata për njohjen e jetës. Dhe tani, kohët nisin e ngatërrohen, hapësirat gjithashtu. Në mitingun në Moskë i duket sikur dikush mbante dhe një pankartë kundër tij. Pastaj një vajzë e përbotur sikur i thotë po ti, ulërije në atë miting. Jo, unë shihja një vajzë të përbotur, pastaj miqtë e tij, Stullpans e Anteos gati tromaksen kur marrin vesh se edhe atij në Tiranë i kishte telefonuar Enver Hoxha. Po, po, kishte ndodhur vërtet. Ishte mesditë dhe unë nuk arrita të them asgjë veç fjalës "Faleminderit!".

Ky rrëfim në dy kohë dhe me të vdekur e të gjallë bashkë, përdoret si sfond për të dhënë përjasjen e dy botëve, asaj ruse dhe asaj shqiptare dhe fatin e poetit apo raportin e tij me sunduesin. Biseda triminutëshe, në thelb të së cilës ishte pyetja e Stalinit për Mandelshtamin, pra në formën: ç'mendon për Mandelshtamin, transformohet në një sintagmë më të gjerë dhe, ashtu siç është zakon në stilin magjik të Kadarese, kalon nga një skenë tragjike në një tjetër dhe bëhet: ç'mendim ke për Poradecin, për Kutelin.

Pastaj vjen pyetja tjetër fatale ç'mendim ke për Pastërnakun? Rindërtimi i atmosferës së nderë para dhe pas botimit të « Perëndimit të muzgut të stepës » vë përballë ose shtresëzon dy realitete, atë rus dhe atë shqiptar dhe në qendër është ai, Boris Pastërnak dhe pyetja fatale që i kishte bërë Stalini: ç'mendon ti për Mandelshtamin? Pastaj hutimi i tij, përgjigja që ne jemi të ndryshëm dhe tjetri nga ana e kundërt e telefonit se ne bolshevikët i mbrojmë shokët apo diçka të ngjashme. Mirëpo, nuk është vetëm kjo, fati i Pastërnakut dhe lejimi apo, më shumë, moslejimi i përmendjes së tij në Shqipëri, e kanë munduar shkrimtarin në gjithë këta vjet dhe tani, si për të shlyer një peng të mbytur në vitet e mohimit, ai nis të rindërtojë figurën e tij duke filluar nga ajo bisedë. Kadareja tregon se edhe përfshirja e Pastërnakut në novelën e Muzgut ishte një gjë e paimagjinueshme, sepse, pas emrit të tij ishte Nobeli, mallkimi për shkrimtarët që jetonin në Moskë apo në Tiranë. Udhëtimi i Pastërnakut në Tiranë përmes një ure që kishte tri harqe dhe lotët e një vajze që qante në mitingun kundër Pastërnakut në Institutin Gorki dhe pastaj vargjet e Pashko Vasës « kjani ju varza, kjani ju gra, me ata sy të bukur qi dini me kja ». Kaq doja të thoja për Pastërnakun sikur i rrëfëhet autori redaktorit Dy herë Dilaver. Duke rrëfyer tekstin e censurës së botimit në Shqipëri, Kadareja përdor stilin e karnevalit dhe na vizaton një botë që është e mbërthyer me personazhe butaforike që veprojnë sipas



kurbës së emocionit të tiranit. Hallka pa fund dhe zyra që e bëjnë redaktorin e shkrëtë ose atë që me shaka i thoshim Dy herë Dilaver, siç thotë Kadareja (emri i redaktorit të librit «Ura me tri Harqe» ishte Dilaver Dilaveri), të dridhej.

Pjesa e parë e librit është një vazhdim i shkruar në një kohë tjetër i novelës së famshme «Muzgu i perëndive të stepës», është, si të thuash, zgjerim i linjës së subjektivit që lidhet me fatin e Pastërnakut dhe të shkrimtarit që rrëfen për të. Është, në një farë mënyrë, një udhëtim në kundër kohë i Pastërnakut në Tiranë, udhëtim që zbulohet nga vizita e dytë e Kadaresë në Moskë pas plot pesëdhjetë vjetëve.

Pjesa e dytë e romanit niste përsëri nga një e vërtetë historike. Në vitin 2015, një ditë, në banesën e Kadaresë në Paris kishte trokitur në derë, as më shumë e as më pak, por Irina Emeljanova, vajza bionde e romanit të Kadaresë që mbushte sytë me lot kur turmat shanin dhe fyenin Pastërnakun. Dhe a mund ta merrte me mend Irina se Kadare, në ato çaste, po shkruante pikërisht për ato tri minutat e bisedës së Stalinit me Pastërnakun? Unë, thotë Kadareja, kisha dëgjuar për to në muajin tim të parë të qëndrimit në Moskë, në moshën 22 vjeçare.

Ishin gjendur, pra, në një ditë ata të tre, Pastërnaku, Mandelshtami dhe tirani në mes. Çfarë kishte ndodhur? E kishin vënë poshtë tiranin, e kishin mundur apo tirani me dredhi i kishte përçarë? Legjenda thoshte se Pastërnaku e kishte lënë në baltë shokun e vet. Mandelshtami e kishte quajtur «maloku i Kremilit», për Pastërnakun thuhej se e kishte përshkruar si një xhuxh me trup katërbëdhjetëvjeçari dhe fytyrë burri vjetran.

Ky triminutësh po zbërthehej sekondë pas sekonde në të gjithë globin. Dhe autori na tregon se kishte arritur të përzgjidhte trembëdhjetë versione të kësaj bisede.

Ishte një ditë qershori dhe Osip Mandelshtami sapo ishte arrestuar. Më tej, rrëfimi na hedh në një përsiatje të gjatë mes fatit të poetit dhe fatit të tiranit. Pushkini ndodhet gjithmonë në mes dhe vargu i tij i famshëm «një monument të gdhendur jo duarsh i ngrita vetes» është versioni më i pranueshëm i një teksti të pamundur për t'u përktlyer për shkak të një fjale që në shqip vështirë të gjendet.

Pjesa e tretë është një lloj protokoll i imagjinativ për numrin e versioneve të bisedës, të cilat mund të jenë bërë aq dhe jo më shumë edhe për shkak të librave të shumtë që autori ka konsultuar.

Po pse numri trembëdhjetë? Ndoshta ngë rrëfimi bibliq? Ndoshta...

Versioni i parë zbërthen autorësinë dhe na tregon se sekretari i Stalinit i ka telefonuar Pastërnakut dhe i thotë se ç'mendon për Mandelshtamin. Përgjigja e Pastërnakut është se unë pak e njoh atë, ai është akmeist, unë i përkas një rryme tjetër kështu që s'mund të them asgjë për Mandelshtamin dhe përgjigja e Stalinit: ju jini një shok shumë i keq, shoku Pastërnak, paska thënë Stalini dhe paska mbyllur telefonin.

Version i dytë merret me kohën, pra se kur mund të ketë ndodhur, në arrestimin e parë apo në të dytin apo në mes dhe rrëfimet tani bazohen mbi kujtime personazhesh të ndyshme, nga mbesa e Çajkovskit, që thuhej se ishte e dashura e Pastërnakut e deri të gruaja e tij.

Në versionin e tretë është një regjistrim i disa njerëzve të letrave dhe këtu nis të hapet një çështje e persekutimit etik të shkrimtarëve që lidhet me aureolën e tyre. Këtë aureolë e kanë ata apo princërit që më pas bëhen prijës, ndërsa shkrimtarët nuk janë gjë tjetër vetëm se disa njerëz që shkruajnë nën efektin e halucinacioneve dhe bredhin pas grave. Këtu autori hap një tjetër parantezë të dhimbshme, atë të kalimit të shkrimtarëve nga epoka borgjeze në atë komuniste, dhe krimi shtetëror mbi

mjaft shkrimtarë dhe demistifikimi i tyre si sfond. Fati i Lazgushit apo i Kutelit në Shqipëri.

Versioni i katërt është ai i një njeriu tjetër të letrave i cili, duke ngatërruar kohët bën që të krijohej një pëstjellim makabër të cilin Kadareja e shpreh në mënyrë të mrekullueshme «... s'kishte ndodhur askund veç gjatë revolucionit të mëvonshëm kulturor kinez, që një i arrestuar të arrestohej prapë brenda arrestimit...Kjo ishte si të thoje që një i vdekur të vdiste brenda vdekjes» (f. 92).

Në versionin e pestë del emri i një poetjeje tjetër, Ana Ahmatovës dhe letra e saj për të shpëtuar djalin, ashtu si letra e Kadaresë për të shpëtuar motrën që mund të arrestohej.

Versioni i gjatë është i gruas, Zinaidës, që ishte shumë e përkushtuar ndaj burrit, por edhe ndaj sovjetizmit, ndoshta për të shpëtuar burrin.

Në versionin e shtatë rimerret përsëri Ana Ahmatova shkrimtarja më e mitizuar që ishte vizatuar nga Modigliani në një kafe të Parisit, «gjysmë murgeshë dhe gjysmë lavire» sipas Zhdanovit, Ana e Ruisë, që mendohej se disa nga poezitë e saj i kishte shkruar kur kishte vdekur, thotë Kadareja. Ajo shton se Pastërnaku kishte dashur të fliste me Stalinin për jetën dhe vdekjen, por ai e kishte mbyllur telefonin. Ana Ahmatova mund të ishte gruaja e tretë e Pastërnakut. Por kjo ishte mblesëri popujsh apo vetëm një flirt?

Pastaj është versioni i tetë, ai i Nadjas gruas së Mandelshtamit martir. Këtu rifutet një takim imagjinuar me Stullpanzin e vdekur, shkrimtarin letonez të «Muzgut...» dhe rrëfimi i tij për vdekjen nga sifilizi i Leninit apo Josif Sifilizoviç Stalin, siç e parodizon me mjeshtëri Kadareja personazhin apo personazhet e tiranisë.

Në versionin e nëntë është një grua, Zinaida Akatanova, aktore, e cila lë të fejuarin, një pianist, dhe shkon me Pastërnakun. Skena që vizaton Kadare, është e magjishme. Burri i saj po luan në piano, por në fund ai shemb kokën në tastierë, sepse gruaja e tij Zianida po e lë. Edhe Pastërnaku është në sallë edhe ai po qan, ka lot me shije tjetër nga ato të pianistit dhe rrëfimi shpërthen. Nis të hapet aty poetika e grave në letërsi që fillon me Helenën, me Beatricën, me Dylqinjën, histori që kanë të përbashkët vetëm një gjë: ëndrën. Danteja e pa dy herë Beatricën; Dylqinjën, Don Kishoti asnjëherë nuk e takoi, por ato kanë mbetur historitë më të famshme të dashurisë. Edhe në rrëfimet për episodin triminutësh të Pastërnakut me Stalinin ka shumë gra.

Versioni i njëmbëdhjetë është i filozofit Izaiah Berlin, i cili kishte kaluar një natë pa gjumë me Ana Ahmatovën. Versioni i dybëdhjetë mbështetet në rrëfimin e një studiuesi të lidhjeve të KGB-së me artistët dhe këtu triminutëshu zbërthehej me anë të helmit mbi poetin dhe të tmerrit që kishin tiranët për ta.

Në sfond është historia e Senekës me Neronin. Seneka që pret damarët në banjën e ngrohtë që t'i japë fund jetës dhe Neroni përbindësh, që pret lloj-lloj spiunësh e hafijesh që i tregojnë se vdekja e poetit po kryhet ngadalë dhe ëmbël.

Dhe versioni i trembëdhjetë është versioni epilodal. Autori thotë se Mandelshtami ose fati i poetit është i pafundmë në kohë. Tri minuta mjaftojnë që të mbahet gjallë historia e një poeti që sfidon gjithë sunduesit që ka përballë. Kjo dyjësia, siç thotë Kadareja, ka shenjuar artin klasik dhe ka shërbyer si skenë për gjigandët e mëdhenj të fjalës, siç edhe është Kadareja ynë.

Ndërsa në fund, ti e ke të vështirë të kuptosh nëse Pastërnaku është Kadare, apo Kadareja është i futur në të, apo të dy bashkë, si në ëndërr, përpiqen të na tregojnë enigmën e pazgjdhshme të fatit të tiranit dhe poetit...

IN MEMORIAM

REQUIEM PËR LINDITA AHMETIN

Nga Nurie Emrullai

Që nga dje, e sotshme do të jetë krejtësisht ndryshe... Ndryshe do të jetë tashmë takimi me miqtë, ndryshe do të jenë bisedat me profesorët, ndryshe do të jenë ligjeratat me studentët, ndryshe do të jetë kritika jonë letrare. Në gjithçka që na rrethon është hapur një vrimë, si ajo *Vrima e zezë* që "këndova" dy javë më parë këtu...

Është hapur vrimë që na e ka gllabëruar krahu tonë të fuqishëm, atë që e kishim shembull, që e kishim motiv e që e kishim shtyllë...

Lindita Ahmeti lidhi shpirtin e saj për poezinë, ndonëse fizikisht nuk është me ne.

Linditën e kam takuar disa herë gjatë studimeve dhe pas asaj kohe më shumë kanë qenë takime mes miqsh. Lindita kishte gjithçka të veçantë, që nga mënyra se si ajo vështronte të tjerët kur i drejtoheshin, me atë kërrshëri të pamatë dhe me një mirësi krejtësisht të pastër, sa ngrohtësisht e priste çdo fjalë me buzëqeshjen që i ravijëzohej nëpër gjithë fytyrën dhe kjo ndodhte kështu deri në momentin kur ajo fillonte të lexonte ndonjë prej poezive të saj... Në atë çast si një lloj rituali, zëri i saj drithëruet, nuk ishte më i njëjti me atë që pak minuta më parë na kishte folur, por ishte një zë ardhur prej lashtësisë, nga atje ku sa herë përmes poezisë së saj na ka treguar që i flente shpirti në antikitet, me një peshë që na e rëndonte dhe na e lehtësonte ajrin përreth, që na trazonte e na ngjallte përnjëherë.

Kurrë nuk do ta harroj mënyrën se si ajo interpretonte apo thënë më mirë se si ajo i ngjallte poezitë e saj e për njëmend ishte krahet e Irisit...

Por, përsëri më vjen ndër mend fjala zbrazëti, një zbrazëti që m'u krijua pse prej madhësisë që ndjeja ndaj saj, kujtoj se shumë pak arrita t'ia shpreh admirimin, respektin dhe dashurinë që e kisha ndaj

krijimtarisë së saj, po kështu më ndodh rëndom kur gjendem pranë dikujt që mendoj se fjalët e zbehin atë që ndjehet, sepse gjithmonë mendoja se do të vinte koha e duhur për t'ia thënë e unë do ta besoja veten se jam e denjë për t'ia thënë.

Gjatë studimeve, bisedat tona për letërsinë kurrë nuk fillonin pa mos u referuar në ndonjë varg të krijimtarisë së saj ose nga ndonjë vepër që Lindita e kishte përktlyer dhe për këtë u jam shumë mirënjohëse profesorëve dhe gjithë atyre, që na njoftuan dhe afruan me poeten tonë më të mirë. Lindita na mësoi ta duam jetën pavarësisht me çfarë pengesash mësohem të jetojmë, e të dimë të mbahemi fort pas saj edhe kur gjithçka na ik prej duarsh. Natyra e saj e qetë, tepër kureshtare dhe kurrë mohuese na ofronte vazhdimisht pranë për ta kundruar ndritësimin që e rrethonte...

Lindita jonë e dashur, ti ishe krenaria jonë, ti ishe ambasadore e fjalës, ti na e hape rrugën të gjithëve, ti tregove se dhe këndeje flejnë muzat dhe sa gjallënisht rojnë mbi ne e në ne.

Linditë e dashur, jo më larg se ditën e kobshme të ikjes tënde, të shkrova për të më përktlyer disa poezi, sepse t'i ishe njohëse e mirë e shumë gjuhëve dhe gjithnjë ne referoheshim te ty. Dhe prita gjithë pasditen që të merrja një konfirmim prej teje... por... si gur i rënë prej qielli ra ai lajm...

Poezia jote do të mbetet nga më të bukurat shenja që denjon të theksojë se arti është më i bukuri shpëtimtar i këtij realiteti të patrajtë, e mbi të gjitha e ndjej të nevojshme të të them Lindita, falemnderit që na e fale emocionin tënd, vërtetësinë tënde, të papërsëritshmen vete...

I pavdekshëm do të jetë kujtimi për ty!



I. ARKETIPI

Duke u mbështetur në teorinë e psikoanalistit zvicërisht Karl Gustav Jung, mundë të themi se: *"Hajria nuk u bë Heroinë vetëm duke imagjinuar të mirat, ajo u bë Malësore (heroinë e romanit) vetëm për shkak se i ka kundërshtuar veprimet e shëmtuara!..."*

Arketipi,² është pjesë e pavetëdijës kolektive,³ dhe ka kuptimin e fillimit, trajtës, tipit që formohet në gjenezë, d.m.th. ekzemplari i parë - origjinali,⁴ ndërsa në gjuhësi ka kuptimin *"trajta fillestare më e vjetër e një fjale nga e cila krijohen fjalë të përbëra (kompozita) kuptimi fillestar i fjalëve"*.⁵ Në planin letrar, kemi të bëjmë me aspekte, natyrore - organike, logjike - shkakore, historike - rendi dhe uniteti i komplotit, që i bie diçka në midis *"të vetëdijshmes dhe pavetëdijës"*,⁶ të gjithë këta parametra e kanë përcaktuar dramën e ngjarjes në romanin *Malësorja*, të Nazmi Rrahmanit, pasi: *"E para lejon lirinë, qartësinë, indiferencën, e dyta zgjon pritje, padurim, interes patolgjik"*, dhe të gjitha këto përbëjnë mozaikun e vlerës letrare për të cilën ne po angazhohemi.

I.1. Përkufizimi letrar i nocionit «Arketip»⁷

Arketipat janë mënyra në të cilat shprehjen një sërë përvojash dhe kujtimeve në lidhje me paraardhësit. Me fjalë të tjera, secili personazh zhvillon një seri arketipash, varësisht prej rastit dhe çastit. Në këtë mënyrë, arketipat e romanit *Malësorja*, kanë mbrojtur idenë kryesore të veprës, *(braktisjen e dogmave)*, nëpërmes veprimt që kategorizohet si pavetëdije e turmës kundër individit. Parë nga ky prizëm, të gjitha personazhet e romanit *Malësorja*, u referohen tipareve të përbashkëta mendore, të cilat zhvillohen proporcionalisht dhe në raport me rrethanat e ngjarjes kanë ndikuar në vetëdijësimin e Hajries.⁸ Një nga pasionet më të mëdha të Karl Gustav Jungut, ishte arkeologjia dhe ky pasion ndoshta rezultoi në vetëdijen e tij, për të nxjerrë teorinë rreth arketipave si struktura ekzistuese dhe universale në pavetëdijen njerëzore.⁹

Tamam, ashtu siç e kemi thënë edhe më parë, *Arketipi*,¹⁰ më shumë ka të bëjë me atë çfarë krijohet në fillim, d.m.th. me origjinën, për të sjajuar pastaj modelin që do të ketë trajtë e formë të subjektit me kompozitat e tij.¹¹

¹ Pajazit Nushi, "Fjalor shpjegues i psikanalizës," ASHAK, Prishtinë 2010, faqe 39.
² Pajazit Nushi, "Leksikon i psikologjisë, Vëllimi I", botoi ASHAK, Prishtinë 2014, faqe 66.

³ Arketipi, ἀρχέτυπον - çfarë krijohet në fillim ἀρχή (archē) = fillimi / origjina + (archetupon) + τύπος (typos) = modeli / tipi / patterni. https://www.google.com/amp/s/www.pinterest.de/amp/kathrin_sievers/archetyp/
⁴ Kathrin Sievers, "Archetyp - Arketipi", <https://www.pinterest.de/amp/kathrin>.

⁵ Carl Golden, "The 12 Common Archetypes", Tree of Life Counseling. http://www.treeoflifecounseling.life/essays/the_12_common_archetypes.html

⁶ Christa Lackner, "Der Archetypus der Persephone in der Literatur - Personifikimi i arketipit në letërsi", Psychologie Alpen-Adria-Universität Klagenfurt, Fakultät für Kulturwissenschaften, Institut für Psychologie, D-Klagenfurt Jänner 2010.

⁷ "Fjalor i fjalëve të huaja", botoi Rilindja, Prishtinë, 1988, faqe 47.

⁸ Mikel Ndreca, "Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe", Toena, Tiranë 2007, faqe 48.

⁹ Po aty, Christa Lackner, "Der Archetypus der Persephone in der Literatur - Personifikimi i arketipit në letërsi..."

¹⁰ Krahajo: Viola Isufaj, "Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë", botoi "Onufri", Tiranë 2013.
¹¹ Krahajo: P. Nushi, "Fjalor shpjegues i psikanalizës," ASHAK, Prishtinë 2010, faqe 39-40.

¹² Zymer Mehani, "Figura e femrës në disa romane të shkrimtarëve shqiptarë", Zemra Shqiptare, 03.12.2017.

¹³ "Die Persönlichkeitstheorie nach Carl Gustav Jung", Gedankenwelt, 04 september, 2017. <https://gedankenwelt.de/die-persoennlichkeitstheorie-nach-carl-gustav-jung/>

¹⁴ "Die 12 Archetypen nach Carl Gustav Jung", në Gedankenwelt, 29.03.2019. <https://gedankenwelt.de/die-12-archetypen-nach-carl-gustav-jung/>

¹⁵ Po aty, Arketipi...
¹⁶ Mikel Ndreca, "Fjalor fjalësh të huaja në gjuhën shqipe", Toena, Tiranë 2007, fq. 48.

Romani "Malësorja" i shkrimtarit Nazmi Rrahmani

ARKETIPI DHE PAVETËDIJA KOLEKTIVE


fragment studimi nga Shefqet Dibrani

I.2. Arketipat e Karl Gustav Jungut

Arketipat e Karl Jungut, janë forma-modelle universale, d.m.th. pjesë e pavetëdijës kolektive, një homologim psikik i instinktit. E "kjo pavetëdije kolektive nuk zhvillohet individualisht, por trashëgohet. Ajo përbëhet nga forma paraardhëse, arketipat që vetëm në një formë të dytë bëhen të ndërgjegjshëm dhe u japin një formë të caktuar elementëve të psikikës."¹² Si duket ato kanë të bëjnë me imazhin e dukurive, dhe me mënyrën e sjelljes së personazheve të cilët brenda atyre rrethanave ndërtojnë personalitetin, e pastaj nëpërmes tyre shpjegohen një varg imazhesh mendore, në varësi me këto personazhe që i ndeshim në romanin *Malësorja*. Edhe pse "arketipat nuk janë gjëra biologjike, ata janë më shumë kërkesa shpirtërore"¹³, ne besojmë se Hajria, ishte ajo gruaja e mençur, dhe padyshim ajo është heroina e veprës, *(kurse autori i ka dhënë epitetin Malësore)*, po ashtu arketipa të rëndësishëm brenda romanit janë edhe djemtë e saj, Aliu dhe Sabiti, sidomos në raport me nënën dhe qëllimin e saj kryesor për t'i braktisur zakonet dhe

¹² Carl G. Jung, "Psikologjia analitike" Shtëpia Botuese "Fan Noli" Tiranë, 2006, faqe 35-66. (Përgatiti Majlinda Cami, "Carl G. Jung - Koncepti i pavetëdijës kolektive", publikuar në Ikivi, Austri, nën përkujdesin e Fahri Xharrës.)

¹³ Mësuese Aurela, "Arketipi i nënës... sipas Karl Gustav Jung", Ese dhe projekte për studentët, 14 janar 2016. <https://www.facebook.com/ese.dhe.projekte/posts/1674722902805348/>



dogmat arkaike.¹⁴

Sipas Karl Jungut, arketipat janë forma që i japin imazh autonom personazheve, veprimi i të cilëve shijohet si proces i pavetëdijës kolektive, së këndejmi "arketipi është pjesë e pavetëdijës kolektive"¹⁵ pasi ata nuk kanë arritur të zhvillohen individualisht, ndonëse kanë gjeneruar ngjarje të shumta, kryesisht nëpërmes ndikimit të kontekstit sociokulturor *(zakoneve)*. Lloje të arketipave janë zhvilluar tek secili personazh i veprës në fjalë.¹⁶ Këto veti karakteristike, edhe për romanin *Malësorja*, barten nga personazhi në personazh, ose nga gjenerata në gjeneratë, për të krijuar vijimësinë arketipale, e përshtatshme për secilin personazh të romanit.

Në këto raste ndikimet kulturore dhe rrethanat patriarkale *(si zakone paraardhëse)* janë të pashmangshme, prandaj janë ndikues në arketipat e personalitetit të Hajries. Problemet që ishin grumbulluar, pa fajin e saj, kanë ndikuar në pavetëdijen

¹⁴ Shih; "Rezymeja e syzheut", nga prof. dr. Z. Rrahmani, Vepra e cituar, faqe 32-32.

¹⁵ Christa Lackner, "Der Archetypus der Persephone in der Literatur - Personifikimi i arketipit në letërsi", Psychologie Alpen-Adria-Universität Klagenfurt, Fakultät für Kulturwissenschaften, Institut für Psychologie, D-Klagenfurt Jänner 2010.

¹⁶ Jungsche Archetypen, „Definition, Eigenschaften und Typen, në "Warbleton Council." <https://sq.warbletoncouncil.org/arquetipos-de-jung-10809#menu-13>.

- Carl Golden, "The 12 Common Archetypes", Tree of Life Counseling. http://www.treeoflifecounseling.life/essays/the_12_common_archetypes.html

e personazheve, të cilët shpeshherë, nga pavetëdija, kanë përcaktuar sjelljen dhe vetëdijen psikike të Hajries, e pastaj edhe të tjerëve. E në anën tjetër *"drama individuale bëhet dramë dhe vdekje kolektive"*.¹⁷

Ndikimi i rrethit dhe i shoqërisë është i pashmangshëm në zhvillimin e arketipave që janë model i imazheve, edhe i simboleve, ato janë shfaqur si forma të pavetëdijës kolektive, dhe janë rezultat i zakonëve të kaluara, të cilat në formë imazhesh janë zbërthyer për gjatë ngjarjeve dhe ndodhive në romanin *Malësorja*. Vlen të theksohen disa nga bisedat dhe sjellja e personazheve, bashkë me reagimet e tyre, herëherë emocionale, kanë tipizuar disa nga mënyrat për t'i dalluar arketipat, dhe në raste të caktuara, arketipat me ngarkesë negative, janë të njohur për nxitje dhe intriga, prandaj aty ku ka pasur mundësi dhe janë izoluar, *(le të kujtohet izolimi që iu ka bërë Sabiti, për ta detyruar atë të heqë dorë nga gjakmarrje)*.

Për të dalluar më mirë se çfarë është arketipi Karl Jungu, pos të tjerash e ka marrë hijen dhe ka shqyrtuar ëndrrën, të cilat përfaqësojnë pavetëdijen e njeriut. Pra forma e njeriut e shndërruar në hije është një model arketipi, pastaj *"nga njëra anë, hija është një arketip që përfaqëson tërësinë e pavetëdijës. Së dyti, hija i referohet aspektit të pavetëdijshëm të personalitetit të njerëzve, karakterizuar nga tipare dhe qëndrime që egoja e vetëdijshme nuk i njeh si të vetat"*¹⁸ në anën tjetër Jungu mendon se «Burimi kryesor në një rast të tillë janë ëndrrat, të cilat e kanë këtë prioritet, sepse ato janë produkte jo derivate, spontane të psikikës së pavetëdijshme. Pikërisht ato janë vepra të pastra të natyrës që nuk mund të falsifikohen me asnjë lloj qëllimi të vetëdijshëm.»¹⁹ Në një aspekt tjetër ne i kemi edhe ëndrrat e Hajries të shprehura në romanin *Malësorja*, qoftë ato ëndërrime gjatë ditës për jetën e saj që nuk u jetua kurrë, ose ato ëndrrat reale sa ishte në gjumë, kur i paraqiteshin lugetërit ose momenti i fundosjes të të birit në ujin e turbullt të lumit të tërbuar dhe në atë momentin kur flaka e zjarrit po e përpinte edhe qenien e saj apatike. E sikur ta pyetnim tani Hajrien, a do të kishte mundësi t'i vërtetonte se cilët nga motivet e shfaqura në ëndrra, ajo i njihte, i përjetonte?! Shikuar nga ky prizëm, personazhet e romanit janë arketipa, ndërsa individit është antagonist ndaj hijes, ndaj ëndrrës, ndaj fenomeneve të tjera. Kjo do të thotë, se personazhi antagonist, i referohet aspektit të pavetëdijshëm të vetvetes që dikush dëshiron ta ndajë me të tjerët. Në këtë kuptim, edhe "uni" i individit është *"imazhi arketip i tërësisë"*, i përjetuar si një fuqi transpersonale që i jep rëndësi dhe kuptim jetës. Në shqyrtimin tonë, Hajria, edhe si nënë që ishte, përbën një imazh arketipal përmes së cilës zbulohet përkushtimi i saj deri në flimij që lidhen me amësinë,²⁰ pastaj *Malësorja*, si epitet, është figura më e rëndësishme që përfaqëson arketipin i cili i referohet imazhit të fuqisë së brendshme, e që karakterizohet nga luftimi i hijes *(pavetëdijës)* do të thotë nga ajo pjesë e pavetëdijës që vetëdija e refuzon. Pra, epiteti *Malësore*, është sinonim i Heroinës, është vlerë zakonore, së këndejmi është një arketip i romanit, që lufton me vendosmëri kundër hijes, dhe një mënyrë jo reflektuese, por spontane dhe me durim admirues. Në këtë kuptim, njeriu i mençur sjell reflektim dhe racionalitet në performancën e vet. *Malësorja*, epitet i zonës, por njëkohësisht Heroinë e romanit, karakterizohet nga

¹⁷ Anton Nikë Berisha, "Romanet e Nazmi Rrahmanit shqiptojnë një botë dramatike dhe tragjike", gazeta "Bota sot", 10 korrik 2018, Prishtinë, 2018.

¹⁸ Po aty, Warbleton Council. <https://sq.warbletoncouncil.org/arquetipos-de-jung-10809#menu-13>

¹⁹ Carl G. Jung, "Psikologjia analitike" Shtëpia Botuese "Fan Noli" Tiranë, 2006, faqe 35-66. (Përgatiti Majlinda Cami, "Carl G. Jung - Koncepti i pavetëdijës kolektive", publikuar në Ikivi, Austri, nën përkujdesin e Fahri Xharrës.)

²⁰ Po aty, Warbleton Council. <https://sq.warbletoncouncil.org/arquetipos-de-jung-10809#menu-13>

këto veti, ajo përmes mënyrës së sjelljes i ka zhvilluar dhe i ka përshtatur efektet e veprimtimit, kurse “ëndrra e saj është dimensionimi më magjik i së ardhmes dhe i shprehës për pafajësinë e saj”,²¹ në anën tjetër Malësorja është pikturimi realist i imazhit të karaktereve.²²

1.3. Arketipi, ose pavetëdija kolektive²³

Arketipat në romanin *Malësorja*, janë personazhe të mahnitshme, qofshin edhe si pavetëdije kolektive, ata janë elemente të fuqishme në prozën e shkrimtarit. Kuptimi i arketipave të futë më mirë në thellësinë e botëkuptimit të veprës, që është qasja më psikanalitike për fenomenet dhe proceset nëpër të cilën kalonte shoqëria. Leximi i kujdesshëm mundëson për t'i identifikuar më mirë arketipat, dhe në të njëjtën kohë për ta njohur më mirë edhe qëllimin e personazheve që pasqyrojnë historinë e trevës si sjellje universale e shoqërisë patriarkale.²⁴ Andaj, *Hija* përfaqëson pamjen e anës së errët, aspektet e pashprehura, të parealizuara ose të refuzuara të diçkaje. Fytyra e hijes është antagonistizëm i reales. Hijet mund të përfaqësojnë potenciale të pashkelura, të tilla si afeksioni, krijimtaria ose aftësia psikike e cila nuk shprehet.²⁵ Megjithatë, simboli duhet dalluar nga shenja, sepse ai ka karakter dinamik dhe të gjallë, ndryshe nga shenja që është diçka e ngurtë dhe statike.²⁶ Epiteti *Malësore*, tashmë është rrënjësor në historinë e shkollës shqipe në Kosovë, prandaj është edhe arketipi më përfaqësues i arsimit shqip, gjatë shekullit të kaluar. *Malësorja*, siç e kemi theksuar edhe më parë është *Heroina* e veprës, ajo e ka tejkaluar fantazmën²⁷ e ideologjisë komuniste e cila në masë kishte për qëllim zhdukjen e shqiptarëve në këto treva.

1.4. Arketipi: Instinkt, model apo fenomen psikologjik


Në studimet e thelluara për arketipat thuhet se “kanë prejardhje nga instinktet, me ndikim të rëndësishëm në psikologjinë individuale”²⁸, e “si rrjedhim ato kanë marrëdhënie shumë të afërta në analogji me arketipat, aq të afërta sa ekzistojnë baza të mjaftueshme për të supozuar se arketipat në të vërtetë janë forma të pandërgjegjshme të vetë instinkteve”²⁹ pastaj është konsideruar se arketipi është “model”³⁰, madje edhe si “fenomen”³¹. Në fushën e gastronomisë dhe të marketingut, po sidomos në sferën e ndërtimitarisë dhe të arkitekturës³²,

kompanitë e fuqishme i kanë implimentuar me sukses *12 Arketipat e Jungut*.³³ Por Jungu, mendonte se “arketipi më i thellë i brendshëm është *Vetja*”, e këtë e ndeshim në personalitetin e Hajries. Vetvetja, është thelbi më karakteristik i personalitetit të saj, rreth së cilës, pastaj janë të organizuar të gjithë elementët e tjerë që i ndeshim nëpër personazhet e romanit. Edhe pse ajo ka një ose më shumë konflikte të brendshme, arketipi i saj me epitetin *Malësore*, shkon përtej kapaciteteve të saj, pasi përpjekja e saj për të dëshmuar pastërtinë, përkatësisht pafajësinë, i sjell konflikte të përhershëm kundrejt dyshimeve të pavetëdijes kolektive dhe kundrejt dëshpërimit si pavetëdije individuale.³⁴ Sipas kësaj, integriteti dhe uniteti i “Unit në personazhin e Hajries”, është shprehur në mënyrë hiperbolike për ta plotësuar sa më bindshëm epitetin e figurës së *Malësore*s, e cila ishte përplot ëndrra, fantazi dhe përvoja të cilat i mishëroi nëpër fatkeqësi. Fillimisht, janë arketipa “të vogla”, siç ishte fare e re dhe e vogël edhe Hajria, pastaj me kalimin e kohës, personaliteti i saj, nga hija u shndërrua në realitet,³⁵ dhe bashkë me të u zhvilluan edhe arketipat, krejtësisht në probabilitet me ngjarjet. Pra, hija, në rastin e romanit *Malësorja*, dhe në raport me protagonisten, përfaqëson energjinë e anës së errët, aspekte të pashprehura, të parealizuara ose të hedhura të diçkaje, që shprehet si arketipi më antagonist kundrejt qëllimit fisnik të Hajries³⁶.

Koncepti i arketipit si “*sintetizues i një shumësie të dhënash në imazhe të forta dhe të ngulitura, si në historinë e njerëzimit, ashtu edhe në ndërgjegjen individuale*”, bëri që mendimi shkencor në fushën e antropologjisë kulturore ta zgjerojë këndin e shqyrtimit.³⁷ Edhe “Skënderbeu dhe populli shqiptar ishin pjesë e politikës evropiane; rezistenca shqiptare ishte me rëndësi ndërkombëtare, gjë e cila përforcon formën arketipale të rezistencës”³⁸, pastaj qëndresa dhe flijimi i Hajries, a nuk kishte formë arkitepale?! Fundja e fundit, “e gjithë historia e arkitekturës është veç një arketip i përkthyer në gurë e beton i asaj që ne mendojmë për botën, veten tonë, për njeriun, jetën, vdekjen, zotat, shoqërinë e kështu me radhë”³⁹, ndërsa në Shqipërinë Socialiste, ndryshimi u ndoq me një fanatizëm primitiv, atëherë kur “arketipi urban i qytetit shqiptar rezulton të jetë pa karakteristika kulturore, gjeografike e historike”⁴⁰ dhe ky shkatërrim u bart me pasoja edhe në fushat e tjera, së këndejmi edhe në fushën e librit dhe të kulturës.

Jo rastësisht i kemi futur në përdorim zyrtar përkatëse të arkitekturës,⁴¹ të cilat arketipin në fushën e industrisë së ndërtimit, kryesisht e klasifikojnë si ndryshim i nevojshëm evolutiv të objekteve ndërtimore, të cilat kanë të bëjnë direkt me format dhe pamjet, se sa me fjalët e shprehura letrare të cilat kryesisht rreken për originalitetin.⁴²

²¹ Po aty, Warbleton Council,
²² Prof. dr. Zejnullah Rrahmani, “Malësorja e Nazmi Rrahmanit ose Arti i interpretimit”, studim letrar, botoi Sh.B. “Faik Konica”, Prishtinë 2002, faqe 25.
²³ Carl G. Jung, “Psikologjia analitike” Shtëpia Botuese “Fan Noli” Tiranë, 2006, faqe 35-66. (Përgatiti Majlinda Cami, “Carl G. Jung - Koncepti i pavetëdijes kolektive”, publikuar në Ikivi, Austri, nën përkujdesin e Fahri Xharrës.)
²⁴ “Roli i arketipave në letërsi”, Seagrantsatlantic. <https://sl.seagrantsatlantic.org/archetypes-of-the-heros-journey-31346-7473>
²⁵ Po aty, “Roli i arketipave në letërsi”,
²⁶ Dr. Jolanda Lila, “Larmia e stileve në poezinë shqipe bashkëkohore”, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, departamenti i letërsisë, Tiranë 2015, f. 71.
²⁷ Pajazit Nushi, “Fjalor shpjegues i psikanalizës,” ASHAK, Prishtinë 2010, faqe 91-92.
²⁸ “Arketipet kryesore sipas analizës Jungian”, Dosaa72, 2019. <https://dosaa72.ru/sq/finansy/osnovnye-arhetipy-v-yungianskom-analize-arhetip--primery.htm>
²⁹ Majlinda Cami, punimi i cituar,
³⁰ Arb Elo, “Dilemë arkitektësh”, Peizazhe, 21 Dhjetor 2015. <https://peizazhe.com/2015/12/21/dileme-arkitektesh/>
³¹ Abdullah Rexhepi, “Të identifikohemi me humanizëm, racionalizëm, spirtualizëm, qytetari e respektim të ligjit.” <https://orientalizmi.wordpress.com/?s=arketipi>
³² Libri “Arketipologji”, janar 2015, ka 135 faqe. Libri merret me Tipologjinë ndërtimore, dhe përmes figurave është shpjeguar: “Nocioni i Tipit/ Tipologjia/ Arketipi”, (Vendi dhe autori nuk dihen.) <https://architecturestudio3.files.wordpress.com/2015/01/arke-tipologjia.pdf>
³³ Krahaso: Antonino Saggio, “Arkitektura dhe moderniteti”, nga Bauhaus tek revolucioni informatik, Roma, shkurt 2010. Publikuar nga Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit, Tiranë, Polis_Press, shtator 2015.
³⁴ Xenia Stoll, “Diese 12 Archetypen sollten Sie kennen”, Marketing, Hubspot.de. <https://blog.hubspot.de/marketing/archetypen>
³⁵ Deb Peterson, “Roli i arketipeve në letërsi”, E.Ferrit, 2021. <https://sq.eferrit.com/roli-i-arketipeve-ne-letersi/>
³⁶ “Arketipat kryesorë sipas analizës Jungian”, Dosaa72, 2019. <https://dosaa72.ru/sq/finansy/osnovnye-arhetipy-v-yungianskom-analize-arhetip--primery.htm>
³⁷ Deb Peterson, “Roli i arketipeve në letërsi”, E. Ferrit, 2021. <https://sq.eferrit.com/roli-i-arketipeve-ne-letersi/>
³⁸ Eldon Gjokaj, “Heroi si arketip në eposin shqiptar dhe Shah-Namenë e Firdeusit”, 14 prill 2013.
³⁹ Doan Dani, “Funkzioni ideologjik i mesianizmit të Skënderbeut”, 15 mars 2014.
⁴⁰ Arb Elo, “Dilemë arkitektësh”, Peizazhe, 21 Dhjetor 2015. <https://peizazhe.com/2015/12/21/dileme-arkitektesh/>
⁴¹ Artan Shkreli & Daniel Gjoni, “Tirana - ferri urban i fundshekullit të XX”, Përpjekja, August 13, 2019. <http://perpjekja.blogspot.com/2019/08/rama-i-vdekur-kund-er-amese-gjalle.html>
⁴² Friedrich Jan, “Archetypen? - Benthem Crouwel in der Architektur Galerie Berlin”, Bauwelt 7-2014, faqe 4, Berlin 2021.
- Zyra e Arkitekturës Benthem Crouwel. <https://www.bauwelt.de/themen/Archetypen-Benthem-Crouwel-Architektur-Galerie-Berlin-2118002.html>
⁴³ Matthias von Ballestrem dhe Jörg H. Gleiter, “Typ - Prototyp - Archetyp”, Jg. 23/ Heft 38/ 2018, Berlin 2018. http://www.architekturtheorie.tu-berlin.de/fileadmin/fg274/Aktuelles/PDF/call_heft_38.pdf
⁴⁴ Xenia Stoll, “Diese 12 Archetypen sollten Sie kennen”, Marketing, Hubspot.de, 30. Oktober 2019. <https://blog.hubspot.de/marketing/archetypen>



“Zyra Teorike” për arkitekturë në Berlin, në studimin “Tipi - Prototipi - Arketipi”⁴³ i japin përparësi pamjes, kur bëhet fjalë për arketipin në ndërtimtari, duke ilustruar studimin me shembuj konkretë, që janë bazuar në teoritë e psikoanalitit Karl Gustav Jung. Për të qartësuar konceptin e arketipave jungiane, revista elektronike për marketing “Hubspot.de”,⁴⁴ ka dhënë pamje-figura të avancuara rreth 12 arketipave në marketing. Sipas kësaj, ne kemi të bëjmë me aspekte, natyrore, logjike e historike të ngjashme me disa zhvillime në romanin *Malësorja*. Pasi qasja ka të bëjë me arketipin brenda romanit, studimi merr kahe nga pamja-dukja e personazhit si arketip.

1.5. Aspekti i veprimit logjik

Karakteret, është personazhi që mishërohet me tipare thelbësore dhe kryesisht ka të bëjë me aspektin logjik të të menduarit dhe vepruarit të një individi apo të karakterit që posedon personazhi i një veprë letrare, i një filmi të shfaqur, i një aktrimit në teatër, ndërsa arketipi kryesisht ka të bëjë me aspektin fizik, pamjen e jashtme të individit, objektit, sendeve, lëvizjet dhe veprimet, madje edhe të hijes së personazhit. Kur jemi tek arketipi, arketipi i personazhit të një veprë letrare, siç është edhe romani *Malësorja*, është vështirë për t’u dalluar nëse shkrimtari nuk e ka potencuar ndonjë anë të jashtme të personazhit, por me ndihmën e imagjinatës dhe të përfytyrimit, mund të arrihet te qëllimi kryesor. Arketipi i këtyre personazheve, më shumë si nuancë mund të kuptohet duke i pasur njohuritë e mjaftueshme nga shkenca e psikanalizës e cila merret me këto dukuri. Ta zëmë karakterin e një veprë artistike, i një romani a drame të realizuar në teatër dhe film mund të dallohet kollaj, pasi në tribunën e teatrit i shohim lëvizjet, gjestikulimet dhe mënyrën e sjelljes duke i gërshetuar këto edhe me aspektin logjik të veprimit dhe mimikën e aktorit, e kemi më kollaj të dallojmë karakterin, aspektin logjik të aktorit dhe të njëjtin si arketip me pamjen dhe lojën e tij, me lëvizjen dhe veprimin që bën në skenë, për të realizuar jo aq veprën sa rolin e tij të inskenuar në teatër ose në një film. Arketipi, shpjegohet më kollaj në arkitekturë. Në këtë arkitekturë janë të njohura të gjithë arketipat që klasifikohen edhe sipas pikëpamjeve të psikoanalitit Karl Gustav Jung. Por i kemi disa shprehje të cilat në raport me fjalën e shprehur, shpesh marrin konotacion tjetër. Një kompleks banimi - ka të bëjë me

Prototyp - Archetyp”, Jg. 23/ Heft 38/ 2018, Berlin 2018. http://www.architekturtheorie.tu-berlin.de/fileadmin/fg274/Aktuelles/PDF/call_heft_38.pdf
⁴³ Po aty, Matthias von Ballestrem dhe Jörg H. Gleiter, “Typ - Prototyp - Archetyp”,
- Krahaso: Prof. dr. Zejnullah Rrahmani, Vepra e cituar, faqe 141.
⁴⁴ Xenia Stoll, “Diese 12 Archetypen sollten Sie kennen”, Marketing, Hubspot.de, 30. Oktober 2019. <https://blog.hubspot.de/marketing/archetypen>

një lagje të tërë e cila shoqërohet me tërë infrastrukturën përcjellëse siç janë: rruga, uji, kanalizimet, elektriku, parqet, kopshti, shkolla, shërbimi mjekësor, konsumi ditor, dhe gjëra të tjera përcjellëse, të cilat e bëjnë atë lagje Kompleks i mirë banimi.

Po ashtu kemi edhe “*personalitet ose individ kompleks*”, si arketip është më kollaj për ta dalluar, ndërsa si karakter çështja është më delikate më komplekse, por fjala është për një individ i cili i posedon të gjitha karakteristikat pozitive, të shkollimit e dijës, sjelljes dhe aspektet e tjera që e bëjnë individin kompleks dhe më të dalluar. Ndërsa në momentin që kalon në mbiemër “i/e” kompleksuar merr konotacion negativ, prandaj edhe tek trajtimi i këtij karakteri duhet të kemi kujdes se duke dashur t’ia paraqesim karakteristikat pozitive, pa vetëdije e bëjmë të kundërtën, ndërsa trajtimi që ne pretendojmë ta realizojmë do të firojë pa u marrë vesh, pa u kuptuar, nëse kemi pasur qëllim negativ a pozitiv, kurse tek lexuesi i zellshëm dhe ata që merren më seriozisht me këto fenomene në romanin *Malësorja*, janë lehtë dhe qartë të dallueshme.⁴⁵

1.6. Arketipi dhe sjellja e personazhit në veprën letrare

Duke lexuar romanin *Malësorja* të Nazmi Rrahmanit, përveç njohjes me karakteret e personazheve, lexuesi ndeshet edhe me arketipat e këtyre personazheve, me sjelljet dhe veprimet, ku do të njihemi me lojën artistike brenda romanit, duke pasur secili një rol të veçantë, specifik dhe të dalluar. Këta arketipa i dallojmë jo vetëm nga pamja, por edhe nga forma e tyre, nga sjelljet dhe artikulimi i mendimit, të cilët duke lexuar romanin i përfytyrojmë si figura njerëzore të gjalla dhe me shpirt. Të gjitha personazhet kanë karakteret e tyre, por kanë edhe formën e arketipit me të cilat dallohen nga njëri tjetri, jo vetëm për sjelljen dhe veprimin por edhe për pamjen dhe mendimin logjik. Ato janë individualitete të caktuara që bëjnë jetën e tyre brenda romanit, personazhe të krijuara nga autori sikurse edhe veprimet e tyre janë të kontrolluara pikërisht nga shkruesi i veprës, përkatësisht nga autori.

1.7. Tiparet dalluese të personazheve

Po ashtu personazhet, kanë tiparet dalluese, të cilat sforcjnë karakterin ose mënyrën e sjelljes si arketipa në lëvizje dhe veprim. Tiparet vetjake mishërohen me rolin e tyre brenda romanit, si anë tipike përfaqësojnë karakterin shoqëror, që paraqesin arketipin e individit brenda shoqërisë, kanë veprim logjik dhe lëvizje të kontrolluara, kështu që lexuesi në mënyrë autonome vlerëson veprimin e tyre si një botëkuptim në mes reales dhe rrëfimit të imagjinuar, qoftë ky edhe në aspektin ideologjik.⁴⁶ Prandaj edhe brenda romanit kemi personazhin kryesor, Hajrinë, e cila luan rolin e saj në transformimin e botëkuptimeve të vjetruara duke i dhënë shkas shoqërisë për të reflektuar në këto ndryshime. Pastaj kemi karakteret e dyta dhe rolet e tyre të ndyta, pa të cilët nuk do të ishin kaq dalluese as vuajtjet e Hajries, e cila falë presioneve, trysnive dhe padrejtësive të shumta arrin të identifikohet si një grua e fortë, e durueshme dhe si personazh triumfues, e pa dyshim, njëri nga personazhet më pozitive brenda këtij romani.

⁴⁵ Shih: Prof. dr. Zejnullah Rrahmani, “Romani Malësorja ose Arti i interpretimit”, Prishtinë 2002. Në këtë studim, profesor Zejnullahu ka bërë një lexim dhe depërtim të thellë, profesional dhe të pakrahueshëm, prandaj vepra në fjalë është pikë e mirë referimi për t’i dalluar nocionet dhe pikëpamjet letrare të shtruara në romanin Malësorja.
⁴⁶ “Cilat janë 12 arketipat dhe cili dominon në personalitetin tuaj?”, Rrjetat, 3 Shtator 2018. <http://rrjetat.com/cilat-jane-12-arketipet-dhe-cili-dominon-ne-personalitetin-tuaj-ose-https://rrjetat.com/cilat-jane-12-arketipet-dhe-cili-dominon-ne-personalitetin-tuaj-2/>

Romani "Vajzat e mjegullës" i shkrimtarit Rshqiptar Namik Dokle, është i parë që u botua nga shtëpia botuese CONNECTUM e Sarajevës, në përkthimin e filologut Sadik Idrizi. U pasua nga botimi edhe i romaneve "Lulet e sakjbotës" (në boshnjakisht me titullin "Gora pa zogj") dhe "Ditët e lakuriqëve të natës."

Është një libër i angazhuar, i shkruar në nderim të atyre njerëzve që u qëndrojnë kushteve të vështira të së përditshmes, të mbyllur në vendlindjen, gjuhën dhe origjinën e tyre; është i angazhuar për arsyen se "mban anën" dhe nderon një popull që është i gjithkujt dhe i askujt, që jeton në kufirin e një vendi që e kanë prerë me shpatë.

Xhaxhai i rrëfimitarit të librit, në ditarin e tij, në datën 11 janar 1956 shënon: "Sherifi rri në klubin e fshatit, pi kafe dhe lexon ditarin e Mulla Jusufit, të cilin e ka mbajtur për 45 vjet. Ka shkruar për gjithë të mirat dhe të këqijat që kanë ndodhur në fshatin tonë dhe më gjerë. Në një faqe gjetëm përshkrimin e ndarjes së kufirit mes Borjes dhe Gllaboçicës, nga Orçusha deri në Shishtavec, të cilin e bëri Komisioni Ndërkombëtar për Caktimin e Kufijve. Atëherë Gorën e kanë prerë me shpatë" (Faqe 139)

"Vajzat e mjegullës" është romani për Gorën dhe goranët, për forcën dhe bukurinë e njeriut, i cili mban në vetvete të drejtën për të qenë dhe për të mbetur ai që është, me gjuhën dhe traditat e veta, me përjetimet dhe bashkësinë e tij, të drejtën për të dashuruar dhe kujtuar, të drejtën dhe detyrimin për qëndresë kundër antinjerëzores, madje edhe të drejtën mbi mallkimin, siç është ai i Sinan Pashës, që vrau djalin e vet për të ruajtur gradat dhe lavdinë. Mund të thuhet që ky është edhe një roman historik në atë kuptim që është i tillë, të themi, "Bija e kapitenit" i Aleksandër Pushkinit. Ai rrëfen vitet e vështira në historinë e një populli nëpërmjet tregimit artistik në të cilin e folura e vërtetë përshfaq atë "jozyrtaren", zërin e një dëshmitari "imaginar", gjë të cilën lexuesi e përjeton si një dokument të sinqertë dhe autentik të njeriut. "Historia zyrtare" këtu është treguar dhe përshfaqur nëpërmjet kujtimeve të shkruara apo të pashkruara, legjendave gorane dhe këngëve të tyre. "Ne akoma nuk kemi shumë intelektualë që do të studionin shkencërisht origjinën tonë", thotë një mësues i ri nga një fshat i Gorës. "Mendoj se kjo është një nga arsyet që ne na përvetësojnë serbët, shqiptarët, maqedonët, së fundi edhe bullgarët. Po ne jemi goranë, ndërmyjet veti quhemi "tanët". Hajde kuptojë këtë, nuk ka diell që do ta shpërndante këtë mjegull." (faqe 114-115) Tekstet dokumentare qëndrojnë kështu në një rrafsh me shkrimet shqiptare, të folklorit shqiptar, folklorit goran, ndërkohë kronikat artistike nga romani kanë fuqinë bindëse të shënimeve autentike dhe të argumenteve të pakundërshtueshme.

Autenticiteti i të treguarit në romanin e Dokles është theksuar edhe prej faktit që rrëfimtari është një fëmijë me të cilin lexuesi lidhet emocionalisht që në faqet e para, kur ky personazh femënor mendon, përpigjet të kuptojë çka ndodh rreth tij, për shembull, çfarë është dhe si është fantazma e një "aksioni" që do të vijë dhe do të rrëmbejë të gjitha vajzat e fshatit, apo njëfarë "organizate" si një bodrum i errët që shpesh edhe i gëlltit ata që futen brenda tij. Ndërsa endet nëpër fshat gjysmë i uritur, duke pritur që për të dhe për moshatarët e tij të krijohet mundësia e shkollimit të mëtejshëm; duke dëgjuar bisedat e më të mëdhenjve, në thelb ky fëmijë përcakton masën e vërtetë të njeriut. Me naivitetin dhe pafajësinë femënore, shpesh i mbërthyer nga frika, përjeton dhe kujton me gjithë qenien e tij, tregon çka është e bukur - qoftë kjo bukuria vajzash, këngësh, aromash, përrallash apo bukuria natyre.

Autori Namik Dokle në mënyrë të

Shënime për romanin "Vajzat e mjegullës" të shkrimtarit Namik Dokle, botim i CONNECTUM, Sarajevë

QËNDRESA NDAJ ANTINJERËZORES

Nga Dr. Adijata Ibrishimoviç-Shabiç
Docente, Fakulteti i Filozofisë, Sarajevë

shkëlqyer ka arritur që nëpërmjet këtij rrëfimtari naiv të na japë një këndvështrim të drejtpërdrejtë, kureshtar dhe plot jetë. Një rrëfimtari i tillë nuk ka dhe s'mund të ketë të krahasuar, i ndërtuar me stil, zë i freskët dhe i fuqishëm njëherësh, gjuhë plot kolorit. Natyrshmëria dhe papërsëritshmëria e vështrimit femënor në roman përshfaqet bukur nëpërmjet zërit të gjuhës dhe folklorit goran. Dijet dhe pikëpyetjet mbi botën, ashtu si edhe përvojat e jetës, vijnë pas gjurmëve të traditave, përrallave dhe rrëfimeve, këngëve vajzërore, legjendave, kronikave, magjive dhe mallkimeve. Dhe e gjithë kjo thurur me shumë zhdërvjelltësi në gjithë rrjedhën e romanit. Në këtë lloj narracioni zbulohet i gjithë trishtimi i një jete të ashpër, që jetohe, pavarësisht gjithçkaje, "për inat" ndaj së keqes dhe njëherësh ndërtohet portreti i njeriut, i nëpërkëmbur, por i papërkulur, i varfër, por kryelartë, kokëshkretë dhe pafundësisht besnik ndaj vetvetes.

"Vajzat e mjegullës" është një kronikë familjare, sepse djali rrëfen për ata që ka më të afërt, babai, nëna, gjyshet, xhaxhai... dhe këto personazhe, të vendosur në hapësirat kufitare të Shqipërisë së Veriut rriten dhe na përshfaqen në personazhe arketipe të babait, nënës, gjyshes, të dhëna në lëvizje të mëdha, ashtu siç i vë në provë mjerimi dhe shëmtia e jetës. Duke zgjeruar këndvështrimin e përjetimeve të veta, duke dalë nga shtëpia në fshat, djali flet për fshatarët; njerëz të mirë ose të këqinj, të ulur pranë vatrave apo të mençur që kujtojnë gjithçka ka ndodhur e ndodh rreth tyre. E tillë është Majka, me të cilën djali është veçanërisht i lidhur, një nga personazhet legjendarë për të cilët nuk dihet as edhe kur kanë lindur dhe sa vjet kanë jetuar mbi tokë, një grua që shëron sëmundje dhe bën magji

e që "vdekja e ka harruar", një dëshmitare e të gjitha ndryshimeve historike dhe politike. I tillë është edhe xhaxhai i djalit, një kronikan i fshehtë i fshatit, me ditarin e të cilit fëmija do të familjarizohet dhe do ta rishkruaj fsheturazi për t'ia treguar mësuesit të tij.

"Sistemin e kemi demokratik. Udhëheqës kemi Enver Hoxhën. Para gjashtë muajsh është mbyllur kufiri me Jugosllavinë, shumë njerëz dhe familje të fshatit kanë ngelur matanë. Deri tani kemi qenë miq me Titon. Ushtarët kanë ardhur në fshat. Deri në fyt jemi të mbytur me angari", ka shkruar xhaxhai më 11 mars 1949, ndërsa më 2 tetor 1954: "Këtë vit nga fshati janë larguar dhjetë familje. Të gjithë ikin se nuk kanë ç'të hanë. E braktisin fshatin vetëm që të afrojnë bukën te goja."

Në "tabarin" e përkundërt, në "organizatën" midis atyre që shkaktojnë braktisjen nga njerëzit të vatrave të tyre shekullore, përshfaqen të tillë, si për shembull, Salko, i cili ka marrë nofkën, - dhe nuk ka nevojë të sqarohet me detaje të tjera, - Stalini i fshatit.

Duke shfrytëzuar në mënyrë të shkëlqyer perspektivën e vëzhgimeve të rrëfimtari të romanit, Namik Dokle ka arritur që nga kronika familjare e një fshati të vogël të ndërtojë kronikën e një krahine dhe të një vendi të tërë, të endë një sagë për popullin e vet. "Vajzat e mjegullës" bëhet kështu libër për vlerat e një jete të ndershme, të thjeshtë dhe të respektuar. Dhe në kushtet tronditëse të një sistemi të frikshëm, të urisë dhe të klimës së ashpër, Namik Dokle me romanin e tij na përcjell mesazhin se gjithçka thjeshtëzohet në pyetjen: ose je, ose nuk je njeri.

Dhe nëse në fund duam të zbulojmë gjëagjzëzën se cilat janë në të vërtetë Vajzat e mjegullës, ndoshta përgjigjen më të mirë



dhe të vërtetë do të na e jepte Majka: "E po, o Mësues, që erdhe nga Shkodra të mësosh fëmijët tanë, dije se në këtë botë ka vetëm një histori...nga çka qenë, ç'është e ç'do të jetë njeriu, asgjë nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë përgjithmonë, ajo që një ditë të bukur ka mundur të jetë, ditën tjetër do të pushojë së qeni...E sa për fshatin tonë... shkruaj se në fund të botës apo në askund, fshehur në mjegull ndodhet një fshat i quajtur Bukojna, ku lindin burra të cilëve u zbardhen flokët që fëmijë dhe që shohin natën më mirë sesa ditën. A e di, o Mësues, se çfarë thonë për burrat e fshatit tonë? Nuk i ka lindur nëna prej barkut, por i ka lindur mjegulla e Kallabakut. Qëkur lindin e derisa vdesin janë fëmijë të mjegullës. Në pelena mjegulle i mbështjellin kur lindin nga barku i nënës dhe në qefin mjegulle i fusin kur i përcjellin pas Bërçes, në varreza. Dhe e gjithë jeta mjegull u shkon nëpër botë, i rrëmbejnë ku të mundin erërat e vjeshtës, përqafohen me shkëmbinj të grykat e lumenjve, hanë bukë me natën dhe grinden me ditën... E vrasim shumë mendjen për këtë botë dhe për atë botë..." (faqe 39)

Edhe pse sipas autorit fatpërcaktues është ai kapitull historik që nis më 1949 (me të cilin hapet kronika), romani arrin të na ofrojë një kuadër të gjerë të një jete pesëdhjeteshtatë vjeçare, për të cilën na sugjeron fjalë e parë e librit. Përrallat, legjendat, mitet, të cilat ndërfiten në roman, e zgjerojnë shumë kohën dhe këndvështrimin e rrëfimit, duke evokuar edhe atë që është futur në thellësitë e të shkuarës (siç është për shembull historia bogomile) me qëllimin që të vërtetojë historinë si fat, në përgjithësi të frikshëm dhe armiqësor, që e vë njeriun në provën e përjetshme: ose je, ose nuk je njeri.



Një antologji është dritare e hapur në shtëpinë e letrave. Në brendësi të kësaj shtëpie vezullon arti dhe ti nuk e përballon gjakimin me trokitë aty. Kur kam qenë student, mbaja poshtë nënkresës dy përmbledhje poetike: *Fije bari*, të Uollt Uitmanit dhe *Mëhallat e botës*, të Janis Ricosit. *Antologjia e Poezisë Greke*, botuar më vonë në shqip, më tha se Ricosi i rinisë sime nuk ishte më shumë se një ujdhesë, në arqipelagun e gjelbëruar të poezisë greke. Për pasojë, Elitisi, për shembull, të cilin vite më pas e shijova në shqipërimin e Niko Kacalidhës, ishte përjetim estetik e veçantë, por jo befas. Ishte brenda prizmave të mia.

Vihet re menjëherë se lëndën për këtë *Antologji të prozës tregimtare greke* Stavri Dajo e ka përzgjedhur me një kombinim mjeshtëror të dijës e të shijës. Nëse këtë lëndë do ta përcaktoja vetëm me një fjali mungesore, do ta quaja: prozë e dilemave të njeriut.

Karakteret që lëvizin nëpër *Antologji* duken të njohura, sa edhe të panjohura. Të njohura, për shkak të natyrës universale të mjaft syresh. Të panjohura, për shkak të individualiteteve origjinale. Në Olimp të tyre rri *Zorba*. Nuk mund të mos pezmatohesh me arithmetiken e akullit, kur kujton se në një nga votimet e jurisë së Nobelit ka qenë një votë, vetëm një, që e mbajti Kazanzaqin (Kazanzakis) larg sofrës së Çmimit të madh. Më pati rënë në dorë ky roman në frengjisht, në fillim të viteve tetëdhjetë. Humba nëpër universin e tij, ndalo, kthehu, vazhdo prapë, frengjishtja ime e atëhershme, e mësuar copa-copa, pa profesor, vuante, nuk kish brenda vetes hapësirë të mjaftueshme për një Zorbë. Gabriel Garcia Markezi tregon për një zonjë të moshuar, e cila kish kopjuar me dorë romanin *Njëqind vjet vetmi*, deri në fjalinë e fundit. Arsyeja? «Sepse unë dua të di kush është me të vërtetë i çmendur, autori apo unë, kishte thënë zonja. Dhe e vetmja mënyrë për të gjetur cili është më i çmendur, është ta rishkruaj librin». Është çmenduria hyjnore e krijimit, gjatë së cilës Kazanzaqis e pasuron letërsinë e botës me një vepër si *Zorba*. Shqipërimi i Stavri Dajos është pothuajse dehës. Gati ta mbush mendjen se je dundur duke pirë verë me Zorbën, se ti dhe ai keni folur mbarë e mbrapsht për aventurat, për udhëtimet, për gratë, gjithnjë shqip, vetëm shqip. Prej së njëjtës hipnozë shqipërimi jam kapluar tash së voni, kur lexova për herë të dytë "poemën" *Frymë të vdekura të Gogolit* - autori e quan poemë - në shqipen mjeshtërore të Mitrush Kutelit.

Nëpër galeritë e *Antologjisë* lëvizin dritëhijet e dilemave të njeriut: a ia vlejti? Në thelb janë mëdyshje për ekzistencën, për kuptimin e jetës, për të vërtetën dhe masakrimin e saj. Sa herë ta dëgjosh Sokratin e Varnalis kah thotë "Nuk ka në botë poshtërsi më të madhe e tradhti më të lartë sesa të thuash të vërtetën", sarkazma të ther brinjë në brinjë. "Nuk ka rëndësi e vërteta, por nëse shkuma, që e vërteta nxjerr nga goja, duke përdorur pastë dhëmbësh, është më tronditëse se shkuma e një epileptiku të njëmendtë" plotëson nga një kundrojë tjetër estetike Jorgo Skampardonis (Giorgos Skampardonis), në tregimin *Shkuma*.

Panajoti i Thanas Valtinos është hero në luftë, po në pasluftë? Në paqë përfundon si genie njerëzore e nënrenditur. Vdes disa herë dhe shndërrohet në dheul, insekt, që mbytet në 4 cm. ujë. Ndërkohë pyetja dramatike pluskon në sipërfaqe: sa ia vlejti? Me kumtin universal, *Panajoti* përvijohet si miniaturë e *Fatit të Njeriut* të M. Shollohovit. Ose po deshe, e *Kolonelit* markezian, të cilit s'ka kush t'i shkruajë. Janë vepra të ngjashme sa edhe të pangjashme. Të ngjashme janë dramat dhe mëdyshjet që nuk i ndahen njeriut, qysh prej kohëve homerike ose gilgameshiane. Dhe që, me gjasë, do të shuhet vetëm me shuarjen e krijesës njerëzore, të paralajmëruar në librat e shenjtë. Të pangjashme janë mjediset me ngjyresa të gjalla dhe individualitetet artistike.

Një vajzë që "E quanin Simone", e Jorgo Theotakas (Giorgos Theotokas), duket sikur na çon te Prosper Merimeja. Kjo Simone mund të quhet edhe Kolombë. Me një ndryshim, i cili përvijon profilin vetiak të Simonës si hero letrar. Aksioni i Kolombës

- Antologjia *Proza tregimtare greke*, përgatitur nga Stavri J. Dajo (*Literatus*, 2023)

DRITËHIJE TË DILEMAVE TË NJERIUT

Nga Mehmet Elezi

ka prapavijë etnografike, është mishërim i traditës së trashëguar të gjakmarrjes, dalluese për korsikanët, për grekët e Kretës dhe natyrisht për ne, shqiptarët. Te Simona nuk është gjaku i derdhur, si i tillë, që e nxit gruan drejt dorasit, për gjakmarrje. Ajo merr hak para së gjithash për dhunimin, për poshtërimin e dinjitetit njerëzor. Një karakter gruajë që sfidon ujërat e errëta të detit me taborre peshkaqenësh dhe më në fund, në mënyrën e saj, i jep kuptim jetës, sjell jehonat e lashtësisë greke, ku shpëtimin i krimin ishte ligj, se po nuk u ndëshkua krimi, e keqja do të shumësohet.

Nëpër fatalitetin e zhvillimeve ndodh që humb jeta, por jo vetë Njeriu. Njeriu mbijeton në trajtë tjetër.

Njeriu mbijeton me hije epike. I bukur, gjithnjë i bukur. Luftëtari i Antoni Samaraqis (Antonis Samarakis), te *Histori luftime*, kaplohet prej kënaqësisë së çau përmjedis vdekjes dhe i shpëtoi jetën një djalë të vogël. "Shpëtova një fëmijë" u thotë shokëve. Ata i bërtasin: Lëviz shpejt, blloku ku je do të hidhet në erë!


Njeriu mbijeton me hije lirike. I bukur, gjithnjë i bukur. Manoli i Andrea Karkavicës (Karkavitsa) pas pak do të mbytet, por kur e pyesin *A di këngë*, përgjigjet: Detin. Kur e pyesin rishitazi si i ka sytë e dashura, që ai nuk e ka, ai prapë zgjedh ngjyrën e detit. Të kaltër, thotë.

Kjo është ana e ndriçuar.

Por është edhe ana e errët, kur buthtojnë instinktet parake, forcat e zeza, që shkelmitin arsyen dhe shpirtin njerëzor. Ana e errët, të cilën Jorge Luis Borges e quan "historia universale e turpërisë". Është pamja kur formula e gjakut të qenies njerëzore çartet. E tjetëron verbëria, e shpërbën egoizmi pa cak.

E tjetëron apo thjesht zbulon cila është? Këtu luhet një mëdyshje, një dilemë tjetër. Njeriu shfaqet si vetja por edhe si kundërvetja. Si arsye e moral por edhe si instinkt i errët. Si engjëll por edhe si qoftëlarg.

Një tablo me dendësi skëterre të krizës së njeriut të çartur, e kemi përjetuar virtualisht te romani *Verbëria*, i nobelistit José Saramago. Në mënyrë të prekshme, jo virtualisht, e përjetojmë në përflakjet bashkëkohore, që skuqin planetin dhe kriminalizojnë qenien njerëzore. Petros Ampaxoglu (Petros Ampatzoglou) skicon një profil të tillë te tregimi *Nga pozita e të fortit*. "Budallallëqe! - u përgjigj koloneli - Kush tha se fëmijët nuk duhet të vdesin? Përpiku ta shohësh botën si një shumatore numrash, që s'kanë rëndësi". Një deklaratë e tillë drithëruese na sjell ndër mend Stefan Cvajkun. "Dhjetëmijë të vrarë në luftë janë thjesht një statistikë", shkruan ai te



monografia për Fushenë.

Për letërsinë e vërtetë s'ka tabu, dilema hyn kështu në një zonë të rrezikshme: mos qenia njerëzore e ka mizorinë në gen? Njeriu është mister, thotë Dostojevski. Pyetjen e mësipërme e shprush më tej një tregim i shkurtër, në vështrim të parë i parëndësishëm, i Tolis Kazanxis (Kazantsis). Titullohet *Blu-ja*. Do çunakë, prej atyre që luajnë e zhgërryhen nëpër dherat e lagjes, torturojnë keqas një bashkëmoshtar, vetëm pse ai është i ndryshëm, nuk është si ata. Bëhen gati me e vra, vetëm pse ai është i ndryshëm, nuk është si ata. Tregimi shkatërron një skemë të përhapur deri në kufijtë e paradigmes, sipas së cilës fëmija është engjëll.

Po, fëmija është engjëll. Por pse engjëllit i shkon mendja pikërisht te vrasja e shokut? I vogli i sotëm është i rrituri i nesërm. Ka të njëjtat shtysa të nënvetëdijës, por s'e ka të njëjtën fuqi arsyetimi dhe aftësi vetëkontrolli. Nëse fëmija përqsatet me engjëllin, kjo ndodh se një fëmijë, edhe kur bën keq, nuk është i vetëdijshëm për pasojat e sjelljes së vet.

Një skenë të ngjashme me ndodhinë e tregimit *Blu-ja* e përjetojmë me ankth te romani i Ferdinand Selinit *Një udhëtim në fund të natës*. Tashmë me personazhe burra, jo më fëmijë. Dy gangsterë shestojnë me e

(Vijon në faqen 13)



(Vijon nga fq. 9)

LULEBORAT NË RRUGËN "ELENA"

tregim nga Valbona Quku



Në tavolinë një vazo qelqi cilindrike me lulebora të harlisuna nuk pushon tue përçue buzëqeshje fluturake në çdo kand të dhomës me mure të xhamta. Lulebora nuk ishte kryekeput si ajo e qytetit të saj të lindjes, por sa herë që vinin festat i merrte gjithsesi si detajin ma sentimental të dekorit, mbante aromë fminie shpija për festat e fundvitit. Nirvana ktheu kryet me pa vajzën e vogël, që u rrekte me pikture në një telajo me numra e zona të përcaktueme. Qetësi absolute, nga jashtë dëgjoheshin hapat e kalimtarëve të rrallë, që ndiqnin ritmin e valëve. Rruga "Elena", një rrugë e vogël me sens unik, ku mbizotnojnë muret e bardha mbi të cilat sukulentet me ngjyrat e tynë të ngrohta qendisin ornamente spanyolle, tue i shkue përshtat kangjellave të perdredhuna, pllakave e oborreve mbushë me pemë të nalta, ku edhe rrezet e diellit kanë vështirësi me depërtue. Të ardhurit nuk e njihnin, dhe turistëve ndoshta nuk i binte rruga andej, por vendasit e androrojshin me jetue diku në afërsi me shtëpinë e artistes. Papritmas u dëgjue zilja e telefonit, një za i dashtun vinte nga larg, me shkëputje. Ra linja, sinjali nuk ishte i qëndrueshëm, kjo për shkak të kodrinave të vazhdueshme, që përshkonin qytetin e mbajtur me hatër nga nana natyrë.

"Po provoj me të thirrë pak ma vonë, nuk ka valë..." i shkroi tezas një mesazh me tre karaktere zemre mbrapa. Ngadalë, por me padurim, filloj të ecte nëpër dhomë me telefon në dorë tue kërkue ku gjendej sinjali ma i fortë, ndërkohë paузë, sytë i mbeten të ngulitura përtej dritares.

Çdo gja që po ndodhte përballë saj kishte ndjesinë e një filmi me lëvizje të ngadalta, gjymtyrët i ishin atrofizue, mendja e shqisat nuk funksiononin, vetëm sytë e zmadhuem me stërmundim përpiqeshin mos me humb lidhjen me realitetin. Vetëm 4-5 metra përtej dritares, në mes të rrugës një skuadër policie i kishin drejtue armët nga Nirvana. Iu deshtën vetëm pak sekonda me kuptue, se në fakt tytat ishin të drejtue ndaj një vaje të ulun në trotuarin e rrugës ngjitë me shpinë. Tue marrë frymë me vështirësi, Nirvana bani një hap mbrapa, e u mbështet në anën e dritares me faqen vetëm disa milimetra larg xhamit. Vajza e re u dridhte, lotët i rrokulliseshin pa ndalë, vështrimin e kishte të tretun, e mbështetur në një dorë mudohej të mbarte balancën e trupit të sflutur, në tjetrën mbante shpërfillshëm një thikë nga ato të kuzhinave. Oficeri i fliste me një za të ngadaltë, por me tonalitet të vendosur, ishte vetem 3-4 metra larg. Pak ma andej, në anën tjetër të trotuarit, në kambë qëndronin disa kojshi tue pa me sy të tmerruem skenën. Njena prej tynë duhej të ishte nana e vajzës,

me krahë të kryqzue në krahnor e me njenen dorë sipër gojës. Nirvanës i dukej se ia dëgjonte të rrahurat e zemrës, dëshpërimin e pafund dhe frikën për çfarë mund të ndodhte nga sekondi në sekond. Vajzën e familjen e saj nuk i njihite, ma vonë i treguen se familja banonte pak ma andej, në krye të rrugës, ishin njerëz të paqtë e intelektual. Pa britma, pa alarme, në qetësi të plotë, kjo skenë nuk zgjati ma shume se 10 minuta, vajza e perlotun u dorezue tek oficerët. Ato pak kojshi që ishin në rrugë u shpërndanë, edhe lotët në trotuar u terën mbas pak minutash. Vetëm trishtimi dhe e ardhmja e pasigurtë, mbeten aty në ajër si konture të hijes së vajzës, që vazhdonte të sillej aty rrotull.

Nirvana mbylli sytë për një çast, mori frymë thellë, me të dy duert rregulloi flokët, por në fakt po përpiqej me sistemue mendimet që akoma i silleshin si furtunë nëpër krye. E çoroditun ktheu kryet me pa nga vogëlshja, bota e saj vazhdonte me kenë e njëjtë nën efektin e bojnavë dhe penelit.

Tue i folë me ambëlsi vajzës, (as vetë nuk e kuptonte si ishte në gjendje ndonjherë, me i mbajtë veç per vedi trazimet, pa u kuptue.)

"Mia, hajde zemra e nanës, e mbarojmë nesër pikturen."

Te dyja bashkë u zhytën në kolltukun e butë. Tue leduatue duert e njoma, e ndjeu aromën e ambël të vogëlshes tue i depërtue në mbrendësi të shpirtit.

Disa muej ma parë vajza ishte diagnostikue me një sëmundje të rrallë, mjekët jepnin një përqindje të vogël mbijetese. Nirvana ishte kthye në genie me shpirt të plagosun. Ditën vazhdonte jetën normale për sytë e botës, e nata ishte tmerrsisht e gjatë dhe e randë, shoqni i banin vetëm lotët, që u ndalnin në flokët e verdha të vajzës, që flinte e patrazueme. Mendimet ishin të pamëshirshme, nuk e lejonin me marrë frymë, pse Mia, pse vajza me sytë ma të ambël në univers?????

Të moçmit thonin bota sillet rrumbullak, çka do që të bash sillet mbrapa me të gjetej. Mendonte ku kishte gabue, ndoshta kishte vra dike o dicka pa dashje, ndoshta në zemërim e sipër, por jo asgja e kësaj natyre nuk i vinte në mendje. Arsyeya kishte humbë, e keqja duket se kishte depërtue pa paralajmërim në jetën e tynë, në formë cinike dhe të përherëshme. Mia kishte fjetë në prehrin e saj, e mbuloi me batanijen e preferueme. Mbylli sytë dhe provoi me shtrij trupin, që akoma ishte në gjende ngërçi. Për çudi vuni oroe, se lotët i kishin ngri, porteti i vajzës në rrugë me thikë në duert që i dridheshin nuk i hiqej nga sytë. Veshja e saj sportive, flokët që i shkëlqenin dhe sytë e pashpresë, nana e tmerrueme dhe një zotni që i rrinte afër portretizonin një familje perfekte, dhe përsëri në një fragment sekondi ata mund të kishin humb çdo ekuilibër të mundshëm. E kush e garantonte, se nuk mund ta humbnin në të ardhmen?

Ndërkohë, Mia i shtriu krahët në kërkim të një përqafimi, e rroken fort njena-tjetren. Mia me andrrat e saja të patrazueme dhe Nirvana që u dridhte lehtë, këtë herë po qante pa lot, tue mendue se çdo çast me njerëzit ma të dashtun asht i çmueshëm dhe mundet me kenë i papërsëritshëm. Nga jashtë fërfëllimat e palmave dhe mjaullitja e një maçoku e thirrën në botën reale.

Gati natë, mjegull e hana e preme në gjysmë si me thikë u reflektonte në pjertësinë e guximshme të valës së përzgjedhun si dhjetëra pasqyra të argjendta. Nata i mbyllte sytë e dritës dhe zhurmat e oqeanit ishin të vetmet, që i tregonin rrugën hapave të tretun në labirintet e natës. Frymë për një moment, mjaftueshëm sa për një jetë!

ZJARRI I NJË AGIMI

Tregim historik për Xhordano Brunon

nga Klara Kodra



Qielli i tërë kishte marrë zjarr. Njeriu që ecte i lidhur në mes të sharjeve dhe të talljeve, ngri një herë kokën lart, vështroi atë pamje edhe buzëqeshi.

Një mendim i çuditshëm i përshkoi trurin se ai zjarr paralajmëronte një zjarr tjetër që ende s'ishite ndezur dhe do ta përpiqte atë vetë.

A thua qielli të merrte pjesë në atë dënim që i jepnin njerëzit?

Qielli që ai e kishte dashur po aq shumë sa tokën?

Mendimi i dytë që i erdhi ishte ky: bota ishte çuditërisht e larmishme dhe e bukur dhe ai do të kishte dashur të jetonte njëmijë vjet për t'u ngopur me të dhe ja, tani i mbeteshin edhe pak çaste.

Hodhi sytë te turra e druve, pastaj te populli. Dëgjoi shkoqur sharjet "Djall", "Heretik", "Magjistari".

"Popull i mjërë" - mendoi ai pa pikë zemërimi. Ai kishte dashur që ata të cilët e ngrysnin jetën në gjunjë të depërtonin në të fshetë e yjeve.

Një krenari e zjarrtë e përshkoi të tërin duke bërë të harronte vdekjen.

Ai kishte trokitur te dyert e pafundësisë, ai kishte mundur t'i shpërthente ato dyert.

Dhe do të donte t'u thoshte:

"Vallë për këtë doni që unë të vdes?"

Për mua qe po aq i rëndë veladoni sa ky qiell i rremë, kjo kupë prej letre të zezë me një perëndi kukull që kisha ka vendosur mbi kryet tuaj. (Ka qenë edhe murg, djalli i zi! - u dëgjua klithma e zemëruar e një gruaje). Ai vazhdoi të mendonte duke tundur kokën:

"Unë e flaka tutje veladonin, e grisa këtë qiell prej letre, i thashë njeriut: Gjithësia është e pafund. Pafundësia është jotja, jotja, po aq sa e Perëndisë".

Dhe toka po rrotullohet edhe tani rreth boshtit të vet duke shndërruar natën në ditë dhe duke vërtetuar tezën time, ndërsa ju thoni "Zoti e bën të agojë Diellin".

Dhe ju mbase mendoni se kjo flakë e qiellit paralajmëron zjarrin e skëterrës për mua.

Jo, skëterra është këtu në tokë, ajo skëterrë që përgatit për ju inkuizicionin.

Dhe unë do të vdes, po toka do të vazhdojë të rrotullohet bashkë me botët e tjera dhe do të vijmë të tjerë pas meje që ndofta do të thonë për mua vetëm kaq "Ai kishte të drejtë!" Po jo, nuk do të doja vetëm këtë, do të doja që të thoshin: Ai ishte njeri i ndershëm nuk u përul. Dhe unë do të mund të jetoja po të doja.

Po nuk do të mundja të mbaja më ballin lart.

Dhe pse të jetoja?

"Jetë do të thotë të luftosh, të kërkosh, të guxosh".

Mendoi për kardinalin Belarmino dhe vetëtima e një buzëqeshjeje ironike ia përshkoi fytyrën.

"Edhe unë mund të isha bërë si ai ... Ma patën premtuar... Lavdi e kotë, e gënjeshtert".

Iu kujtua gruaja që kishte dashur, tiparet e saj fine, flokët e saj, shkëlqimi i bardhë i trupit të saj.

"Dashuria është një nga format e Bukurisë, një nga mrekullitë e jetës".

Po fëmijët?

S'kishte mundur të linte prapa fëmijë të mishit dhe gjakut të vet, po kishte lënë aq shumë fëmijë prej letre, librat e tij ... ndofta këta fëmijë ishin më tepër të tijtë se sa do të kishin qenë të bijtë.

A do të jetonin ata pas tij? Apo do t'i digjin edhe ata? Jo, ky mendim ishte i padurueshëm, më i keq se vdekja. Apo do të jetonin dhe ... do t'i lexonin brezat e ardhshëm. Në këtë çast e përshkoi si rrymë elektrike një dridhmë lumturie, gëzimi i fundit.

Solli ndërmend nxënësit që do të jetonin pas tij, adhurimin e tyre të heshtur, bisedën e fundit që kishte pasur me Sagredon.

Fara që kishte mbjellë ndër ta nuk do të humbiste.

Iu kujtuan fjalët që kishte shquptuar kur ia lexuan dënimin me vdekje:

"Major forsitam cum timore sententiam in me fertis quam ego uccipiam".

Do të donte të fliste përsëri, po u ndërjegjësua që ia kishin lidhur gjuhën.

Ja, po e zhvishnin lakuriq - poshtërimin e fundit - po i hidhnin "sanbeniton", po e lidhnin pas shtyllës ... drurët kërcisnin, flaka po ngrihej...

Njeriu që po vdiste i hodhi një vështrim të etur Fushës së Luleve³ dhe kërkoi një fytyrë njeriu për ta parë për herë të fundit.

Ndeshi një shkëlqim të çuditshëm, gazi e lotësh, vështrimin e pafajshëm dhe të trembur të një fëmije, të një djali tetëvjeçar brun dhe kaçurreles, me sy të mëdhenj e të zgjuar të cilin e mbante për dore një grua e re dhe e bukur, e veshur në të kaltra.

Fjalët e fundit që i arritën veshit të tij ishin fjalët e tyre:

-Mama, pse e djegin atë?

-Pusho, bir, ai është një njeri i keq, magjistari.

-Mama, kam frikë, flaka po ngrihet, po e djeg atë, sa keq më vjen, mama!

-Shën Mëri, na ruaj! Ç'janë këto fjalë, bir? Kisha e Shenjtë di se ç'bën.

Djali i vogël ia hodhi përsëri sytë atij që po vdiste dhe e ndeshi vështrimin e atyre syve, një vështrim krenar, të patrembur.

Iu kujtuan shenjtoret, martirët, për të cilët kishte lexuar që s'kishin frikë të vdisnin për një të vërtetë të shenjtë.

Ai mendim e trembi. Si ishte e mundur, ai që po vdiste ishte njeri i keq, magjistari!

Po flaka e blertë u ngrit më lart, e përfshiu të tërin njeriun e lidhur dhe djali shpërtheu në ngashërime dhe s'pa më asgjë. Vetëm ndjeu shtërgimim e dorës së nënës dhe fjalët e saj të shqetësuar:

-Mjaft, bir, mjaft. Ç'po bën kështu, s'është mirë.

Kur e hodhi prapë vështrimin në shesh, djali s'pa veçse një grumbull me hi.

"Magjistari", "Heretiku", ish murgu Xhordano Bruno s'ishite më.

1 Me më tepër frikë e shquptoi ju dënimin që më jepni se sa e dëgjoj unë.

2 Një lloj pëllhure të ashpër që kishte vizatuar djaj dhe gjuhë flake.

3 Campo dei Fiori në Romë.

Rrugën për në atë qytet të vogël e bëri me tren. Në stacion zbritën edhe dy udhëtarë të tjerë. (Arriti t'u shquajë shtatin mesatar dhe ndonjë tipar të fytyrës). Nuk ishte aq vonë. Në rrugët mezi të ndriçuar s'ndihej këmbë njeriu. Iu desh të pyeste një nëpunës poste për të gjetur hotelin. Ai i tregoi me gisht, në përgjumje e sipër vezullimin e zbehtë të një drite jo shumë larg ndërtesës së PT.

Tek sporteli i hotelit pa dy nga bashkudhëtarët që patën zbritur me të në stacionin e trenit. U mërzi nga mendimi se do t'i duhej të kalonte natën në një dhomë me ta. Por hotelieri që kishte kuptuar mërzinë e tij, kur i kërkoi pasaportën, i tha se nuk e kishte fare të vështirë ta rregullonte në një dhomë teke.

Hoteli ku ai punonte, kurrë s'qe populluar ndonjëherë, aq sa të qe problem për vende.

Falenderoi, mori çelësat dhe u ngjit në dhomë. Kur po përgatitej të flinte, dëgjoi shiun. Ngriti perden për të parë. U rrënqeth prej errësirës. Ideja e mungesës së jetës e trembi. Filloi të mendojë për të ardhmen e tij në këtë qytet të vogël, me të cilin për herë të parë u takua këtë mbrëmje të lagur vjeshte.

Natën shiu qe dendësuar dhe bubullima të gjata e të forta, shoqëruar me vetëtimë, e zgjuan. Ngriti përsëri perden, siç kishte bërë orë më parë, kur përgatitej të flinte, por kësaj here me idenë se shumëçka jashtë ishte shkatërruar. Asgjë nuk ishte shkatërruar. Jsthtë kishte vetëm errësirë. Për një çast iu bë se ky qytet nuk kishte patur kurrë agimë. Atij do t'i duhej të jetonte në një qytet errësirë. Si masë paraprake ushtrimore, u përpoq ta përfytyronte veten qytetar të kësaj errësire. Gjithçka do të ishte ndryshe. Shumë gjëra që kishin kuptim në kushtet e dritës, këtu do të ishin të pakuptimta. Nuk do të kishte stinë, nuk do të kishte vjeshtë, as mbrëmje pranverore. Shkurt, nuk do të kishte kuptim asgjë që vjen nëpërmjet figurës; as ekspozita, as filma, as libra, (as që mund të bëhej fjalë për to). Njerëzit, në qoftë se do t'i quanim kështu, nuk do të kishin idenë e formave të tyre trupore. Nuk do të bëhej fjalë për vajza të bukura, për sy të kaltër e të zinj, për flokë biondë apo pendë korbi. Gjithçka që kishte lidhje me figurën do të ishte e pakuptimtë në këtë mbretëri të zezë.

Përveç kësaj zeznaie, i vetmi element tjetër i pranishëm do të ishte tingulli, i cili do të orientonte qenien njerëzore. Në këto kushte, organi i perceptimit të tij, në mos i njëjtë, së paku do të ishte i ngjashëm me atë të lakuriqëve të natës. Qytetarët e errësirës do t'i kishin veshët pak më të gjatë për perceptimin sa më të plotë të tingujve dhe deshifrimin e tyre sipas kodeve lakuriqiane të errësirës. Kaq shumë u dha pas këtij imazhi, sa filloi të mendojë për përshtatjen e tij. Forma e mbajtjes së flokëve nuk do të ishte tani një çështje parimore. Sytë do t'i reduktoheshin, duke e humbur tërësisht funksionin e të parit. Duke u përshtatur me errësirën, kjo do të ishte një nga ato humbjet pa dhembje fizike. Derisa të përsosej tek ai organi i perceptimit ngjashëm me atë të lakuriqëve të natës, do ta kishte të vështirë. Në përpjekje për të ecur në rrugët e errëta, do të rrëzohej e do të përplasej me objekte të ndryshme. Përfytyroi veten të përplasej me një shtyllë dhe nga hundët t'i dilte gjak. Në atë gjendje mendoi se për ndokënd nga banorët e errësirës mund të ishte një kujtim tronditës. Vazhdoi të mendonte për përshtatjen e tij metamorfike. I erdhi keq për veten nga ai shfytirim monstruoze në pushtetin e errësirës. Më keq i erdhi për sytë dhe flokët. Prej tyre kishte qenë i lakmuar nga vajzat. A do të kishte vajza ky qytet? Përdërisa figura do të ishte e pakuptimtë në këtë mbretëri të zezë, ç'gjë tjetër do t'i bënte joshëse ato, veç tipareve të fytyrës dhe formave trupore feminele? A do të kishte dashuri në këtë qytet? Iu kujtuan dashuritë e tij në qytetet me dritë. Në kujtime të ëmbla e sipër, e zuri gjumi.

U zgjua në orën 7 të mëngjesit. Ndjeu kokën e rëndë dhe shijen e keqe të gojës. Kur i ndodhte kështu, i dukej se ishte i rrethuar nga sende në kalbësim e sipër. Këtë përshtypje kishte edhe për trupin e vet. I bëhej se diçka brenda tij ishte kalbur apo po kalbej dhe kundërmimi i dilte nëpërmjet gojës. Duhet të vishej dhe të paraqitej në bankën ku do të fillonte punën e re. Pasi u vesh, u paraqit në sportel ku dorëzoi çelsin e dhomës. Nuk harroi ta porosisë hotelierin të mos ia zinte dhomën. Ai do të rrinte gjatë në atë qytet. Hotelieri përsëri iu përgjigj, si mbrëmjen e kaluar. Në atë hotel s'kishte ndodhur kurrë të

NJË SHFAQJE NË QYTETIN E VOGËL



Nga Skënder Karriqi

ishte problem për vende. Nëse klienti donte të rrinte gjatë, hotelieri s'kishte pse t'ia zinte dhomën. Pyeti se ku ndodhej banka. Pasi mori përgjigjen, u nis shpejt andej nga i thanë dhe nuk e dëgjoi hotelierin që foli zëshëm me vete, i habitur se çdo të bënte ky njeri që do të rrinte gjatë në qytetin e tyre. Atij kurrë s'i kishte qëlluar t'i binte në dorë dy herë e njëjta pasaportë. Kurrë s'kishte parë dy herë të njëjtën fytyrë bujtësi në hotelin e tij, as në qytetin e tij. Ndërsa ky do të rrika gjatë!

Duke ecur për në bankë, vuri re se nuk po këmbëhej me njeri. Po të mos kishte parë dy vetë që, nga veshja dhe llapat e karbitit, kuptohej se ishin minatorë, do të mendonte se po shkelte një rregull ndalimqarkullimi. Kishte dëgjuar të flitej për rrugët e zbratura ditën dhe të pandriçura natën në qytetet e vogla. Arriti në bankë. Takimi me përgjegjës nën nuk qe i gjatë. Në hapësirën e përbashkët pa edhe katër punonjës të tjerë. Secili punonte në heshtje me shifra, kupona, mandate etj. Nga një aneks dëgjohej tastiera e ngadaltë e një makine shkrimi. Kërcitjet e thata i kujtuan procesin e mbërthimit të arkivoleve. Nuk e kuptoi se nga u shfaq aty një punonjëse e re. Në fytyrën e saj nuk mungonin shenjat e bukuri, por e mundonte një ndjenjë ankthi. Ishte një ankth pritjeje e gjatë. Përgjegjësi i tha se me drejtorin e qendrës kishin vendosur që ai të fillonte nesër punë. Sot mjaftonte paraqitja e tij.

Doli në rrugë. Mendoi të gjente një mensë ku të hante a të pinte gjësendi. Gjeti një të tillë dhe mbaroi punë. Endja në kërkim të mensës qe e mjaftueshme për t'i rënë kryq e tërthor atij qyteti të vogël. Përshtypje të veçantë i bënen bordurat e trotuareve. Ngjanin me kufizues përtej të cilëve nuk duhet të kalohej. Trotuaret ishin të pashkelura. Arriti në hotel. Mendoi të flinte. Do të zgjohej të hante drekë dhe përsëri do të flinte. Asnjëherë nuk kishte qenë në gjendje të tillë përgjumjeje. E lidhi gjendjen e tij me pamjen gjumëndjellëse të qytetit. Kjo duhet të ishte edhe arsyeja e mungesës së njerëzve. Para se ta zinte gjumi, i shkoi mendja tek e kaluar e tij plot andralla. Në këtë qytet të përgjumur, i dukej se të gjitha i kishin ndodhur në një planet tjetër.

Në mesnatë do të bindej për të kundërtën e qytetit të përgjumur. E zgjoi sirena e një autoveture. Doli në dritare për të parë se ç'ndodhte jashtë. Në rrugën e bankës dalloj një grumbull njerëzish. Diçka u bisedua në grup. Shtatë-tetë prej tyre u shpërndanë në drejtime të ndryshme. Të shpërndarët kishin lajmëruar qytetarët të mblihdeshin. Këtë e kuptoi kur njerëzit filluan të mblihdhen nga drejtime të ndryshme. Së pari shkonin tek makina që duhej të ishte autovetura me sirenë, duke treguar haptas kureshtjen se ç'kishte në të. Atje një gjatosh i drejtonte për nga sheshi i kinoklubit. Ky qytet, që ditën ishte i përgjumur, tani në mesnatë, për një moment po i dukej i gjallë, kureshtar. Perdet e autoveturës nuk lejonin të shihej se ç'kishte brenda. Njerëzit ngrisheshin në majat e gishteve. Drita e zbehtë e një neoni bënte që hijet e tyre të stërgjateshin përçudnueshëm. Dukeshin hije njerëzish pa kocka, pa shtyllë kurrizore. Dëgjoi të trokitura në derë. Ishte hotelieri. Ai tha se duhet të dilte tek sheshi para kinoklubit. E pyeti hotelierin se ç'po ndodhte. Hotelieri i tha se këtë mesnatë, në sheshin para kinoklubit kishte teatër. Të gjithë qytetarët duhet të dilnin dhe të shikonin. Duhet të dilnin edhe bujtësit e hotelit. Hotelieri i tha se ata asnjëherë nuk kishin ardhur kaq vonë. Duhet të vinin më parë. Përgjigja e hotelierit iu duk e çuditshme dhe e pavërtetë. Ç'ishte ky teatër në mes të natës?! Ç'ishin ata aktorë që pranonin të luanin në këtë orë?! Ç'pjesë do të luanin?!

U vesh dhe doli. Donte të dijë se ç'qe kjo shfaqje teatrale që e shkuli këtë qytet nga gjumi i natës, (Këtë qytet që edhe ditën ishte përgjumur, pale natën). Tek sheshi i kinoklubit katër-pesë vetë po improvizonin një piacë me dërrasa parafabrikate, të ngritur rreth një metër. Një tjetër po montonte nje prozhektor. Një mesoburrë fliste dhe bënte shumë xheste. Nga qëndrimi që mbante, dukej se ishte inspektori i skenës. Kërkonte që prozhektori të levizte më në qendër. Drita të binte nga lart-poshtë, pingulthi. Figura të dukej nga të katër anët dhe sa më e zbehtë. Deshi të pyeste se ç'ishte kjo shfaqje, por ata po vinin. Nga makina doli gjatoshi që kishte parë nga dritarja. Tani i shquhej jo vetëm gjatësia e shtatit, por edhe tiparet e fytyrës vvarëlije. Ai pa orën nën dritën e fenerëve të makinës. Ishte i pakënaqur për shkak të vonesës. Një plak i tha se ata nuk i kishin pritur kaq vonë. Pasi kishin pritur deri në orën tetë të mbrëmjes, njerëzit qenë futur në shtëpitë e tyre. Gjatoshi i tha se shfaqje të tilla parashikohen edhe në mesnatë. Efekti i tyre në këtë orë është i jashtëzakonshëm. Urdhëroi të mbaronin rregullimin se do të fillonin. Bujtësi asgjë nuk po kuptonte. Mendoi se ishte në ëndërr. Por pamjet ishin konkrete, të prekshme, të drejtpërdrejta.

Turma levizi për t'i hapur rrugë makinës. Ajo u afrua tek pjaca e improvizuar. Njerëzit u pozicionuan për të parë. U bë heshtje. Po fillonte shfaqja. Diçka doli nga makina, por nuk u vu re. Të gjithë i kishin mbërthyer sytë nga pjaca. Pas dy-tri minutash u ndez projektori. Nën dritën e tij qëndronte një gjysmëkufomë si e zënë peng. Para dhe mbrapa i kishin vënë dy beze të bardha dhe të shkuara. Ato fillonin tek koka dhe mbaronin tek këmbët. Mbi atë që i ishte vendosur para shkruhej; "Tradhëtar i Partisë dhe i Atdheut". Mbi atë që i ishte vendosur mbrapa shkruhej; "Shkelësit e kufirit në litar". Gjatoshi urdhëroi me gjepte dikë që ta rrotullonte gjysmëkufomën. Në pjacë hipi një bullafiq i devotshëm dhe bëri ç'i thanë. Njerëzit shikonin të përqëndruar si të lexonin ndonjë libër të shenjtë apo të shihnin skena fantastike nga rrëfimet e shenjta ku ndëshkoheshin rrebelët e qiellit. Ishte një shfaqje tragjike. Pas disa rrotullimeve gjysmëkufoma u rrëzua. U dëgjua një zhurmë e mbytur sendi që bie. U ndie një rënkim nga grumbulli i njerëzve. Bujtësi dalloj një nënë 60-vjeçare. Nën dritën e zbehtë të prozhektorit ai mundi të dalloje profilin e saj me tipare të rrafshuara, si një pllakë e vjetër, me mbishkrime të fshira nga koha. Gjysmëkufoma nuk mund të ngrihej më. Njeri nga pleqtë në radhët e para hipi në pjacë. Në mënyrë rituale ai thirri me zë të fortë: "Shkelësit e kufirit në litar". Thirrja u përserit nga të gjithë shikuesit njëzëri. Vendimi qe marrë. Në fillim ai qe shkruar në zyra të prokurorisë. Pastaj i qe shkruar gjysmëkufomës përgjatë shpinës, nga koka tek këmbët. Ishte komunikuar publikisht nga ky plak dhe ishte miratuar nga përsëritja korale e shikuesve. Ky ritual ishte dhe epilogu i atij teatri të çuditshëm.

Prozhektori mbi pjacë akoma nuk qe fikur. Njerëzit filluan të shpërndahen në heshtje. Dëgjoi nga pas klithma të vjellash. U shtang kur, nën dritën e prozhektorit, që qeshej me njerëzit, dalloj fytyrën e punonjëses që pati parë në bankë dhe që atij atëhere i qe dukur se vuante nga një ndjenjë ankthi, një ankth pritjeje e gjatë. Pranë saj ishte një mesogrua e cila përpiquej ta justifikonte dobësinë e vajzës. Duhet të ishte e ëma. Ajo tha se vajza e saj e kishte për herë të parë. Iu kujtua se diçka e tillë, e përtafërt, thuhej edhe në rastet e shtatzanive të para të nuseve. Ishte i lodhur prej shfaqjes makabre. U kthye në hotel. Atje e priste gjumi i vvarë.

Stravaj-Prenjës, 1989.

(Vijon nga fq. 11)

vra një udhëtar që rri në kuvertë të anijes, zhytur në shoqërinë e natës së detit e të mendimeve të veta. Pse? Vetëm se ai është dikush i ndryshëm. Nuk u pëlqen pamja e tij, u duket mendjemadh ose botë në vete. Ta qërojmë!

Në rastin më të pafajshëm - që prapë është dhimbje - drejtpeshimin moral të njeriut e prish instinkti i mbijetesës. Të varfërit në tregimin e Ilija Venezis tronditen për valën e refugjatëve, jo se u vjen keq për ata shkretanë të shkretë. Te dyndja e tyre shohin një rrezik ekzistencial për veten. "Derrat e ndytë, shau njëri. Me siguri do të marrin edhe vendet ku do të mihim ne". Është vetëzbërthimi i njeriut të thartuar, të shpërbërë nga kriza. Tregimi lexohet si një shembëlltjërë e shkapetjve në botën e sotme, mes të cilave spikatatin krizat e refugjatëve. Kriza që po trandin themele shtetesh, themele sistemesh dhe shoqëri vlerash.

Ndërsa, siç thuhet, shkenca luhetat ndërmjet pyetjeve të shumta e përgjigjeve shumë herë më të pakta, letërsia, me mëdyshtet e kumtet e përthyerë në art, nuk mëton me dhanë përgjigjeje. Ajo zhbiron në brendësitë e njeriut. Mbase herë pas here rreket me ndezë një dritëz shprese. Po ç'është shpresa, është realitet, utopi apo lëkundje ndërmjet kësaj mëdyshtjeje që e bën dhe e zhbën? Njeriu që e sheh i pari anijen e lirisë në det, te tregimi i Petro Aris (Charis) *Dritë në det*, është një i marrë. Pas tij një nga një e shohin të tjerë, që nuk janë të marrë. Bashkë nuk e shohin, veç e veç e shohin.

Janë të marrë kur e shohin a kur nuk e shohin? Një tjetër mëdyshtje kjo.

Spiro Ciro (Tsiros) duket sikur sjell një përgjigje, por është thjesht truk. Fton me fiksue në celulozë një personazh paqëtues, Mirësinë. Kumt i bukur, por i pagjasë. I përshkuar nga një lloj naiviteti, si në krijimet për fëmijë, nuk di kujt i drejtohet më fort tregimi: fëmijëve apo të rriturve, që harbojnë çarturisht pas interesit të ngushtë e bëhen më të vegjël se vetë të vegjël. Letërsia njih vepra të mëdha e të zakonshme, që përdorin gjuhë fëmijësh, duke pasur cak të mëdhenjtë. A nuk është dallues ky stil te *Princi i vogël* i Ekzyperisë?

Intrigues vjen në këtë antologji emri i një shkrimtari politikan. Bota e artit njih këngëtarë me emër - Sharl Aznavuri, për shembull - që mbasi kanë arritur shumëçka me zërin e muzikën, sfidojnë me një aventurë të re, provojnë, pse jo, edhe aktrimin. A është i njëjti trill te politikanët, që kthehen me fytyrë kah letërsia?

Duke lexuar prozën e Niko Papandreut, ndien se nuk është politika që ia ka çelë autorit derën e botës së letrave. Këtë derë e ka çelë shkrimtari i fshehur brenda politikanit. Proza në "Dhjetë rrëfenja dhe një histori" rrjedh, të çon në ajrin e veçantë ishullor të Kretës, e cila është më tepër se ujdhesë në kuptimin gjeografik. Të njeh me karaktere origjinale, shplon detaje etnografike, depërton nëpër imtësi psikologjike. Gjithnjë nën një dozë të holluar humori ose ironie dashamirëse, edhe ndaj vetes. Kavafis, thotë dikush aty, besonte se politika është vdekje për familjen. Duke u kthyer nga ky pohim i mjeshtrit të poezisë, bëjmë pyetjen: po për letërsinë, çfarë është politika?

Te njeriu i talentuar politika nuk mund ta vdesë letërsinë. Ani pse gjasat janë se i hyn në hak.

Faleminderit.

Tiranë, 05 prill 2024

NUK KA ITAKË

Në këtë udhëtim nuk ka liman ku të mund të hedhësh spirancën
nuk ka vend që quhet Itakë.

Dëgjo, djalosh!
Dallgët do ta përmbysin anijezen tënde
prej letre
dhe ti do të gëlltitësh ujin e kripur
do të notosh në det të hapur do të përpish
detin me krahët e shtrirë
duke ditur se vija e horizontit do të mbetet
gjithmonë para teje
si litar i tendosur.

Një anije tjetër do të fundoset sërish
një tjetër dashuri do t'i dorëzohet stuhisë
ëndrrat e tua, vetëm ato nuk do të
fundosen – atdheu yt është një ishull i
largët
një vetmi të përndjek si vetmia e perëndive
dhe ti zhytur në këtë blu të paanë
i heshtur si Krijuesi
do të ngresh kokën e përulur mbi dallgët e
zemëruara.

Nuk ka vend ku të qetësohen vuajtjet
nuk është koha për lot e të qeshura
- dhe mandej ky shpërthim i së qeshurës
për një lumturi kalimtare
vallë çfarë mund t'i mësojë njeriut? -
dhimbja do të të maturojë dhe do mësosh
më në fund
të vallëzosh në akull

të vallëzosh në akull.

MUSTAFAI I MARIKËS

Xham i lulëzuar, te shtëpia e kopshtarit,
ah mos më kallëzo!
I pashë përmes kërcjeve të tejdukshëm të
luleve,
xham i lulëzuar.

I zhveshur, del nga banja Mustafai, duke
pikuar,
tendoset lastar
përpara Marikës -
duhet të jetë i marrë Mustafai
gruaja fillon të zhvishet dhe ajo
dalëngadalë!

Oh, lulevath, vathët e mbretëreshës,
në xhamin e kopshtarit
tekta shtrihen bashkë lakuriq, të
mbështjellë
si dy foshnja në djep
as grek as turk ligjërimi i tyre

HYJNIA E ERËS

Poezi nga Mehmet Jasin

Përktheu: Petro Çerkezi

Mehmet Jasini ka lindur në Nikosia të Qipros në vitin 1958. Është ndoshta poeti
Mqipriot turk më i njohur dhe më i vlerësuar në shkallë ndërkombëtare. Në të njëjtën
kohë, ai konsiderohet edhe si një nga poetët më të rëndësishëm modernë turkofonë.

Poezia e tij është një zë rezistence dhe proteste ndaj luftës, është klithmë e
dhimbshme dashurie e tokës mëmë, është shi i trazuar me gjak, është rrugë dhe ëndrra
të prera në mes prej lumi gjaku dhe teli me gjemba.

Mehmet Jasini është njeriu i paqetë dhe shpërthyes, poeti lirik që nuk pushoi kurrë
së dashuruari poezinë e jetës së munduar e të plagosur, lirizmin e lidhur me mijëra fije
me vendlindjen, Qipron, është antikonformisti ekstrem në raport me jetën politike dhe
shoqërore dhe me problemet ndëretnike duke e parë gjithçka me sy kritik.

Vepra të tij janë përkthyer e botuar në 12 gjuhë europiane, kurse krijime të veçanta
në 64 gjuhë. Këto ditë Shtëpia Botuese NERAIDA e solli poezinë e Jasinit edhe për
lexuesin shqiptar me vëllimin "Engjëj hakmarrës".

Vlerat e poezisë së Mehmet Jasinit, të sjella mjeshtërisht në shqipe nga poeti dhe
përkthyesi Petro Çerkezi u evidentuan nga poetja e mirënjohur Natasha Lako dhe folës
të tjerë në takimin e zhvilluar me rastin e prezantimit të librit në ambientet e Qendrës
Kombëtare të Librit dhe Leximit.

*lulevath lulevath
asgjë nuk kuptova oh,
lulevath.*

shndërroji në vathë psherëtimat e tyre!

Mustafai i Marikës është marrok
Por më e marrë është Marika.

KOHË LUFTE

Po flisja me vete që të mos më dëgjonte
njeri
dhe të gjithë shquan mençuri në heshtjen
time!
Turqishtja ishte e rrezikshme, nuk duhej
folur,
dhe greqishtja ishte absolutisht e ndaluar.
Të rriturit që donin të më shpëtonin
prisnin
secili me gishtin në këmbëzën e një
automatiku.
Gjithsesi, të gjithë ishin ushtarë të
gatshëm në atë kohë.
Anglishtja ishte gjithmonë në mes,
një prerës letre i hollë e i gjatë
mes faqeve të teksteve shkollore,
një gjuhë për të folur në kohë të caktuara
veçanërisht me grekët.
Kishte raste madje që nuk dija në ç'gjuhë

të përlotesha
Jetova një jetë jo të huaj – të përkthyer,
gjuha ime amtare ishte tjetër, atdheu im
tjetër,
unë vetë një tjetër.
Edhe në ditët e errësimit të detyruar ishte
e qartë
se nuk do të mundja kurrë të isha poet i
një vendi
i përkisja pakicës - dhe "liria"
ishte fjalë e pakëndshme në të gjithë
fjalorët etnikë...
Së fundi tri gjuhë u përzien në poezitë e
mia
as turqit nuk mund të ndienin kurrsesi atë
që ndieja unë
as grekët, as të Tjerët -
Por nuk fajësoj askënd, ishte kohë lufte.

SHTËPIA E VDEKUR

Muri i zbardhur atje ku dikur qëndronte
ora
Tavolina prej arre e harruar nga koha
Gjurmë gishtash që pastruan pluhurin
Çelësa të humbur

Kuti postare me brava të ndryshkura

Letargjia
e plakës që vuri protezën e dhëmbëve në
ujë

*Dhe kjo makinë shkrimi ku im atë
daktilografoi poezitë e para, kjo shtëpi ku
nëna ime u dashurua dhe vdiq - e pushtuar
nga çdo luftë, e pushkatuar, e djegur, me
plaçkitjet e pajave të ruajtura në sëndukët
otomanë - dhe pasqyrat që i panë lakuriq të
gjitha gratë e familjes, pasqyrat, pasqyrat
që mbulonin fytyrat me çarçafë - gjithë
lulet të vyshkura, të gjitha përveç aromës së
trëndafilave të egër kacavjerrës - koha kur
gjyshja ime i ruante brenda në peceta me
dantella të bardha - kjo fantazmë e vogël
që këmbëngul të kthehet në vendet ku u
vra - hijet e gjata të heshtura të selvive të
prera - tani të gjithë banorët e kësaj shtëpie
shikojnë fshehtas në mesnatë prej fotove ku
ende jehon histerike e qeshura e luftës - një
burrë me feste shikon prapa xhamit duke
harruar pse qesh - dhe shtëpia pyet veten
pse
më lanë të gjallë ata që vranë gjithçka që
më takonte - dhe befaz ndizen dritat në
dhomën feminare ku lind kjo poezi.*

Shtëpi e Vdekur Shtëpi e Vdekur Shtëpi e
Vdekur

Poezia vetëm asgjë tjetër
nuk mund të më detyrojë të kthehem në
këtë shtëpi.

SAHATÇIU I VOGËL

Gjithë njerëzit i besonin sahatin e tyre,
secili mbetur në kohë të ndryshme.
Cila orë ishte e saktë, cila gabim
në këtë vend pa diell, sa është ora vërtet?
Pastaj, tekta shtrihet, nga dritarja e largët
e përrallave
çdo minutë *kuku kuku kuku kuku* -
Koordinimi i Kohës është punë delikate
ingranazhet të kafshojnë duart çdo çast.
Ndërkohë, ai ishte një fëmijë klepsidër rëre
që zhytej për të dalë duke
mbartur të ardhmen
sirenë-çapëne, det çapëne
madje dhe mësues qofsh, më mirë
nxënës të mbetesh në botë,
Orët nuk do të të falin asnjë sekondë
të tërhiqesh në vetvete
kuku kuku ti djali-zog, ngjyrë e gjelbër
ende në syth.
Baba nënë pleq, prindër të përkushtuar



erdhi nga provinca, për bukën e gojës udhëve të rrudhosura mëngjeseve, mbrëmjeve, angari dhe kërcënime, keqtrajtime seksuale...

E detyronin të jetonte një kohë që u përkiste të tjerëve dhe sikur të mos mjaftonte kjo

iu desh të koordinonte orët e gjithë qytetit në këtë orë të shkuar

[ora e të burgosurve të tij]
kuku

DALLËNDYSHE

Më ndodh shpesh në gjumë që ndiej se po qaj dhe nuk e di përsenë, ose ndoshta e harroj arsyen kur zgjohem. Dhe kur përpiqem të hap sytë ngadalë, atëherë faqet e para të gazetave shpërthejnë para meje. Ah, të mund të zgjohesha nga poezia! Por i gozhdur duke klithur në heshtje të këndoje poezinë, të këndoje poezinë. Ka raste kur bëj dashuri me një krijesë pa fytirë, ose ndoshta harroj të gjitha fytirat që kam dashur. Janë dhe ca ëndrra që më kthejnë te fëmijëria ime para se të shpërthehte lufta, përpara se të më vdisnin prindërit para se ata që njihja të shpërndaheshin në fund të botës. Por të gjitha këto janë kaq të largëta sa nuk mundem t'i kujtoj edhe po të përpiqem dhe të dua kështu pra fluturoj në gjumë për ndonjë vend tjetër fluturoj fluturoj fluturoj fluturoj.

Por nuk arrij të kuptoj se ku ndodhem në ç'qytet, në ç'dhomë, në cilin shtrat, në cilën anë ta kthej fytirën dhe në ç'gjuhë të përgjigjem teksta më pyesin në gjumë - dhe pastaj nuk mundem të dalloj ç'zogj fluturojnë në qiell: të jetë vallë kalandër, të jetë turtulleshë, apo dallëndyshe, po, besoj se dallëndyshe ishte ajo që shihnim nga terraca e shtëpisë sonë në Lefkë.

[thashë e shtëpisë sonë?]

Ka çaste që ndiej se qaj në gjumë.

Dallëndyshe: shumë herët, nuk e mbaj mend as kohën as vendin

HUMBJE E HIDHUR

Po të mos e kisha humbur, nuk do ta gjeja Vetëm ai është i pavdekshëm

Në qoftë se nëna ime nuk do të kishte vdekur kaq herët, nuk do të më duhej ta ringjallja dhe po të mos më kishte braktisur im atë, nuk do t'i kushtoja fare vëmendje... (Linda në një shtëpi të destinuar për t'u plaçkitur dhe kështu, me luftën, kjo shtëpi e mallkuar u bë Toka jonë e Shenjtë.) Kush nuk ka humbur kurrë asgjë do të bëjë një interpretim tjetër duke besuar se kupton gjithçka, por si i bëhet të kuptosh poezinë nëse nuk e dëgjon të lexuar nga thellësia e zemrës? Ashtu si mbetet në sy rrahja e flatrave të zogjve tekta fluturojnë ndërsa degët e pemëve kanë mbetur prej kohësh të shkreta,

kështu edhe poezia. Por ndoshta nuk do t'i kisha kaluar kurrë kufijtë e vetvetes sikur të mos isha dëbuar me forcë nga parajsja ime e parë e poezisë. Tashmë e kuptoj se poetët grumbullojnë shumë nga mjerimet, heshtja, njollosja e ngadalhtë e të gjitha pasurive të tyre, humbur përgjithmonë, vetëm për t'u rigjetur sërish shumë më vonë, si poezi.

Këtu prehet

NË PUS SHKRIMI I KEQ

“Pusi juaj ka pisllëk”, thanë, ne vumë pasqyrën, asnjë reflektim, hodhëm një gur heshtje... (A do të thërrasim zhytës tani?) Më janë tharë lëngjet gjarpërinjtë, dyzetkëmbëshat, krimbat, plehurat. Tani jam një gjiriz një vend pa ajër dhe dritë (një mijë kate më thellë se një varr i zakonshëm) unë, me ndihmën e kalorësve që më shpëtuan jetën, jam flijim, viktimë dragoi. Mbuloni! Mbuloni! Jam një shpirtlig i vdekur. (Në emër të mirësisë më bënë aq keq sa u katandisa dhe unë i keq.) Ju lutem, mos më lexoni! Duke shkruar të keqen pa ndalur ju bëj të harroni të mirën.

NË KREVAT

Rrëshqet në këmbët e krevatit dhe krusullohet përmbyks sikur të mos shtrihet me ty. Në kutinë e vogël të mbyllur muzikore ku kërcen një balerinë, fle në fshikëzën e mëndafshhtë të këpucëve rozë të foshnjës sikur të mos flinte... E tërhoqi çarçafin tërësisht nga ana e saj. Ti mbete lakuriq. Ajo e mbuluar. Dhe nuk mund ta hapësh as kutinë mikroskopike muzikore. Ngrihesh dhe shikon një ëndërrshpjegues që të mundesh t'i interpretosh të gjitha këto i shtrirë vetëm në shtrat... Thua se ishte dikush tjetër që shihe në gjumë ëndrrat e tua.

HYJNIA E ERËS

Perëndia e erës është elokuent në fund të verës fjalët e tij thumbojnë pemët i përgjigjen me dashamirësi. Perëndia e erës tërbon dallgët nxit retë mbi biçikletë dhe pastaj hedh një top të kuq në ujëvarë. Perëndia e erës u jep jetë zogjve dhe fluturave dhe netëve në male kalon duke fishkëllyer nëpër shpellat e stalaktiteve. Perëndia e erës i favorizon fëmijët u zgjidh kordelet duke kaluar nëpër leshra duke u shkaktuar dridhje të çuditshme. Perëndia e erës merr me qira shtëpi në ishujt verorë, të fton, këmbëngul heq dorë nga të gjitha dhe vjen të të flasë. Perëndia e erës u qep flatra fytirave por ai që nuk mund të ngrrejë lart është shpirti yt që nuk është gati të fluturojë.

PADASHUR E LËNDOVA GOMARIN

Tregimi nga Luan Rama

Trokëllima e fjalëve derdhur rrëmuqshëm si gurë të formësuar në një tru idioti qe aq e beftë për mua, sa për një çast m'u duk se gjendesha në Përroin e Marrëzisë e jo në atë zyrë, ku njeriu në të djathtën time gjendej paradoksalisht prej një rastësie të habitshme dhe të pakuptimtë.

Po prisja të heshtëte që të mund t'i arsyetoja se isha aty prej ftesës së tij, siç kishte ndodhur rëndom që prej kur ai ishte në atë detyrë, por derdhja e fjalëve e kishte rrëmbyer aq pavetëdijshëm sa po e shtynte në një rrokullimë të pakthim.

Fati e solli qe ai të ndjente nevojën për të pirë ujë që të mund të ndërhyja.

-Vërtet më vjen keq, më vjen shumë keq për veten, - i thashë qetë e ngadalë, duke ia artikulluar fjalët germë për germë e të rrokëzuara që të mund t'i dëgjonte të plota e ta kuptonte se çfarë po i thoja.

Syzgurdulluar e me ballin që iu rrudh edhe më tepër me një zgjatim jo fort anatomik, pyeti si i sapozgjuar:

-Pse?!

-Sepse nuk e paskam ditur që kam patur për mik një gomar, iu përgjigja menjëherë, duke pritur se çfarë do të thoshte. Por heshti. Mbase nuk e kuptoi se çfarë i thashë. Ose e kuptoi dhe i pëlqeu. Nuk e di e nuk do të kem më asnjë mundësi ta mësoj se çfarë ndjesie i provokoi atij njeriu ajo që i thashë.

Pas shungëllimës së fjalëve të shqiptuara përgjysmë që nxorri nga goja e për të cilat vura se se as skuqej e as zverdhej, e ndjeva se kjo qe fjalja e vetme që mund të thoja. Të vazhdoja e të qëndroja ende aty përballë tij ishte e pamundur. Jo se prisja të thoshte ndonjë fjalë të mençur, por të paktë mendova t'ia kursej vetes praninë aty ku ai po shfaqej aq i pacipë. Edhe aq kisha duruar më shumë nga sa ja lejoj vetes. Për të mos ia hedhur më sytë e zhvendosa vështrimin tek personi i tretë, por vura re se i bezdisur ndjehej edhe tjetri, personi përballë meje e në të djathtën e atij, i cili u ndodh në një skenë ku me siguri nuk do të donte të ishte i pranishëm. Sepse nga njëra anë ishte shefi i tij e përballë unë.

M'u desh të ngrihesha e të ikja me vërtik nga ajo zyrë, duke lënë pas shpine shëmtinë e një njeriu mosmirënjohës.

Mbase nuk ishim miq. Nuk ishim as shokë, edhe pse unë e nderova dhe e besova sa një mik.

Ai më quante vëlla. Kështu më shkruante sa herë më ftonte t'i shkoja në zyrë apo në vilën në periferinë e qytetit ku banonte prej pak kohësh. Shkoja me dëshirë. Donte ta ndihmoja dhe unë e bëja me kënaqësi. Jo ngaqë më quante vëlla, por sepse realisht doja t'ie ecte puna mbarë. Pse ta fsheh, ndjehesha e gjendesha mirë në cilësimin vëlla. Më miklonte ajo fjalë sa herë e lexoja apo e dëgjoja. Sepse ndjeja se më sillte prej tij njeriun. E me veten mendoja se i ofroj padyshim diçka të mirë, diçka prej vëllait. Ndryshe pse do ta ndjente nevojën të më quante vëlla? Mund të më drejtohej edhe thjeshtë në emër. Unë njësor do të të nderoja. Për njeriun që mendoja se ishte. Doja të besoja se ishte njeri i mire dhe se detyra e re e shumë e rëndësishme do ta bënte edhe më të mirë.

Sa e sa herë i kam thënë; dua je njeriun që je dhe bëji edhe të tjerët të të ngajnë në mirësinë që unë mendoja se e ke. Sepse e doja sa një mik. Dhe miku duhet mirë.

Mirëpo jeta është e çuditshme. Shpesh e pamëshirshme në befazitë e veta. Ajo është si një vorbull e madhe. Na rrëmben e përfshin, na përplas, na rrëzon. Na vë në sprovë.



Jo të gjithë ia dalin. Por ama të gjithë mësojnë prej saj. Herët apo vonë të gjithë mësojnë.

Unë jam i bindur se edhe ai do të mësojë një ditë. Paçka se prej pamjes gjithaq të pafajshme në dukje, më shumë prej antropologjisë së kafkës se sa prej të qeshurës së stampuar shëmtuar nuk shfaq asnjë premisë e nuk jep ndonjë shenjë se mund të mësojë, unë prapë shpresoj. Do të jetë ca vonë, por kjo nuk është më në dorën time. Nuk është as në dorën e tij.

“Rrugës për n'theqafje këtej pari i ranë...”. Ky varg i Migjenit më erdhe nëpër mend ndërsa po zbrisja shkallët e daljes nga ajo ndërtesë, ku për më shumë se tri dekada kisha hyrë e dalë aq shpesh, por kurrë me pezmin dhe dhimbjen që më shkaktoi biseda me frymorin që vetëm pak çaste më parë, teksa vendosa të ikja, gabimisht e kisha krahasuar me një gomar!

Jeta është e çuditshme.

Është e pamëshirshme, por e drejtë. Edhe zhgënjimi është pjesë e saj. Ai tashmë për mua nuk është zhgënjim. Ai është i vërtetë. Është i vërtetë dhe i vetmjaftueshëm.

“Unë e pranoj këtë zhgënjim se edhe zhgënjime ka në jetë”, kam shkruar dikur në një poezi.

Por, ndërsa rri e sjell nëpër mend atë ditë e gjithë sa ndodhi në zyrën ku lashë një njeri të bjerrë, ndje se një barrë faji më ka kapluar të gjithin që e lëshova gojën në atë mënyrë dhe e quajta gomar!

Ai nuk bëzani. Nuk tha asnjë fjalë. Mbase i ishin mbaruar fjalët. Ose nuk pati kohë t'i formësonte e t'i artikullonte, ngaqë unë përmenda gomarin dhe ika. Ndërkaq, ai shtangu. U mundua t'i japë fytirës një tis të qeshure, e madje në përpjekje për ta bërë sa më të dukshme këtë, hoqi edhe syzet si për të më dhënë mundësinë të shquaja për herë të fundit brenda atyre syve budallain e kollarisur, si për ironi të të gjithës, me kravatën që ia pata çuar vetë dhuratë.

Pse duhej ta përmendja gomarin përballë atij njeriu? E për më tepër pse duhej ta krahasoja gomarin me të?... Këtë nuk ia fal vetes.

Edhe pse jam munduar të shfaqësohem, pengun i asaj që i thashë pa u menduar më ka kapluar shpirtin. Pësia e fajit më rëndon si një barrë e lagme. Pse duhej ta fyeja e lëndoja aq shumë gomarin e mirë? Pse duhej ta përmendja në atë zyrë ku shëmtia jo vetëm si nocion estetik shfaqej përballë meje, përkundraill murit ku dominonte piktura e bukur, vepër e një piktori të famshëm, të cilën, në një nga ditët e shumta që kalonim bashkë, ia pata sugjeruar ta vendoste m'u aty, edhe pse e dija që sytë nuk i shquajnë dot asnjë kontur të saj, përveç një morie bojërash që në trurin e tij mbërrijnë si pllanga të pakuptimta?

Unë i dua shumë kafshët. Janë të mira kafshët. Edhe gomari është i mirë. Padashur e lëndova gomarin atë ditë vjeshte...

AURA

Në atë llohë dëbore mendimet më trazozin, sikur dridheshin në një fushë të bardhë, të paanë. Qerpikët më rëndonin nga një ngricë e lehtë që më së shumti vinte nga brenda sesa nga jashtë.

Doja ta nxirrja një cigare nga kutia metalike, ajo ka një mbishkrimin të çuditshëm që nuk e kam deshifruar dot, por natyra nuk donte ta prishte ngricën qoftë dhe me një flakë shkrepseje.

Ndejta gjatë afër drurëve që nuk po mund t'ua përcaktoja llojin ashtu si i kishte zhveshur dimri. Lloha e lehtë me qiellin e zbrazur nga çfarëdolloj rrezeje, ajri i ftohtë me drurët e zhveshur nga të gjitha petkat dhe përfytyrimet e mia të vjetra, të ikura bashkë me të, po më pëlqenin.

Kishte kaluar gati një vit dhe nuk i dihej si kisha mbijetuar për të mbërritur në këtë palcë dimri, për të parë këtë pamje që më së shumti më ka mbledhur në një qark të brendshëm për t'më treguar sa i dobet jam.

Po prisni një histori me gra, një histori të dhimbshme dashurie, ku tradhtia, ndarja e vdekja ma kanë mpikur zemrën e ma kanë dimëruar trupin. Asnjëra nga këto të lartpërmendurat s'është, nuk ka si të jetë. Sado tragjike të jetë ajo lloj humbje, sado e thellë të jetë humnera ku të ka hedhur, njeriu e ka gjetur shpikjen; vë plloça të mëdhenj mbi plagë, ngre shkallare që të kalojë në majë të gishtave dhe ikën disi. S'harro të hajë, nis të pijë ndonjë gotë për ta platitur sadopak dhimbjen dhe u kacavirret me thonj ditëve.

Halli im qe ndryshe. Kishte një vit që e kisha minuar zemrën.

Aura quhej.

E pashë një vit më parë, në mes të kësaj toke e këtyre pemëve, në mes të kësaj zbrazëtisë të lagësht e me temperatura nën zero.

Kishte veshur një pallto të rëndë të dalë mode, çizme me qepje të trashë anash, kishte lidhur një shall të thurur me dorë, dukej si një masë e madhe leckash mbi borë, sikur e kishte lëshuar nga asgjëja një re e kolme gri.

Iu afrova për t'i dhënë ndihmë në mes të atij acari, por u shtanga.

Një grua surreale nxjerr veten nga dengui i rrobave, me një daltë të vogël në dorë erdhi drejt meje, më pa thellë në sy, hyri brenda trurit tim dhe rrëmoi për të gjetur nuk di çfarë. M'i shkallmoi neuronet, ua hoqi atë bigorr që kishin zënë, i shkundi fort, aq sa u ra poshtë çdo grimcë a pluhur që përbënte një kuptim. U ul këmbëkryq në hipofizë dhe me dorë kontrollon e hoqi ato tumore që kishin mbirë si kërpudha në atë gjendër të vogël. I shtrydhi ndër duar sa asgjë e frikshme s'mbeti prej tyre.

Si i kontrolloi të gjitha shqisat, rregulloi, lau e pastroi çdo gjë, imthi e thërrimthi, vuri veshin e po dëgjonte atë gurgullimë të paqtë të venave, që pa alegori e shpinin gjakun te zemra si ujën në një mulli bloje. Së fundimi, hetoi së brendshmi çdo gjë me sy dhe vuri buzën në gaz.

O Zot, ç'punë të hollë kishte bërë!

Vuaj! Që nga ajo ditë që e takova Aurën time, ndiej praninë jashtëndijore të një dimri, gruaje të veshur keq apo një fati që nuk di pse më ka zgjedhur.

GAJA

Nuk dua të takoj asnjërin. Kini mirësinë të mos më dilni para, se përndryshe; do t'ju jap dorën dhe do t'ju pyes për shëndetin, punët e jetën në përgjithësi.

Gruaja që më përshëndeti ishte Gaja. As nuk e mendoi ç'po kuturiste kjo mendja ime, m'u afrova dhe me një buzëqeshje në dukje të çiltër, filloi të më pyeste për shëndetin, punët e jetën në përgjithësi. Për të ma lëshuar dorën m'u desh një copë herë



AURA

tregime nga Esmeralda Shpata

përpëlitje mes pëllëmbës së saj, ca djersë të imta mes gishtave dhe së fundmi një dorëzim e lëshim muskujsh.

As nuk e vrau mendjen ç'po më ndodhte dhe si me fuqi të marra nga pëllëmba ime hapi gojën dhe me një ton të prerë më tha:

"E di unë si të rregulloj ty, më kanë dëgjuar veshët plot çudira këto kohë, por kjo është tjetër gjë."

Me një të qeshur ironike në buzë belbëzova pa pikë turpi:

"Si?"

"Ruaj shëndetin, kujdesu për veten dhe prit."

Me kaq fjalë, u largua duke më lënë si statujë mes rrugës. Ika dhe unë duke u ia mbathur me tërsëllëmë nga skena e rastit se kushedi ç'dorë tjetër më zgjatej dhe në ç'favore më futte.

Ditët fironin dhe unë s'pata ndonjë qëllim konkret ta takoja atë fatën time, por, ikja nga ikja dhe këmbët po atje më çonin, atje ku kisha ndier një farë trazimi. Nuk doja ta jepja veten dhe sapo i afrohesha vendit ku u takova me të shikoja egër dhe me inat. A thua do t'i vija pikat mbi i me ato reagime naive.

Gaja ishte egoja ime. Unë jam një asgjë pa Gajan, ky mendimi i të qenit pa gjë më buis si një pikël në tru, me ca dridhja si brisk.

Gaja është e paarsyeshme, ka marrë një sharrë dhe një pozicion prerës.

M'i pret mendimet sikur të ishin krahët dhe këmbët e mia. M'i bën masë para syve si një lëndë drusore që s'bën punë për mobilje, e shumta që mund të bësh me të është ta dëgjesh e të ngrohesh kur të hyn i ftohti në palcë.

Gaja më ka gjymtuar, kështu sakat si jam më flet për punët që s'i ndreq dot, shëndetin që po më lëshon çdo ditë dhe për jetën. Qëllimi i saj ka qenë gjithmonë të ma kalojë dhe unë të mos ndiej shije për asgjë.

Për të më torturuar më puth dhe gudulis gjithë trupin. Unë jam cung, nuk ia kthej dot, nuk kam as duar ta përkëdhel, as këmbë që t'i zhdukem nga sytë.

NË QETËSI ME JURËN

Jura u martua. Shumë syresh u çuditën, por beqare ta harrojnë, nuk e kthejnë dot më. Si çdo nuseje të re i hipi një nur i cili nuk zgjat vetëm një muaj, po ta shohësh dhe tani e ruan një sjellje të hollë në fytyrë, nga ato që e kanë të vetën gratë e sapomartuara. Megjithëse çfarë po flas kot, mendoj se ajo dhe për të gjitha kohët që do të vijnë do ta ruaj atë shkëlqim që vjen nga zbulimet dhe gjërat e ndryshme që të sjell jeta.

Jura mbeti e ve ca ditë pas dasme, sesi i hyri vdekja në krevat dhe ia mori të shoqin aq shpejt nuk e di. Asnjë parandjenjë nuk pati, ndodhë ndonjëherë që leh qeni duke qarë dhe të zotët e shtëpisë tremben për vdekjen që u vjen rrotull, por jo. Qeni i tyre qeshte, sapo shihte çiftin e ri u afrohej te këmbët, tundte bishtin dhe i ndritnin sytë e kuq. Dhe shtrati bashkëshortor nuk dha asnjë erëzim të çuditshëm për çiftin, aty nënkresat dhe rrobat e linjtat të gjumit gëzonin sikur të ishin me flatra. As ndonjë zog nuk iu përplas te xhamat e dritares së madhe dhe të binte i ngordhur në parvaz, asgjë nga këto, asgjë.

Nuk di ç'b'u them jo, Jura ishte vajzë e rritur mirë, njohje për martesën e për burrin nuk kishte, por me pak intuitë dhe me përkujdesje nga edukimi i së emës ia doli ato pak ditë ta bënte të lumtur martesën e saj.

Një ditë të diele, pa gdhirë mirë, kur drita sapo kishte filluar ta plasarite errësirën Junës i kaloi një e dridhur kur kujtoi ç'kishte ndodhur, si pati fjetur vetëm në atë gropë të madhe, ashtu i dukej shtrati bashkëshortor tani që i shoqi kishte ikur përgjithmonë. Mendime të tmerrshme i kërcenin në krevat, herë shtriheshin njëri mbi tjetrin, herë qëndronin mbi kokën dhe gjoksin e Jurës.

Nuk duhet të vdesësh nga dëshpërimi, nuk duhet. E ulur në gjunjë vështroi për së fundmi atë shtrat të përmortshëm. Atë, fatin e saj vetjak dhe... Një kambanë e vogël i vezulloi në mendje. Sytë e saj ndritën. U bë gati dhe u nis për rrugë.

Ajo grua shet shpirtin për t'i hedhur një grusht të ftohtë fytyrës, për ta gjetur dhe një herë atë freski të harruar diku në fusha, larg njerëzve.

E pashë të ulur mbi një valixhe të drunjtë, me dy-tre fustane të linjtat brenda dhe me një bllok shënimesh me disa faqe të shkruara.

Treni mbërriti, zgjaten drejt saj disa duar njëherësh ajo me një të kërcyer të shpejtë hipën në vagonin e klasit të parë. Afrohet te dritarja dhe me sjellje tepër elegante bën avuj për ta fshirë atë pamje nga sytë.

Mendoi se shpëtoi nga duhja e nxehtë e rrugës dhe syve të panjohur, por jo, mirazhi i tij i ishte ngulur në tru dhe po e shoqëronte në udhëtim të gjatë. Një njollë e mavijosur në të zezë i kishte mbetur rrëzë qafës, askush nuk e shihte ç'emocione të fshehta ruante ai shall i lidhur me një fjonjo të lehtë në anën e majtë.

Kujtimi i tij me sytë e mbyllur njëherë e mirë, nuk guxoi ta mendonte me sytë e hapur, e përndiqte dhe i qëndronte mes dy lotëve që nuk e shkëpusnin pikën e të

rridhnin faqeve.

"Mos ik të lutem, -tha ajo, - si ike?! Nuk kam asnjë forcë të të kthej veç dashurisë sime, rri, rri me mua të lutem!"

Është koha për të ikur, të gjithë ikin, dhe ditët, të gjitha kthehen në një masë të madhe kujtimesh që nuk i nxë dot një kokë.

Jura sapo zbriti në një vend e kohë tjetër ndjeu një amzë të fort toke, iu dorëzua shijes së re dhe nuk e kuptoi si u gjet e vetme mes pemësh dhe zogjsh që e shihnin të çuditur. Një burrë që i ngjante shumë të ndjerit e priste krahëhapur duke luajtur me një qen që i përkëdhelej te këmbët. Të dy sapo e vunë re Jurën s'u hiqej e s'u hiqej e qeshura nga fytyra.

"Erdhe, -i tha, -unë e dija se ti do ta gjeje rrugën, nuk jam aq i mirë sa mund të mos shpresoja, të dorëzohesha e të ikja pa ty. Eja!"

Burri duke kapërdirë spërkën e lumturisë në stomak, shtriu duart drejt Jurës dhe hyri në qetësinë e përjetshme.

NE TË TJERËT

Nata mbuloi qytetin. Gruaja vazhdoi të ecte pa e prishur fare terezinë. Këmbët e çuan në pjesën më të paqme të atij vendi me një arkitekturë të përsosur. Gjeti me një orientim të qartë anën veriore të sheshit dhe u drejtua për atje me hapa të lehtë dhe të sigurt. Kishte pak ftohtë nga duart, por me një lëvizje të befte gëzimi e harroi fare të ftohtin.

Burri që i qe shfaqur ndryshe mes mijëra të tjerëve, sot i kishte shprehur ndjenjat e tij. Zemra po i ngrihej peshë, ndaj zgjodhi atë vend.

Ajri që i vinte nga pemët aty pranë ia mbushte mushkëritë tejprerë. Me një logjikë të thjeshtë sot kishte për çfarë të gëzonte. Historia që kishte ëndërruar prej kohësh sapo kishte nisur. Sa shumë raste kishte refuzuar, sa shumë mundësive të tjera nuk u dha asnjë shans për ta kapërcyer pragun e njohjes. Sa shumë djem e burra në atë qytet nuk do ta kenë kurrë mundësinë të jenë pjesë e jetës së saj. Sa shumë të tjerë që s'kanë pasur fatin ta njohin s'do të munden kurrë të japin një mendim se ç'grua e mirë u ka rrëshkitur nga sytë në këtë jetë. Sa lumturi!

Me këto mendime në kokë, në atë shesh të mbushur me njerëz të panjohur, për herë të parë u tremb për dashurinë e saj. Për herë të parë më pa në sy mua që kisha qenë gjithmonë i pranishëm.

Isha përfshirë shumë në jetën e tyre. Aq shumë sa nuk e di në do t'më mbetet ndonjëherë ndonjë copëz e mendjes jashtë.

Nuk e di ku e gjeja guximin të gjendesha mes bisedave, mes vështrimeve, në prekje dhe në kuptimet e fshehta që merrte çdo gjest gati i padukshëm.

Kam bindjen se ata e dinë që unë e di të gjithën. Pëshpërisin fjalë të ngrohta me njëri-tjetrin, më shumë e bëjnë për t'i dëgjuar unë. Me siguri duan të më kapin pulsën, këtë e bëjnë për të testuar dhe veten nëpërmjet rrahjeve të mia. Unë jam pak emocional, mbaj shqetësimet e të gjithëve ne, ndaj nuk është i rehatshëm këndi nga ku shoh. Tekembramja le të vuajmë, se mos na detyroi njeri të bëhemi pjesë e një lidhjeje të tillë. Ata janë të pakënaqur me praninë time, më fshehin mua dhe të dridhurat kur u afrohet dikush. Mua më rrëshqet frika në mes të këmbëve, mirë që e humbas mendjen me debatet që ndodhin mes tyre, sepse po të qe ndryshe nuk do të mundem dot kurrë të tregoj çfarë pashë.

Pashë një grua që pa asnjë lloj mëdyshjeje iu ankua fatit dhe më gjuajti drejt e në zemër. Pashë një burrë që për lumturinë e tij nuk ngurroi të më fshinte nga faqja e dheut. Pashë dhe një shpellë mu në mes të gjoksit tim që më përpiu dhe më nxori nga nata, çifti i ri dhe qyteti.

Dita e punës filloi me një qortim. Ma bëri Rudolfi, shefi i kuadrit të ndërmarrjes. U afrova si rastësisht dhe, pa përshëndetur, më tha me zë të ulët, intim:

- Kujtim, ti je familje e mirë... Të kam parë disa herë të shoqërohesh me atë piktorin tiranas. Kujdes, djalë i mbarë, kujdes! Mos harro përse e kanë sjellë këtu!

U largua duke më lënë të topitur.

Piktori tiranas ishte Sali Sekuj. Shkurt ne e thirrnim Eses. Nuk më kujtohet kush ia vuri këtë nofkë dhe përse. Ndoshta ngaqë ishte flokëverdhe si gjermanët. Ndoshta prej inicialeve të emrit të tij. Nga pamja mund ta merrje për gjerman, kurse nga karakteri jo. Ishte ca melankolik. Shpesh përhumbej. Se nga i fluturonte mendja. Befasohej para diskut të zjarrtë të diellit, që ulej në Perëndim, tej kapriatave të kantjerit tonë të ndërtimit. Po kështu ia ngulte vështrimin një fluturë tërë ngjyra, që rastësisht ndalte aty pranë. S'ke ç'i thua, teka artisti! Madje, ai ishte artist i shquar. Skenograf i Teatrit të Operas dhe Baletit në kryeqytet. Tek ne nuk kishte shumë kohë si punëtor. E kishin sjellë me dënim të stilit kinez, riedukim në gjirin e klasës punëtoresh. Faji i tij? "Ka shfaqje të huaja në artin e piktorit, na tha Rudolfi këtu e tre muaj më parë, kur na e solli në brigadë. - Është molepsur nga "izmat", që duan ta përdhosin artin tonë të realizmit socialist."

Ditët e para filluam ta shikonim vëngër Saliun. "...Është molepsur nga...". Këto fjalë përdorshin për ndonjë të sëmure nga zgjedhja ose kolera. Prandaj sa më larg tij. Edhe piktori rrinte si i veçuar, i mbledhur në fatin e vet të rëndë. Me punën fizike nuk e pati lehtë të mësohej. Pëllëmbët e njoma iu mbushën tërë flucka, që i plasën dhe i digjnin. Megjithatë, nuk mungoi as edhe një ditë të vetme. Duart i fashoi dhe kazmën nuk e lëshoi.

Nuk u desh shumë kohë që ta njihnim zemrën e artë të shokut tonë të ri. Na bëri për vete me fjalën e drojtur, me sjelljen e çiltër, me drejtësinë. Pasditet i kalonte më tepër shtrirë. Rimerrote energji për të nesërmen. Ishte interesant kur tregonte. E mbanim vesh gojëhapur. Kishte parë botë me sy. Studimet i pati kryer jashtë. Pastaj, për 13 vjet rresht, në kryeqytet. Ja, edhe tani, nuk ndryshonte fare nga punëtorët e tjerë: po ajo veshje me rroba doku, po ato 'opinga'. E pra, kështu më hyri në zemër dhe, pa kuptuar, u miqësova me të.

Javët e fundit Saliu sikur qe zgjuar nga gjumi. Qe gjallëruar. Qeshte e bënte shaka. Pëllëmbët i qenë mbuluar me kallo dhe nuk donte t'ia dinte për kazmën. Edhe lodhjen tani sikur nuk e ndjente më aq shumë. Pasdite nuk rrinte shtrirë si dikur, por vinte me ne. Herë-herë ndihmonte në agjitacionin figurativ të ndërmarrjes. Kudo dora e tij: pllakate të mëdha e parulla në pëlhurë, në llamarinë e në mure.

Rishtazi njeriu po merrte frymë i lirë, po jetonte si ne, mes dashurisë sonë. Por ja që Rudolfi... vinte e na kujtonte se tjetri ishte i huaj, i molepsur...

Dita më u duk e gjatë, puna - e lodhshme. Mërzitja më kishte pushtuar të tërin. More, po ç' dreq qenkan ato „izmat“ e Saliut, nga të cilat duhet të ruhesha?!

Rasti e solli që me to të njihesha më mirë qysh atë mbrëmje.

Pasdite vura re Saliun që po lahej e po rruhej me kujdes. Kur veshi edhe rrobat „e mira“, e kuptova se do të dilte në qytet. Kjo ishte gjë e rrallë për të, ndaj u bëra kureshtar.

- Ku kështu, Eses?

- Në teatër. Bëhen provat e përgjithshme të festivalit të këngës për pionierë.

- Po ti ç'hyn aty?

- Kam punuar skenografinë... Po të duash...- Ai bëri shenjë kuptimplote.

- I lirë jam. Fundja, po vij.

Në çast më kujtua porosia e shefit të kuadrit, por tanimë ishte vonë. Nuk mund të tërhiqesha.



FLAMUJT E BARDHË

Tregim kushtuar piktorit Ali Oseku
nga Astrit Bishqemi

U veshja dhe e shoqërova.

Thashë se salla e teatrit do të ishte mbushur plot e përplot me spaktatorë, kurse ajo ishte pothuajse bosh. Vetëm nja dy-tri radhë të zëna nga këshilli artistik. Përfaqësues të komitetit të partisë, të komitetit ekzekutiv, të frontit demokratik, të organizatës së gruas etj. Ata do të vlerësonin dhe do të miratonin veprimtarinë kulturore.

Shfaqja më pëlqeu. Zërat e ngrohtë e të çiltër të fëmijëve më futën në shpirt gëzim e gjallëri, më përtërinë, ma hoqën ankthin që më pati kaplluar tërë ditën. Duartrokita fort. Por Saliu që kisha në anë, më goditi me majën e këpucës që të heshtja.

Pasi u larguan fëmijët, në sallë filloi diskutimi.

Regjisori vuri në dukje se spektakli i asaj nate nuk ishte i plotë. I mungonin disa komponentë. Për shembull, dritat nuk funksionuan fare, meqë nuk ishin në gatishmëri. Uniformat e fëmijëve...

Mua nuk më hynin në punë këta "komponentë", ndaj nuk ua vura veshin. Mezi po prisja të mbaronte mbledhja që "ta lagnim" së bashku me Saliun suksesin e tij.

Diskutuan nja dy-tre vetë për përbajtjen e këngëve, për ritmin muzikor të tyre e ku ta di unë. Pashë të ngrihej shoku

Baki, përfaqësuesi i organizatës së Frontit.

- Shokë, mendoj se shfaqja vuan nga "izmat"!


Këto fjalë qenë si gjëmimi në një ditë të kthjellët vere. Të gjithë lëvizën tërë sy e veshë. U bëra i vëmendshëm edhe unë. Pa t'i shikojta ç'ishin ato "izmat", që i kishte kapur shoku Baki. Megjithëse i kishte kaluar koha për të dalë në pension, ai vazhonte ende të jepte ndihmesën e vet të çmuar për shoqërinë.

- Te muzika s'para marr vesh shumë e nuk di t'i zbuloj shfaqjet e huaja, veç te skenografia ndryshon puna. Aty ato janë të dukshme, të prekshme, të kapshme, bëjnë "muu"!

Kur dëgjoi këtë bulurimë, Saliu lëvizi përkrah meje, sikur ta shponte briri i demit.

- Ka "izma" në skenografi?!- hapi sytë instruktori i kulturës pranë komitetit të partisë.

- "Izma" posi. Nuk mund të them të ç'loji janë: impresionizëm, kubizëm, surrelizëm a djall me brirë. Por një gjë e kam të qartë: me këtë skenografi nuk edukojmë te brezi i ri veti të moralit komunist, si guximin e qëndresën. Përkundrazi, edukojmë kapitullimin. Ngrejme duart lart para armikut.



- Xha Baki, shprehu më qartë ju lutem!- u hodh përgjegjësja e organizatës së gruas.- Skena më duket e gjetur, e thjeshtë, e bukur, domethënëse.

Edhe unë i atij mendimi isha. Ia ngula edhe një herë sytë me vëmendje skenografisë. Ja, disa lulëkuqe të lidhura me shallin e pionierit. Më tej flamurë të shpalosur, që valëviteshin krenarë në ajër. Ku ishin këtu shfaqjet e huaja, apo "izmat", siç i quanin?

- Ëhë! Pa shiko njëherë ç'ngjyrë kanë lulet! Të bardha. Pa shikojë shallin e pionierit: ç'ngjyrë ka! Të bardhë. Pa shiko flamujt, të lutem shumë! Ç'ngjyrë kanë? Të bardhë.

Të gjithë hapën sytë të habitur. Diskutuesi kishte të drejtë. Si nuk e kisha vënë re?! Ja pra, ku na u fshehka lepuri!

- E de,- vazhdoi me zjarr shoku Baki,- e bardhë, e bardhë, e bardhë! Edhe lulëkuqet, edhe shalli i pionierit, edhe flamuri. Po ngjyra e bardhë s'është komuniste, o t'u mbylltë! Flamuri i bardhë simbolizon kapitullimin para armikut!

Mbi sallë rëndoi heshtja.

Regjisori u ngrit menjëherë të sqaronte se, siç e kishte vënë në dukje qysh në fillim, fajin e kishin dritat. Po binte në dorë xha Bakiu?

- Ç'punë kanë dritat këtu! Unë shoh fare mirë, nuk më kanë lënë llambatinat! Faji është i shokëve që ia ngarkuan skenografinë e shfaqjes një piktori të tillë si Sali Sekuj. Ai ka studiuar jashtë, në një vend revizionist, ku shfaqjet e huaja në letërsi e në arte të gllabërojnë të tërin pa e kuptuar. Në Tiranë ky piktor i manifestoi këto "izma", ndaj i vunë drunë. E sollën këtu për riedukim. Kurse ai ç'po bën? Po infekton skenat tona, spektatorin tonë, fëmijët tanë. Po ëhë, këtë nuk duhet ta lejojmë!

- Me leje!- ndjeva shokun tim të kërkonte fjalën. Zëri i dridhej. Jo vetëm zëri, por edhe dora që kishte ngritur. Në fytyrë nuk i kishte ngelur pikë gjaku.

- Pa ta dëgjojmë piktorin njëherë, - tha sekretari për çështjet ideologjike i komitetit të partisë. Dukej i revoltuar, se ia kishin futur ujin nën rrogos.

Saliu u ngrit i dërrmuar.

- E dini si është puna, more shokë? U nisa nga estetika, nga e bukura. I kam punuar në kompensatë të spërkatur me allçi maketet e flamujve, të luleve e të shallit të pionierit. Ndaj janë të bardha. Nuk i leva me bojë të kuqe që të dukeshin më fine. Ngjyrën do t'ua japin projektorët e ndezur me filtra të kuq. Atëherë shalli e flamujt do të duken si prej mëndafshi. Madje jo vetëm ata, po edhe gjithë skena do të marrë një purpuri agimi.

Ëhë, kështu thuj, mendova me vete zemërlehtësuar. Gjaku më u shkri. Saliu kishte të drejtë.

Vura re se mbi të gjithë ende rëndonte heshtja e parë.

Akullin e theu sekretari i komitetit të partisë, i cili dukej qartë që ishte personi më i rëndësishëm aty.

- Jo, jo, nuk mund të pranojmë ekuivoke. Jemi kundër formalizmit estetik. Flamujt e shalli janë simbole të nderuara që nuk duhet të rrinë asnjë minutë pa ngjyrën e kuqe karakteristike. Qysh sonte të lyhen me bojë të kuqe!

Pas këtij urdhëri të prerë, diskutimi nuk vazhdoi gjatë. U dhanë edhe dy-tri udhëzime të tjera dhe mbledhja u mbyll.

Tek dilnim jashtë, shoku im nxitoi të largohej.

- Eses... Sali! - i thirra.

Qëndroi një grimë sa iu afrova dhe më pëshpëriti pa kthyer kokën:

- Jo, jo, nuk është mirë të të shohin me mua. Nuk dua ta pësosh edhe ti!

Pas dy ditësh e arrestuan. E kishte mbushur kupën e „izmave“. Gjyqi e dënoi me 16 vjet heqje lirie...

Në vitin 1938, zoti Shahin Zharri, ish nxënës i shkollës Normale të Elbasanit, botoi në revistën “Shkolla Kombëtare” (Nr.16-17, faqe 22) këngën historike me titull: “Kanga e Gjorg Golemit”, e cila është konsideruar si një ndër krijimet më të bukura të folklorit shqiptar. Kënga i kushtohet Gjergj Aranit Golemit, një nga figurat historike më të shquara të shekullit të 15-të.

Që nga botimi i saj, kënga e Gj. Golemit, si dhe figura e Gjergj Aranitit, kanë qenë objekt studimi nga autorë të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj, por edhe burim frymëzimi për krijimin e shumë veprave letrare dhe të arteve figurative.

1. Gjorg Golemi në veprat letrare.

Krijimi i parë letrar që njohim, i cili është frymëzuar me motivet e këngës së Gjorg Golemit, është novela “Ditët e sprasme të Gjorg Golemit: Lufta e Bekuar”, e shkrimtari Dhimitër Shuteriqi (Revista “Nëntori”, Nr. 3, Tiranë 1957, faqe 26–70). Si ngjarjet dhe personazhet u mbështetën në subjektin e këngës së Gjorg Golemit. Novela pati sukses dhe u prit mjaft mirë nga lexuesit. Ajo u konsiderua nga kritika e kohës si një nga “krijimet më të bukura... (që) edhe tani lexohet me endje...” (D. Shaplo: “Në botën krijuese të një tregimtari të shquar”, “Nderim Dh. S. Shuteriqit”, Tiranë 2004, faqe 96).

Shkrimtari Sterjo Spasse, në romanin e tij epike “Pishtarët” (1975), një nga personazhet e shumtë të romanit të tij ishte Halit Bërzeshita (Bej Babai), i cili, shkruan autori, meditoi në ulur mbi minderin e shtëpisë së tij, për legjendën e Gjorg Golemit dhe heroizmin e grave sopotare.

Në vitin 1967, poeti i mirënjohur elbasanas Musa Vyshka, botoi një vjershë të titulluar “Gjorg Golemi”. Vjersha u botua në një antologji letrare, me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut, me titull: “Antalogji për Skënderbeun” (1967), në të cilën ishte përfshirë krijimtaria më e mirë letrare e autorëve shqiptarë në vite.

Në vitin 1968 shkrimtari Kolë Jakova shkroi libretin “I fundmi i Golemëve”, me motive të novelës së Dh. Shuteriqit “Ditët e sprepsme të Gj. Golemit”. Kompozitori Nikolla Zoraqi i vuri muzikën libretit të Jakovës, e cila u shkruar me rastin 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Për fat

Kënga e Gjorg Golemit dhe figura Gjergj Aranitit në letërsi dhe arte

Nga Avni Alcani

të keq opera nuk u vendos kurrë në skenë, për shkak të mentaliteteve të kohës, të pretendimit absurd, pasi personazhi kryesor i veprës ishte një prift (!).

Në novelën e shkrimtarit Ismail Kadare, “Prilli i thyer” (1978), personazhi kryesor e ka emrin Gjorg. Mendoj se emri Gjorg, i romanit të Kadaresë, është huazuar nga emri i personazhit kryesor të poemës së mirënjohur, *Kanga e Gjorg Golemit*. Gjuhësisht, forma e emrit *Gjorg-Gjorgu*, është varianti i emrit biblik *Gjergj*. Variantet: *Gjorg, Gjorga, Gjorgu*, qarkullojnë në trevat ku ruhen këngët dhe legjendat për Gjorg Golemin, si në Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Pogradec. Ende dhe sot e ndeshim në disa toponime, si: *Mali i Gjorg Golemit* (Polis-Librazhd), një përrua në Myzeqenë e Vogël (Elbasan), quhet *Gjorgë*, kurse në fshatin Gurakuq (Çermenikë-Librazhd) një fis mban si mbiemër (llagap) emrin *Gjorga* etj.

Figurën e Princit të Sopotit pati përfshirë në veprën e tij dhe poeti Koçi Petriti. Petriti ka qenë mësues në trevat e Librazhdit prej shumë vitesh (22 vjet), e cila i kishte dhënë mundësinë që ai të ishte në kontakt me krijimtarinë folklorike librazhdase kushtuar Gj. Golemit. I mbështetur te këto legjenda ai shkroi baladën “*Golomarja*” (1974). Disa vite më vonë ai e ripunoi baladën dhe i shtoi vjershës vargje të tjera, duke e transformuar në një poemë. Në vitin 1978, në kuadër të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, poema e K. Petritit “*Golomarja*” mori Çmimin e Parë Kombëtar.

Mbështetur në subjektin e këngës së Gjorg Golemit, shkrimtari Dilaver Baxhaku shkroi një dramën me titull: “*Historia me rrënjët në legjendë - Historia e kalasë së*

Sopotit dhe e Gjergj Golemit”. Në vitin 1982 radiodramatizimi u regjistruar në Radio-Tirana nga një grup aktorësh të Teatrit Popullor të Tiranës dhe është transmetuar e ritransmetua disa herë në Radio-Tirana, gjatë emisionit: “*Heroizmi i popullit tonë në shekuj*” (Fondi i fonotekës së Radio-Tiranës, Nr. i regjistrimit 559).


Shkrimtari i mirënjohur për fëmijë Odhise K. Grillo, shkroi një libër poetik me ilustrime, të titulluar : “*Shpata e Gjorg Golemit*” (2001). Subjektin e librit autori e mori nga legjenda dhe nga kënga e Gjorg Golemit, duke e përshtatur për fëmijë. Libri është ilustruar nga piktori Lulzim Mema.

Krijimi më i fundit letrar, që ka si personazh kryesor një personazh me emrin Arianit Komneni, është romani “*Të jetosh në ishull*” (2008), i autorit Ben Blushi. Personazhi i Blushit ka jetuar në shek. XVII dhe është stërnip i nipit të Gjergj Aranit Komnenit, princit të famshëm shqiptar të shek. XV, emrin e të cilit e ka trashëguar ai dhe djali i tij, Gjergji. Në hyrje të romanit, Arianit Komneni i rrëfen Ali Tepelenës, një tjetër personazhi historik, rrënjët e fisit të tij të Komnenëve dhe historinë e bëmat e stërgjyshit të tij të madh.

2. Kënga e Gjorg Golemit dhe figura e Gjergj Aranitit në artet figurative.

Figurës së Gjergj Aranitit i janë kushtuar mjaft vepra në artet figurative, si në pikturë, skulpturë, grafikë, qeramikë etj.


Me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së Gj. K. Skënderbeut piktori Guri Madhi realizoi një kompozim në pikturë të titulluar



“*Sopotaret*”. Tabloja evidenton heroizmin dhe vetëmohimin e grave sopotare, të cilat rrëmbyen armët në mbrojtje të Gjorg Golemit dhe të kështjellës së Sopotit. Piktura është mjaft e realizuar artistikisht dhe konsiderohet si një nga veprat më të bukura të piktorit Guri Madhi. Piktori Pandi Mele ka realizuar një portret në grafikë kushtuar figurës së Gjergj Aranitit. Portreti i Pandi Meles ilustron çdo shkrim kushtuar Gj. Aranitit. Gjithashtu, po në këtë kuadër, Piktori librazhdas Sami Roçi, i frymëzuar në këngën e legjendën e Gjorg Golemit, mbështetur dhe nga poema “*Golomarja*” e Koçi Petritit, në vitin 1978 realizoi një pikturë shumë të bukur kushtuar Marës së Golemëve.

Portreti i parë që njohim në skulpturë, kushtuar Gjergj Aranitit, është një vepër e Dhimitër Çanit, e realizuar në kuadrin e 500 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut. Në vitin 1981 skulptori Agim Rada realizoi një portret kushtuar Gjergj Aranit. Portreti ndodhet në muzeun *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu* të qytetit të Krujës. Portreti më i fundit në skulpturë, kushtuar figurës së Gjergj Aranitit, është realizuar në vitin 1983 nga klasiku i skulpturës shqiptare, Odhise Paskali. Portreti i Paskalit kohët e fundit (2005) është derdhur në bronz dhe është i vendosur në sheshin kryesor të qytetit të Librazhdit.

Piktori Sali Shijaku në vitin 1985 ka realizuar mbi një pjatë dekorative në qeramikë portretin e Gjorg Golemit, të cilin e pat titulluar: “*Në Mal-Plak, mbi një breg, Gjorg Golemi thotë jam Mbret!*”. Titulli është marrë nga vargjet e këngës së Gjorg Golemit. Pjata dekorative ishte koleksion



Guri Madhi: Sopotaret



Sami Roçi: Golomarja

i një ekspozite me punime qeramike, që piktori Shijaku kishte hapur në vitin 1985 në Galerinë Kombëtare të Arteve Figurative të Tiranës.

Në vitin 2001 piktori Lulzim Mema ilustroi librin e sipërpërmendur "Shpata e Gjorg Golemit" të shkrimtarit Odhise Grillo. Piktori ka realizuar rreth 16 ilustrime me ngjyra (kompozime), duke përfshirë edhe dy kopertinat. Piktori, për t'i vendosur ngjarjet në kohë, në shek. e 15-të, ka përdorur mjete dhe elemente artistike shumë shprehëse, si veshjet, armët e luftëtarëve shqiptarë, kështjellën, peisazhin etj., të cilat nxisin dhe zhvillojnë fantazinë e fëmijëve. Ilustrimet janë mjaft të arrira nga ana artistike.

Kënga e Gjorg Golemit ka qenë dhe mbetet objekt edhe i krijimtarisë publicistike. Në shtypin shqiptar janë shkruar me dhjetra artikuj, që i kushtohen ngjarjes së Sopotit dhe figurës së Gjorg Golemit.



A. Rada: Gj. Araniti



O. Paskali: Gjorg Golemi



A. Rada: Gj. Araniti

Dhjetë fabula

Nga Vangjush Saro



NJERIU dhe HIJA

Hija në muzg është e gjatë; edhe njeriu, që s'e ha thatë, i flet asaj kinse me ton: "Se mos merr kot moj, më dëgjon? Jam unë pa je ti. Tutkune!" "Vërtet, ia pret ajo, por ti s'je unë..." Bën tjetri të gjejë fjalën për më tej; ndërkohë, dita po ngriset me gjithsej.

RENDI

Moti, për festimet, dukej mbarë. Në tribunë, u dha Çakalli i pari. Fjalët, q'i kish shkruar mbi një gjethe, zuri t'i kumtonte plot lezete... Por papritur, bëri ballë Luani. Gjindja mbajti frymën, le ç'po ngjan. Bam (!) ai një shkelm zotit Çakall dhe e postoi te shkurret përballë... "Të më falni," tha pastaj, "ishte pa klas; por... o miqtë e mi, nga kjo marr shkas ta them ndershëm se do ish më mirë, që sekush vendin e tij ta dijë." Paskëtaj, fjalën e mori vetë; gjindja - sytë përjetë...

KRIMBI I DELIRIT

E bëri internetin copë-copë; pastaj u ul që të pushonte. Përzgjidhte selfie në lëndinë, duke menduar vetëm për lavdinë. Ishin Ai dhe Dielli, tok; (shto Krimbin e Delirit, mik për kokë.) Ndërkohë një Gjarpër vinte ngadalë dhe dukej se në shenjë e kishte marrë. I tha Krimb' i Delirit: "Stop! Mund të ikësh, e çoj unë në gropë..."

FAJKOI JEP LEKSIONE GJUETIE

Deti është i qetë, vaj. Një Fajkua zhytet dhe pastaj ngrihet që andej me peshk në sqep, për ta çuar në fole në e vet... Dhe kur zbret për gjuetinë e radhës, Sorra, e habitur, i vjen anës: "More byrazer, si është kjo punë? Më mëso të gjuaj edhe unë..." "Po, moj, e pse jo, ia kthen Fajkoi. Po kështu... me not, je mirë besoj?" "Au, për Zotin, s'kam mësuar fare!" "Po ç'kërkon atëhere, moj qyqare?" Tha Fajkoi dhe u zhyt sërish. Mbeti Sorra po atje ku ish...

NGUT

U mat njeriu disa herë të kapërcente një llogaçe; së fundi hopa(!) tha i mjeri edhe u hodh sakaq. Por nuk ia doli gjithsesi, në baltë u përlye, prandaj edhe u mat të shante kanalën e urryer q'ë lagu thuj gjer në thonj. Por balta mëndjen ia ndërroi tekta i foli: -O kokëtul, S'ta kemi fajin as unë, as gropa: pa marrë ende mirë vrull, si mund të thuash: "Hopa!"

KUSH E 'RRËZOI' GLOBIN?

Globi ra nga rafti drejt në shesh, se... kush e rrëzoi, s'u muar vesh; (se shtëpia ka qen edhe mace, që veç në të rrallë bëjnë paqe). Kushedi... do shtypet ca përqark apo nuk do bëhet më për raft (!)

KAMELEONI

Te korija që digjet në zheg, Trungu i rrëzuar përmbi pellg, po i flet Kameleonit rëndë: "Ç'më ngallosesh vend edhe pa vend, dhe më loz me ngjyra, me nuanca? E mohon? Të kapa në flagrancë." "Rri, o mik dhe kot mos ia vesh!" thotë Kameleoni sy e veshë. "Unë ndërrohem puna si të jetë, se përndryshe nuk ngriset kjo jetë..."

POETI dhe SHIU

Një Poet po "qante" bashkë me Shiun; (shiu këtu e shiu atje...) Ish në qiellin e shtatë derëzë, fjalët dhe lotët shkoni rrëke.



I tha Shiu, pak si me shaka: "Nuk u lodhe njëherë, o zotëri; fillim-mbarim me mua tallava? Folë për veten, thuj kush je ti..."

TRUMCAKU

I ikën një Trumcaku mendja edhe kujton se është... qendra; (qendra e Botës domethënë). Pra, s'ka më Diell edhe Hënë, është veç ai dhe... këng' e tij. Të mbajmë vesh çfarë do të ndrijë: E nis 'koncertin' si Gushëkuq, por sprova e parë i del huq. E ka pak lart, e ul më poshtë, që si Mëllënjë t'ia thotë. Por pak më tutje, ndërton prapë ky yll; rreh të këndojë si një Bilbil. Më kot. Bën vetëm: "Ciu, ciu!" Kjo s'i pëlqen as vetë të ziut. Dhe s'ka më kohë, nuk vazhdon dot. U ngrys. Ra perdja dhe për sot...

PA SHPJEGIM

Era pemët po krihte me nge... Diku, një kokërr molle ra përdhe. Zoti Iriq, që andej kalonte, tha me vete: "Ia hodha sontë." Kurse Krimbi, tekta dilte jashtë: "Byrazer, po mua do më hash? Jo për gjë, por mund të më kurseje, sepse këtë vakt e ke prej meje." Tjetri, me sa dukej, ngutej pak; Mollë edhe Krimb shkuan në bark...



*Ndër gjinitë e preferuara për këtë autor, me disa botime edhe në gjuhë të huaja. (Së fundi, u botua në ShBA libri i tij me fabula "WHERE TO?")

NJË PERSONAZH LINDOR QË ËNDËRRONTE PERËNDIMIN

Ali Pasha është ndoshta personazhi historik shqiptar më i lëvruar në gjininë e letrave, artet figurative, skenat e muzikës dhe teatrit botëror. Sigurisht e tërë kjo vëmendje e krijuesve të letërsisë, muzikës dhe artit pamor evropian dhe më gjerë nuk ishte rastësi. Ajo nuk u imponua as me forcën e diktatit, autoritetin e pushtetit, e aq më pak me censurën.

Po çfarë i shty kaq shumë artistë dhe krijuesit evropianë, madje ata më në zë, që kishin kultura evropiane e kohës, ata britanikë, francezë, italianë, gjermanë, rusë, suedezë, danezë, etj., të krijonin, botonin, vinin në skenë apo krijonin tablo mbresëlënëse për këtë tepelenas, të lindur dhe rritur diku, në një krahinë pothuaj të panjohur të Perandorisë Osmane?

Qysh në fillim të ngjitjes së tij në pushtet, monarku tepelenas tërhoqi vëmendjen e evropianëve. Shkak për këtë u bënë reformat e thella dhe përpjekjet e tij për fuqizimin e pashallëkut përmes kontrollit të rreptë dhe zgjerimit të territoreve, konsolidimin e sistemit të taksave mbi tërë popullsinë e zotërimeve të tij, rikthimi i rendit dhe sigurisë përmes operacioneve ushtarake, ndëshkimi dhe nënshtrimi i hajdutëve dhe brigandëve, vendosja e qetësisë dhe ligjit në të gjitha hapësirat urbane dhe rrugëkalimet ku qarkullonin mallrat dhe njerëzit, rritja dhe fuqizimi i potencialit ushtarak, aplikimi i një diplomacie aktive dhe largpamëse, etj.

Të gjitha këto e bënë këtë hegjemon faktor, subjekt dhe nismëtar të ndryshimeve radikale që do të pësonin në të ardhmen e afërt statuskuotë tradicionale politike dhe morale që dominonin popullsitë shqiptare dhe atë greke prej shekujsh. Nën hijen dhe mesazhet e tij domethënëse do të lindnin dhe ushqeheshin lëvizjet separatiste, ato sovraniste dhe nacionale tek të gjithë popujt e Ballkanit.

Nën këto reforma kurajoze, hegjemoni tepelenas do të kthehej shumë shpejt një prej aktorëve evidentë, i pranishëm dhe jo rrallë interlokutor në politikën, lëvizjet, aleancat dhe rrjedhat politike përtej kufijve të perandorisë Osmane.

Zhvillimet ushtarake në Europë dhe fushatat bonaparteske, synimet e tyre për ekspansionin drejt territoreve të Ballkanit jugor, kthyen dhe përqendruan edhe më tej vëmendjen ndaj këtij Veziri. Zbritja në Ishujt Jonianë dhe kërcënimi i divizioneve franceze më 1797, 1803 dhe 1809 u bënë përherë eminente për territoret e pashallëkut të Janinës dhe krijuan skena jo rrallë të përgjakshme dhe herë tensionesh të ngrira mes Pashait të Janinës dhe fuqisë ushtarake më të madhe të kohës, Francës.

Reagimi i britanikëve dhe nxitimi i tyre për të ardhur menjëherë në kontakte, aleanca dhe marrëveshje sekrete me Ali Pashën, shtuan edhe më tej vëmendjen ndaj Vezirit të Janinës dhe shqiptarëve të tij.

Konfliktet shekullore mes Rusisë dhe

ALI PASHA NË LETËRSINË, ARTIN DHE SKENAT E TEATRIT BOTËROR

Prof. Dr. Irakli Koçollari



“ALI PASHA I JANINES”, PJESE NE
GJASHTE AKTE, INTERPRETUAR NE
“TEATRO ALLA SCALA” TE MILANOS.

Perandorisë Osmane nxitën gjithashtu synimet, planet dhe ndërhyrjet e Rusisë për të shtuar kontaktet me Ali Pashën. Admirali Potjemkin dhe Ushakov morën kontakte të drejtpërdrejta me tepelenasin dhe shtruan idetë e bashkëpunimit dhe operacioneve të përbashkëta kundër Perandorisë Osmane.

Dinamikat dhe transformimet e thella politike dhe ekonomike, sociale dhe kulturore, diplomatike dhe morale, investimet në arsim dhe në dije, këmbimet e zgjeruara tregtare, informimi permanent me zhvillimet politike në Europë, përhapja dhe interesimi për doktrinat e reja filozofike dhe kulturore, idetë e iluminizmit francez dhe sistemet e reja politike që krijoheshin dhe gjallonin aso kohe nëpër Europë, u vunë në fokusin e vëmendjes të tepelenasit.

Sigurisht, ky hierark kish lindur dhe ish rritur në një botë të mbushur me ngarkesa të mëdha morale dhe kulturore që vinin nga një e kaluar e largët konservatore mesjetare, mbushur me besëtytni dhe zakone, doke dhe norma të trashëguara apo imponuara nga kohët dhe pushtuesit lindorë, me rrënjë të thella që vinin ndesh përpjekjeve për ndryshim. Terreni ku çapitej ai ishte i mbushur me pasiguri, me krerë fisesh dhe brigandë në konflikte permanente, me një administratë të huaj që sillte përherë tensione, dhunë dhe autoritarizëm, në një skaj gjeografik që qëndronte mes lindjes dhe perëndimit, nën një sundim shekullor barbar dhe të përgjakshëm Osman.

Ali Pasha do të duhej të luftonte dhe mbijetonte mes asaj vorbulle komplekse troshitëse, që kërkonte kurajë për të kundërshtuar traditën rrënjëdalë mesjetare duke përdorur të gjitha ato mjete dhe mënyra që ofronte ajo kohë, mesjeta, shtrëngesat ligjore, kërcënimet, ndëshkimet, sanksione penale dhe financiare që ofronte Sherihati, apo traditat ligjore kristiane dhe ato kanonore.

Ai do të mbetej një nismëtar për ndryshime dhe transformime radikale në lëmi dhe fushat e ekonomisë, financave, mbrojtjes, kulturës, religjionit, urbanistikës, etj.,

Me atë kurajë unike, ai kërcënoi dhe ndëshkoi, ndërtoi aleanca me krerë fisesh të njohur, familje fisnikësh dhe deri brigandësh të njohur. Hartoi “Marrëveshje Pajeje dhe Mirëkuptimi” me kundërshtarë tradicionalë apo familje të fuqishme dhe të njohura nëpër krahinat e Arbërisë jugore dhe ato të Greqisë kontinentale. Përdori kërcënimin dhe dhunën ndaj të pabindurve, jo rrallë edhe rryshfetin, si një mjet efikas i pranuar institucionalit në strukturat e Perandorisë Osmane.

Por, ishte ky njeri që nuk nguroi të vështrëjë me uri kah portat e civilizimit evropian, që dëgjonte me kureshtje britmat e revolucionit francez, që debatonte me konsuj, diplomate dhe udhëtarë të huaj që



vizitonin pashallëkun, doktrinat e reja të hartuara dhe të udhëhequra nga Robespierë dhe Maratë, nga Volterë dhe Zhan Zhak Ruso, Deni Didro, Xhon Lokë, etj.


PËRBALLË SYNIMEVE DHE KËRCËNIMEVE TË FUQIVE MË TË MËDHA TË KOHËS

Bashkë me to Ali Pasha do të duhej të përballlej me synimet e fuqive më të mëdha të kohës, Rusisë, Francës dhe Britanisë, nën hijen kërcënuese të Portës së Lartë, të gjente rrugëzgjidhje, mekanizma, aleatë dhe ekuilibra delikatë. Brenda tij u mbart e fshehur me kujdes një ide e frikshme, por kurajoze, potencialisht me pasoja të rrezikshme. Idetë e para të nacionalizmit dhe shpëputjes prej Perandorisë. Ndoshta ajo ide dhe kurajë rebele, do të bëhej për këtë monark, i pari ndër popujt e Ballkanit, akti final i ndëshkimit të përgjakshëm të tij.

Në atë botë me dinamikë të papërsëritshme, figura e Ali Pashë Tepelenës, në profilin kompleks, shumëdimensional të saj, u shoqërua nga akte dhe bëma unike, mbushur me ngjarje të papërsëritshme, me një diplomaci mbushur me kulisa, tensione, kurthe dhe pabesi të frikshme, me një politikë mbresëlënëse përballë autoritetit apo kërcënimeve të rrezikshme të fuqive më të mëdha të kohës, me operacione ushtarake të përgjakshme brenda apo në toka të largëta të pashallëkut, me intriga dhe kërcënime perandorake osmane për të nënshtruar shpirtin rebel dhe separatist të Pashait tepelenas, me ngjarje të çuditshme humane dhe familjare që troshitën shpirtin njerëzor të atyre kohëve.

Pikërisht kjo figurë, Aliu tepelenas, shqiptarët e tij dhe murrllani mbresëlënës i shumë ngjarjeve që shoqëroi bëmat dhe dimensionet gjeografike të pashallëkut ku ai sundoi, befasoi dhe tërhoqi vëmendjen jo vetëm të politikanëve dhe ushtarakëve evropianë, por edhe të krijuesve të shquar të letrave, penelit, partiturës dhe kulturës evropiane në tërësi.

Shkrimtarë, gazetarë, publicistë, dramaturgë, më të njohurit e kohës, sikundër britaniku Lord Gordon Bajron, francezët



“POT-PURRI”, ME TITULLIN “ALI PASHA...” SHFAQUR NE PANORAMA DRAMATIQUE NE PARIS, ME 1822



MELODRAME NE TRE AKTE KUSHTUAR “ALI PASHES” SHFAQUR NE PANORAMA DRAMATIQUE, NE PARIS NE VITIN 1822, KOMPOZITOR CICERI, THIERRÉ-LUC-CHARLES



OPERA NE TRE AKTE “ALI PASHA” SHFAQUR NE TEATRIN E PARISIT

Viktor Hygo, Aleksandër Dyma, Ibrahim Manzour Efendi (**Samson Cerfbeer de Medelsheim**), Jacob Salomon Bartholdy, etj.; Diplomatë dhe ushtarakë të njohur që shërbyen me mision të ndryshme në pashallëk sikundër, koloneli dhe konsulli britanik, William Martin Leak; Thomas Smart Hughes, David Richard Morier, francezi Hughes (Hugo) Pouqueville; konsulli dhe historiani francez, Francois Charls Hugues Laurent Pouqueville; Sir Thomas Gordon; Komisari Perandorak francez, Julien Bessieres; diplomati William Richard Hamilton, historiani Theodore Lyman; gazetari amerikan Edward Everet; ushtaraku britanik Richard Davenport; studiuesi dhe historiani John Cam Hobhouse; mjeku dhe historiani Sir Henry Holland, gazetari i njohur danez, Peter Oluf Brondsted, etj., janë vetëm një pjesë fare e vogël e numrit të madh të atyre që lanë vepra dhe krijime letrare, romane, novela, poema, artikuj gazetareskë, hartuan një dokumentacion arkivor të pafund, informacione, relacione, studime, raporte sekrete, për Ali Pashën dhe shqiptarët në tërësi.

Krahas tyre, Ali Pasha, oborri i tij, shqiptarët, peisazhet mahnitëse të vendeve ku jetonte ky popull, zakonet, veshja, vallet, këngët, luftimet dhe qëndresa e tyre, etj. u bënë objekt frymëzimi për shumë krijime në gjininë e pikturës. Kompozime në vaj, portrete, peisazhe, skena lufte dhe dashurie të botës shqiptare, i dhuruan botës europiane imazhe nga ky thesar i pafund për këtë popull dhe Arbërinë.

Piktori i njohur francez, Eugene Delacroix; piktori dhe shkrimtari Luis Dupre; piktori Leon Zherom; arkitekti, arkeologu, shkrimtari dhe piktori i njohur britanik Charles Robert Cockerell; piktori britanik Joseph Cartwright; piktorët William Purser, Theodore Lyman, Davide Richard Norier, Luigi Ciampolini, Alphonse de Beuchamp, Eilliam Eton, Charles Luis Muller, Paul Emil Jacobs, Camille Corrot, Beresford, G. de la Poer, etj., sollën një inventar të pafund veprash të botës shqiptare që edhe sot mbeten me vlera të papërsëritshme për artet figurative në tërësi dhe historinë e popullit tonë në veçanti.

ALI PASHA NË SKENAT E TEATRIT DHE OPERËS EUROPIANE

Por, jo vetëm në këta lëmij!

Ali Pasha mbetet, hë për hë, shqiptari për të cilin janë dedikuar më shumë krijime muzikore në raport me gjithë pararendësit, bashkëkohësit apo personalitetet e njohura shqiptare të kohëve moderne.

Ai u shfaqet përmes këtyre krijimeve, me profilin e tij kompleks mjaft atraktiv, befasues dhe pse jo miklues, për kompozitorët dhe gjer për krijuesit anonimë të këngëve popullore.

Kompozitorë, këngëtarë të njohur të muzikës operistike, skenaristë dhe regjizorë, të skenave me të dëgjuara europiane, krijuan dhe interpretuan vepra në zhanre të ndryshme të muzikës për tepelenasin befasues. Opera, melodrama, kantata, elegji dhe këngë të shumta pasuruan gjatë shekullit të XIX repertorin e krijimtarisë së shumë krijuesve të njohur duke pasur në qendër të veprave të tyre heroin e Janinës, Ali Pashë Tepelenën. Këto krijime nuk u prezantuan në teatro apo paradhoma provinciale, të panjohura, por në skenat më të mëdha dhe elitare të teatrit evropian dhe atij botëror. Vetëm opera kushtuar këtij hegjemoni janë plot katërbëdhjetë! Ato u interpretuan në:

- “La Scala” e Milanos
- “Royal Theatre” – Convent Garden i Londrës
- “La Fenice” e Venecias
- “Panorama Dramatique” e Parisit
- “Theatre Comique” e Bostonit SHBA

- “Park Theatre” e Nju Jorkut
- “Theatre Lafayette” i Nju Jorkut
- “De Rochefort” në Francë
- “Teatro Vittorio Emanuele” i Torinos
- “Teatro Regio” i Torinos
- “Teatro Nuovo” i Padovës
- “Royal Theatre” i Stokholmit
- “Deutsches Theater” i Berlinit, etj.

Ndër veprat operistike më të njohura, që u mirëpritën me mjaft kureshtje dhe vëmendje nga publiku evropian mund të renditen:

Opera lirike në tre akte **“Ali Pasha, ou Jerome L’Enfle”**, me libret të **Francois Fougeray, e cila u vu në skenën e “Teatro Panorama”** të Parisit, në Mars të vitit 1822, pak ditë mbas vrasjes së Ali Pashës. Autori ia dedikonte operën qëndresës heroike në çastet e fundit të rebelimit antiosman dhe vrasjes së Ali Pashës.

Në muajin Korrik të vitit 1822, pesë muaj pas vrasjes së Ali Pashës, u prezantua në sallën e njohur të **teatrit historik të Parisit “Panorama – Dramatique”**, melodrama në tre akte me titull **“Ali Pasha”**. Libreti u shkrua nga dy prej shkrimtarëve francezë më në zë të kohës, François Isaak Hyacinthe de Comberousse dhe Jean Michel Pichat. Pas suksesit në Paris, melodrama u prezantua më datë 2. 12. 1822 edhe në skenën e Roterdamit nën interpretues hollandezë.

Më 12 Tetor 1822, gati tetë muaj pas vrasjes së Ali Pashës, u prezantua në skenën e njohur historike të “Royal Theatre – of Convent Garden” të Londrës, opera **“Ali Pasha or the Signet Ring”** (“Ali Pasha apo unaza – vulë”). Libreti i operës ishte shkruar nga shkrimtari, dramaturgu, skenaristi dhe poeti i njohur amerikan **John Hoard Payne**. Rolet kryesore u interpretuan nga artistët më të njohur të kohës, sikundër William Farren (Ali Pasha) – i vlerësuar si krenaria e tetarit të Londrës, Ema Sarah Love (që nënkuptonte Vasiliqinë), por që në skenë mbante emrin Helena, etj.

E njëjta opera **“Ali Pasha or the Signet Ring”** (“Ali Pasha apo unaza – vulë”), në vitin 1823 u luajt në skenën historike të “Park Theatre” të New Yorkut, nën drejtimin e dramaturgut të famshëm britanik **James Robinson Planche**.


Në vitin 1825 poeti dhe dramaturgu i njohur, ndoshta ndër më të mëdhenjtë e kohës së tij, francezi **Jean Luis Nepomucene Lemersier** shkroi në Paris, tragjedinë në gjashtë akte të titulluar **“Les Martyres de Suliet et L’Epire Moderne”**. Vepra e dramaturgut francez mbështetej kryesisht në botimet e Konsullit francez pranë Ali Pashës, Fransua Puqueville. Të gjithë personazhet e kësaj opere janë figura reale, pjesëmarrës në ngjarjet historike pashallëkut të Janinës dhe të rezistencës suljote.

Në vitin 1825 shkrimtari dhe skenaristi gjerman Theodor von Haupt prezantoi në teatrin e operas të Laipsigut melodramën me titull **“Ali Pascha”**.


Më 2 Janar të vitit 1827 u shfaq në Munster të Vestfalisë - Gjermani, opera romantike me një akt e titulluar **“Ali Pascha von Janina”** e kompozitorit të njohur gjerman, **Gustav Albert Lortzing**.

Më 3 Korrik të vitit 1827, në **teatrin francez “De Rochefort”** u luajt premiera e melodramës **“La Mort d’Ali Tebelen, Pasha de Janina”**. Autor i libretit ishte poeti dhe skenaristi i njohur i teatrit **Eugen de Pradel**. Opera ishte një tragjedi në tre akte, e cila njohu një sukses dhe u rivu në skenë për shumë kohë.


Më 11 Maj të vitit 1827, në “Teatrin Mbretëror” të Stokholmit – Suedi, u prezantua premiera e operës **“Die Sulioten oder die Ubergabe von Suli...”** (“Suliotët dhe rënia e Sulit – Një ngjarje nga luftimet për lirinë e Greqisë”) Libreti i operës ishte shkruar nga shkrimtari dhe kompozitori i njohur romantik suedez, **Franz Adolf Bervald**. Opera i dedikohej




OPERA “SULIOTËT DHE RENIA E SULIT”, SHFAQUR NE TEATRIN MBRETEROR TE STOKHOLMIT, ME 11 MAJ TË VITIT 1827.



OPERA “MARTYRET E SULIT – EPIRI MODERN” SHFAQUR NE PARIS, ME 1825



MELODRAMA “ALI PASHA, UNAZA VULE” SHFAQUR NË TEATRIN MBRETËROR, NË LONDËR, ME 1828.



OPERA “ALI PASHA I JANINES”, ME AUTOR GIOVANNI GALZERINI, SHFAQUR NE VITI 1838, NE “LA SCALA” TE MILANOS

ALEXANDRE DUMAS FILS
DE L'ACADEMIE FRANÇAISE

THÉÂTRE COMPLET


AVEC PRÉFACES INÉDITES

VI
MONSIEUR ALPHONSE
L'ÉTRANGÈRE



PARIS
CALMANN LÉVY, ÉDITEUR
ANCIENNE MAISON MICHEL LÉVY FRÈRES
3, RUE AUBER, 3
1896
Droits de reproduction et de traduction réservés.


TEATER KUSHTUAR ALI PASHES,
MBESHTETUR NE BOTIMIN E
ALEKSANDER DYMASE, SHFAQUR NE
PARIS ME 1896



“DEKJA E ALI-TEPELENES, PASHAIT
TE JANINES”, TRAGJEDI NE VARGJE,
NE TRE AKTE, SHFAQUR NE PARIS, ME
31 KORRIK 1827.



ARTIKULL PER ALI PASHEN SHKRUAR
NE GAZETEN PARISJENE “JOURNAL
DES DEBATS” ME 25 SHKURT 1822



OPERA KOMIKE ME NJE AKT “ARIU
DHE PASHAI”, SHFAQUR NE PARIS, ME
1820

princeshës Josephina Maximiliana Evgenia, trashëgimtare e fronit mbretëror të Suedisë dhe Norvegjisë. Figura qendrore e operës ishte Ali Pasha dhe përballë tij Lambro Xhavella, babai i luftëtarit të njohur suliot Foto Xhavella.

Po këtë vit, 1827, në një nga skenat më të mëdha të teatrit të Nju Jorkut, “Lafayette Theatre” u shfaq premiera e melodramës së titulluar “Ali Pasha or the greek struggle

for liberty” e dramaturgut të njohur anglez **Robinson Planché**.

Në ditët e karnavaleve, në vitin 1838 u vu në skenën më të madhe të muzikës botërore, “La Scala” të Milanos, opera “*Ali Pascia di Giannina*”. Krijuesi i saj, ishte një prej figurave më të njohura të botës muzikore në Europë, **Giovanni Galzerani**, i njohur edhe si kompozitor, libretist, koreograf dhe interpretues. Dirigjent i orkestrës së madhe

ishte Giuseppe Carlucci. Rolin e Ali Pashës e interpretonte Effisio Catte. Prima balerina në interpretimin e operës ishte balerina më e njohur e kohës në skenat e Europës, austriakja Fanny Essler, e cila kishte ardhur nga skena e Operas së Vjenës. Shfaqja pati një sukses të jashtëzakonshëm dhe qëndroi në skenën e “La Scala” për shumë kohë.

Në Prill të vitit 1843 u shfaq në skenën e njohur të teatrit “La Fenice” të Venecias,

opera me titull “*Ultimi Giorni di Suli*” (“*Ditët e fundit të qëndresës së Sulit*”). Libreti i operës ishte shkruar nga Giovanni Peruzzini, ndërsa kompozitori i melodramës ishte kompozitori i njohur **Giovanni Battista Ferrari**. Ngjarja e operës zhvillohet në malet e Sulit në vitin 1803. Në skenë interpretuan disa nga këngëtarët operistikë më të njohur lirikë të kohës sikundër Fortunato Borioni, Almerinda Granchi, këngëtarja personale e mbretit të Prusisë dhe interpretuesja e parë e veprave të Donizzeti-t.

E njëjta vepër, u interpretua më 1857 në skenën e teatrit të Milanos, në Rijeka të Kroacisë, në Ferrara, në Piza, në “Teatro Vittorio Emanuele” të Torinos dhe disa vite më vonë edhe në “Tetro Nuovo” të Padovës.

Me muzikë të kompozitorit **H. Sergent**, me libret të shkrimtarëve të njohur Henri Fraconi dhe Henri Vilmot, me koreografi të baletmaestrit Bertoto, u shfaq në “Theatre du Cirque Olympique” të Parisit, opera me titull “*Suli ou les Suliotés*”. Vepra i kushtohet rrethimit të Sulit nga repartet e Ali Pashës, në vitin 1792. Figurat kryesore të veprës janë Myftar Pasha, Lambro Xhavella, Foto Xhavella, Gjergj Boçari, Isuf Arapi, etj., të gjithë këta personazhe historikë pjesëmarrës aktivë në skenat e zhvillimeve politike në pashallëkun e Janinës.

Sigurisht, kjo figurë kaq komplekse, që tërhoqi vëmendjen e rrethve politike, diplomatike, ushtarake por edhe ato intelektuale të kohës, në Europë e më gjerë, me kurajën e tij për tu ngritur kundër një perandorie shumëshekullore të kohës, sikundër qe Perandoria Osmane, ngjalli interes të veçantë edhe tek popujt fqinjë ballkanikë. Kompozitorë, libretistë dhe interpretuan vepra të shumta dedikuar këtij monarku që ngjalli shpresat e lirisë së popujve të robëruar me rebelimin e tij. Krijimet e tyre u interpretuan pothuaj në të gjitha skenat e muzikës, dramës dhe teatrit grek në Athinë, Selanik, Janinë, Korfuz, Patra, e gjetkë.

Me siguri në fondet e panumërta të arkivave europiane duhet të ruhen edhe krijime të tjera për këtë hegjemon, ashtu sikundër jemi të bindur se vlera të tjera do të dalin në dritë për të dhe shqiptarët e asaj kohe.

Fotot në vijim janë vetëm disa nga afishet (postera) që ngjitesh në muret e qyteteve të Europës, në Paris, Londër, Berlin, Milano, Venecia, Stokholm dhe njoftonin shfaqet e operave për këtë shqiptar zulmëmadh. Me dhjetëra dhe qindra të tjerë ruhen në fondet e arkivave për t'i treguar qytetarit modern dimensionet befusuese dhe mahnitëse të këtij shqiptari mbresëlënës në histori.

Karikaturë nga Arben Mexsi



Gabriel García Márquez (1927-2014), njohur ndryshe si "Gabo", e nisi karrierën e tij si gazetar, por famën e mori prej romaneve dhe tregimeve të shkurtër të cilat i dhanë Çmimin Nobel për letërsi në vitin 1982.

Midis shkrimtarit peruan, Mario Vargas Llosa, dhe atij meksikan, Carlos Fuentes, ai ishte anëtar i njohur i triumviratit që nisi bumin në letërsinë amerikano-latine në fund të viteve '60. Márquez popullarizoi stilin që u bë i njohur si "realizmi magjik", duke ndikuar te shkrimtarët e mëvonshëm si Isabel Allende dhe Salman Rushdie.

Romani i tij, "Njëqind vjet vetmi", ka shitur mbi 30 milionë kopje dhe është përkthyer në 37 gjuhë. Ai është një prej shkrimtarëve më të përkthyer në botë të gjuhës spanjolle, së bashku me Allende-n, Jorge Luis Borges-in, dhe autorin e Don Kishotit, Miguel de Cervantes.

Lajmet për romanin e pabotuar të Márquez-it kanë bërë bujë për gati një vit. Romanet e botuara pas vdekjes mund të shkaktojnë polemika. Zakonisht futen në katër kategori.

Disa janë të papërfunduara ose të paplota. Ato janë ose vepra fragmentare, si për shembull "The Original of Laura", e Vladimir Nabokov-it, ose vepra të rëndësishme të cilat nuk janë rishikuar plotësisht siç do autori. Disa shembuj të famshëm të romaneve të papërfunduara e të botuara pas vdekjes së autorit, janë veprat e Franz Kafka-s, "Amerika", "Procesi", dhe "Kështjella".

Disa janë pjesërisht të përfunduara. Në këtë rast, kemi pjesë të cilat janë rishikuar krejtësisht nga autori, sipas pëlqimit të tij ose të saj, por që drafti nuk është i plotë. Romani i fundit i Charles Dickens-it, "Misteri i Edvin Drudit", bie në këtë kategori. Kur Dickens ndërroi jetë në vitin 1870, kishte përfunduar dhe rishikuar plotësisht gjashtë nga dymbëdhjetë kapituj.

Ka raste që librat e botuar pas vdekjes së autorit janë të përfunduar dhe të rishikuar. Në vitin 1914, E. M. Forster shkroi romanin "Maurice", i cili flet për dashurinë homoseksuale. Ai e rishikoi, por vendosi të mos e botonte. Kishte frikë nga pasojat ligjore prej qëndrimeve kundrejt homoseksualitetit gjatë asaj kohë. Romani u botua në vitin 1971, një vit pas vdekjes së tij.

Pastaj kemi romanet e përfunduara, por të parishikuara. Drafti i plotë ekziston, por dimë se duhej një rishikim i mëtejshëm prej autorit. Për shembull, vepra "The Silmarillion" e J. R. R. Tolkien-it, u shkrua pas romanit "Hobit", por fillimisht u refuzua. Kjo bëri që Tolkien të shkruante trilogjinë e "Kryezotit të unazave". Si përfundim, "The Silmarillion" u rishikua, u redaktua dhe u botua prej djalit të Tolkien-it, Christopher Tolkien, katër vite pas vdekjes së babait të tij.

Romani "Shihemi në gusht" i Márquez-it bie në këtë kategori të fundit. Është një vepër e përfunduar, por që Márquez nuk arriti ta rishikonte. Romani u redaktua prej Cristóbal Pera-s, i cili redaktoi gjithashtu librin me kujtime të Márquez-it, "Jeto për ta treguar". Versioni i botuar bazohet në draftin e pestë dhe të fundit të Márquez-it, duke përfshirë disa fragmente prej drafteve të mëparshme.

Është e rëndësishme që ta kemi parasysh këtë teksta lexojmë romanin, së bashku me arsyet se përse nuk u rishikua plotësisht.

THASHETHEME LETRARE

Thashethemet për ekzistencën e një romani të pabotuar nga Márquez janë dëgjuar që prej marsit të vitit 1999,

ROMANI I FUNDIT I GABRIEL GARCÍA MÁRQUEZ-IT, ËSHTË NJË DËSHMI PREKËSE E GJENISË SË TIJ

Gabriel Garcia Ochoa

Përktheu: David Hudhri

kur autori lexoi një kapitull të romanit "Shihemi në gusht" në qendrën kulturore Casa América në Madrid, gjatë forumit të atij viti për Shoqatën Spanjolle të Shkrimtarëve dhe Botuesve. Tre ditë më pas, gazeta spanjolle El País botoi kapitullin, i cili më pas u përkthye në anglisht për revistën The New Yorker.

Në vitin 2003, u zbulua një tjetër fragment i këtij romani. U botua si tregim i shkurtër në revistën kolumbiane Cambio (e cila zotërohej nga Márquez-i), me titullin "Mbrëmja e eklipsit".

Pas kësaj, heshtje. Për një kohë të gjatë, u duk se këto thashetheme ishin veçse të tilla, deri në gushtin e vitit 2023, kur botuesi Penguin Random House konfirmoi ekzistencën e këtij romani dhe datën e botimit të tij në vitin 2024, dhjetë vjetori i vdekjes së Márquez-it. Data e botimit është dyfish e rëndësishme: në spanjisht, libri u botua në 6 mars, për ditëlindjen e tij. Márquez ishte perfeksionist. Ai i

rishikonte romanet e tij me përpikëri, i rishikonte vazhdimisht. Kryevepra e tij e padiskutueshme, "Vjeshta e patriarkut", deshi 17 vite të përfundohej.

Prandaj fëmijët e tij, Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha, tashmë në zotërim të trashëgimisë letrare të babait të tyre, fillimisht nuk deshën ta botonin "Shihemi në gusht". Në parathënien e romanit, ata ndajnë mendimin e babait të tyre për këtë roman: "Ky libër nuk bën. Duhet shkatërruar".

Megjithatë, siç vëllezërit vënë në dukje, "Shihemi në gusht" ishte "përpjekja e fundit e babait të tyre për të vazhduar krijimtarinë". Në vitin 1999, Márquez u diagnostifikua me kancer limfatik, dhe pas pak vitesh, në 2002-shin, me demencë. Përkeqësimi i shëndetit, i ndikoi tek e shkruara. Romani "Shihemi në gusht" u shkrua gjatë kësaj periudhe.

Ky "roman" është më shumë një novelë, diku te 100 faqe i gjatë, i ndarë në

gjashtë kapituj të cilët organizohen rreth personazhit kryesor, Ana Magdalena Bach. Ana Magdalena është 46 vjeç. Emri i është vënë pas gruas së dytë të Johann Sebastian Bach-ut dhe, ashtu si adashi i saj, edhe kjo është martuar me një muzikant. Domenico Amaris, bashkëshorti i saj prej 27 vitesh, është drejtori i shkollës së muzikës.

Nëna e Ana Magdalena-s ndërroi jetë tetë vite përpara. Dëshira e saj e fundit ishte të varrosej në një ishull të Karaibeve. Çdo vit në datën 16 gusht, në përvjetorin e vdekjes së mamasë së saj, Ana Magdalena niset për një udhëtim njëditor, për të çuar lule te varri i saj.

Në udhëtimin e tetë për në ishull, Ana Magdalena takohet me një burrë dhe bën seks me të. Në këtë pikë, është tunduese të mendosh se libri do të flasë për marrëdhënien e Magdalena-s me këtë burrë, për gjetjen e dashurisë së vërtetë, për dëshirën e zjarrtë përgjatë vitit për ta takuar atë në gusht. Por nuk është kjo tematika.

Pas këtij takimi të parë, Ana Magdalena vë synim që çdo vit të gjejë një burrë tjetër me të cilin të kalojë natën në 16 gusht.

Megjithatë, libri nuk flet as për lirinë e saj seksuale. Na bëhet e qartë se pas gati tre dekadash bashkë, Ana Magdalena dhe bashkëshorti i saj gëzojnë ende një martesë të shëndetshme, si dhe një jetë seksuale të nxehtë që përfshin çdo lloj aventure erotike, të cilat i bëjnë çiftet më të reja në moshë.

Anonimiteti i ishullit nxit elemente të tjera të identitetit të Ana Magdalena-s që të dalin në pah dhe ta ndryshojnë atë në lloj-lloj mënyrash. Përvojat e saj seksuale janë të larmishme. Njëri nga takimet është me një burrë i cili supozon se ajo është prostitutë, dhe në kopjen e saj të librit "Drakula" të Bram Stoker-it, ai i lë njëzet dollarë, duke e zemëruar.

Çuditërisht, asnjëri prej burrave me të cilët Ana Magdalena fle, nuk ka emër. Ata janë anonim, duke e bërë Ana Magdalena-n protagonisten e vetme të këtyre takimeve.

TË SHKRUASH MES VËSHITRËSIVE

"Shihemi në gusht" shkëlqen nga Sgjenia e Márquez-it. E shkruara është magjepsëse, subjekti është tejet kreativ. Personazhet janë të ndërlikuar, kontradiktor dhe tërheqës.

Nuk është një roman i realizmit magjik, ndaj mos prisni diçka të tillë. Megjithatë është një libër që të rrëmben dhe një dëshmi e sfidave që Márquez po luftonte për t'i kapërcyer, teksa e shkruante. Librat nuk ekzistojnë në vakum, por janë produkt i rrethanave në të cilat shkruhen. Si rrjedhojë, "Shihemi në gusht" nuk është vepra më e mirë e Márquez-it. Subjekti ka disa kontradikta të vogla, përsëritje të panevojshme dhe një mungesë qartësie në ca paragrafë. Fundi i romanit është i papritur.

E megjithatë është një libër i mrekullueshëm, veçanërisht kur marrim parasysh se në mënyrë metaforike, Márquez e shkroi me një dorë të lidhur pas shpine.

Në leksionin e saj për Nobelin të titulluar "Të shkruarit dhe të qenit", autorja afrikano-jugore, Nadine Gordimer, përmend përkushtimin politik të Márquez-it ndaj të shkruarës. Ajo përmbledh këndvështrimet e tij në një fjali: "Detyra e shkrimtarit, ose detyra e tij revolucionare, është të shkruajë mirë".

Përballë betejës, shkrimtari shkruan. Edhe Márquez, përballë sëmundjes, shkroi. "Shihemi në gusht" është fryti i kësaj pune përballë vështirësisë, një dëshmi prekëse e dashurisë dhe e përkushtimit të Márquez-it ndaj letërsisë.



SKËNDER BUÇPAPAJ

njeri me hënë

OnufriRoman

